Rruga Arbërit

GAZETË E PAVARUR. NR. 1 (33). JANAR 2009. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO

AURORA GROUP

PROJEKTIM - ZBATIM

koha kalon, cilësia mbetet

Autostrada Tirane - Durres, Km.9
Tel: +355 48 30 2046
Tel: +355 48 30 2040
www.auroragroup.com.al
e-mail: auroragroup@auroragroup.com.al

OPINION

Skënderbeu, personazhi më i gjallë i gjithë historisë së shqiptarëve

Nga BAMIR TOPI
President i Republikës

Familjet e mëdha fisnike shqiptare zënë fill herët në Mesjetë me principatat arbërore, për të kulmuar me familjen e Kastriotëve dhe Skënderbeun, dhe pas tij ato ripozicionohen sipas rrjedhave historike, në të cilat përfshihet faktori shqiptar.

Në këtë konferencë, sot, do të flitet për familjet e mëdha shqiptare, me kumtesa profesionale mbi personazhe, ngjarje fakte e kontribute. Unë jam i bindur që e gjithë fisnikëria historike, si dhe ato familje që iu bashkangjitën asaj me gjeste të rralla patriotizmi, heroizmi, mençurie apo aksion politik në shërbim të lirisë kombëtare, të Pavarësisë së Kosovës dhe prosperitetit të kombit, në kohë të vjetra dhe të reja, dëshmojnë që Skënderbeu, Kryefisniku është kudo, tek çdo shqiptar, si ideal dhe si realitet.

Shekuj më parë, më 17 Janar të vitit 1468, Kryezoti i Arbërisë, Gjergj Kastrioti Skënderbeu ndahej nga jeta për t'u bërë personazhi më i gjallë i gjithë historisë së Shqiptarëve. Fan Noli, që dha e mori me të gjatë, thuajse tërë jetës, pohoi aty nga fundi i saj: "Nganjëherë pyes veten nëse mund të ketë sot ndonjë njeri që të jetë po aq i gjallë sa Skënderbeu"?

Ai ishte realiteti, modeli dhe simboli i një kauze të shenjtë, i lirisë kundër robërisë. Ai ishte Prijësi i një lufte të drejtë, heroike e mbrojtëse si dhe burri i shtetformimit. Efektet e këtij kontributi nuk u zbehën asnjëherë. Ato ishin brumi i Rilindjes kombëtare deri në nëntorin e vitit 1912, në përpjekjen sublime për Pavarësi dhe shtet shqiptar, thelbi i identitetit kombëtar dhe i vetëdijes bashkëkohore. Ideja e luftës çlirimtare me Skënderbeun, u bë realitet madhështor, e njëkohësisht trashëgimi shpirtërore, me të cilën përballuam sfidat e rënda të kohërave.

Ai realizoi të parin bashkim politik dhe ushtarak të arbërve në Kuvendin e Lezhës. Aktiviteti i tij dhe rezistenca ndaj pushtuesit, e vunë atë në ballë të koalicionit antiosman. Lufta Skënderbegiane buronte prej vetëdijes, se pushtimi osman do të tjetërsonte vlerat kombëtare dhe do ta shkëputste vendin nga Europa. Ai nuk pati parësore principatën e tij, por bashkimin e Arbërisë. Epopeja e tij është pasqyrim i dëshirave të shqiptarëve, dhe jo i interesave të tij personale. Qëndresa 25-vjeçare rrezatohet edhe në shekujt e mëvonshëm si nënvetëdije popullore, si folklor, si rrëfim i pandërprerë dhe ushqen herë pas here kryengritje të reja. Lufta për lirinë dhe Pavarësinë e Kosoves u frymëzua edhe nga kujtimi i Heroit.

Ndokush mund të ketë xhelozi për heroin tonë kombëtar, për bëmat, famën, marrëdhënien, që ai ndërtoi me kombin e tij dhe Europën ushtarake e politike të kohës duke u perpjekur sot ta ridimensionojë atë. Ai nuk iu ofrua historisë si personazh i letërsisë, por historia dhe personaliteti i tij dominues në epokën kur jetoi, të qenit mbrojtës dhe jo zaptues, të qenit konseguent në filozofinë e lirisë, të qenit në anën e drejtë e bënë atë lëndë për qindra e mijëra libra, që u shkruan gjatë shekujve.

(Vijon në faqen 4)

KUJTESË

Bashkim Gazidede i kishte shokët e rrallë

Nga: **ADEM BUNGURI** - FAQE 14

ESE

Kuvendim për misionet e papërmbushura

Nga: **AGRON TUFA** - FAQE 7

PORTRET

Fuad Dibra, për Shqipërinë shkriu jetën dhe pasurinë

Nga: **REXHEP TORTE** - FAQE 6

Peshkopia në prag të binjakëzimit me qytetin e Uoterberrit në SHBA



Në foto: Ymer Hasani (majtas) dhe kryebashkiaku i Uoterberrit, Michael J. Jarjura (djathtas), më 28 nëntor 2008, duke ngritur flamurin shqiptar

Ymer Hasani nga Peshkopia ofron ndërmjetësim për një vizitë të delegacionit të qytetit të Uoterberrit në Shqipëri. Në listë si kandidatë për qytete motra janë edhe Korça, Pogradeci dhe Struga. Në këtë qytet amerikan jetojnë 11000 shqiptarë. Cili do jetë qyteti motër? Këtë do e vendosë një delegacion nga qyteti i Uoterberrit që do të vizitojë Shqipërinë në qershor 2009.

LEXONI NE FAQEN 3

Në pranverë nis ndërtimi i Rrugës së Arbërit në Maqedoni

Kryeministri Sali Berisha priti javën që shkoi në një takim kryetarin e Partisë Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) të Maqedonisë Ali Ahmeti, me të cilin diskutoi zhvillimet në Shqipëri dhe Maqedoni, si dhe zgjerimin e mëtejshëm të bashkëpunimit midis dy vendeve.

Ali Ahmeti u shpreh në këtë takim "në këtë pranverë do të fillojë ndërtimi i vazhdimit të Rrugës së Arbrit në territorin e Maqedonisë, si dhe është shpallur tenderi për ndërtimin e hekurudhës që lidh kufirin shqiptar me qytetin e Shkupit". Kryeministri Berisha shprehu kënaqësinë e tij për këtë lajm dhe theksoi se "ndërtimi i këtyre rrjeteve lidhëse janë prioritet i tij dhe i qeverisë shqiptare".

Ky deklarim i z. Ali Ahmeti, është si vazhdimësi e deklarimeve të tij të mëparshme, ku është shprehur për domosdoshmërinë e ndërtimit të Rrugës së Arbërit. Z. Ahmeti dhe partia e tij në Maqedoni kanë pasur gjithmonë një qëndrim konstant lidhur me rrugën. Gjatë fushatës së fundit elektorale, Ali Ahmeti pati premtuar gjatë një tubimi në Dibër, se ndërtimi i rrugës së Arbërit në territorin maqedonas do të ishte një prioritet, në qoftë se ai do t'i fitonte zgjedhjet, dhe tani BDI është në qeverisje, mbetet që të vërtetojë mbajtjen e premtimit.

REKUIEM

"11 heronjtë e Batrës"

Nga: **YMER KETA** - FAQE 13

SHENIME

Shqipëria është e vogël në hartë, inxhinier!

Nga: **VESEL HOXHA** - FAQE 10

S'ka më shpejt se
123ALBANIA
Reklamoni biznesin tuaj 100% falas
Email: marketing@123albania.com
Vizitoni: www.123albania.com

Ky muaj ishte i dhimbshëm për Bulqizën,
siç kanë qenë jo pak muaj vitin e kaluar...
Shpresa në këtë qytet po venitet....

Emigrantët, ndihma për të përballuar krizën

DIBER, MAQEDONI: Dibra me 20 mijë mërgimtarë që jetojnë dhe punojnë në Amerikë si dhe shumë të tjerë në Itali akoma nuk ka filluar t'i ndjejë pasojat e krizës globale ekonomike. Dibranët që ndihmohen financiarisht nga të afërmit e tyre që punojnë në Amerikë thonë se ata u dërgojnë shuma të njëjta parash sikurse vitin e shkuar. Thonë se edhe në këto raste ka mbizotëruar mentaliteti dibran për të ndihmuar të afërmit e tyre.

"Na ndihmojnë, mos të jenë ata neve s'mund të jetojmë", thotë një dibran. "Prap për amerikanët ska krizë. Mos të jenë ata këtu do të ishte kriza edhe më e madhe", shton një tjetër. Por e njëta gjë nuk vlen edhe për ata që veprojnë në Europë. Kompanitë e transferit të parave thonë se nga vendet e Evropës tani transferohen më pak para.

"Posaçërisht muaji i dhjetorit dhe i janarit tregon indikatorë të rënëis të dërgesës së parave posaçërisht nga vendet eurpoiane në Republikën e Maqedonisë. Ballafaqohemi edhe ne me këtë; duhet cekur se në Maqedoni akoma nuk është arrit baza përfundimtare ku do të shihet recesioni përfundimtarë", thotë Ylli Marku, drejtor i Ëestern Union për Maqedoninë.

Edhe pse në Dibër biznesi nuk është i shprehur dukshëm; në këtë qytet bëhet vetëm biznes sezonal ai i verës apo ditëve të shtuna kur shumë banorë të Peshkopisë së Shqipërisë vijnë për të bërë pazar. Ditëve të tjera shitoret shumë pak apo fare frekuentohen nga dibranët.Ata thonë se dollarët amerikane I ruajnë për ditë më të vështira. Nga komuna thonë se pasojat e krizës globale do të mund të ndjehen pas gjasht muajsh.Ata bëjnë thirje që të investohet në komunë.

"Kemi shpresë që tani të hapet edhe një kombinat tjetër për përpunimin e gipsit dhe dibranët të cilët në Amerikë kanë krijuar kapitalet të fillojnë në zonat ekonomike të cilat i kemi bërë me planin detal të hapin vende të reja pune", shprehet Argëtim Fida, kryetar i Komunës së Dibrës.

Sipas te dhënave statistikore dhe financiare te Maqedonisë, gjatë viteve të fundit mërgimtarët në vendlindje dërgojnë rreth 100 milionë dollarë në muaj, ose mbi një miliardë në vit. / **Meral Ismaili -** *Gazeta Koha*

Kronikë e dhimbshme nga qyteti i minatorëve



SHEMBET GALERIA, NJË MINATOR I BLLOKUAR DHE NJË I PLAGOSUR

Një tjetër aksident i rëndë ka ndodhur në galeritë e kromit në Bulqizë. Një minator rezulton i humbur, ndërsa një tjetër është plagosur rëndë, si pasojë e një shembjeje që ndodhi dje pasdite në një galeri që shfrytëzohej prej një firme të palicencuar. Burimet policore njoftuan se të dielën, rreth orës 16.00, në një galeri që ndodhet jashtë minierës së Bulqizës ka ndodhur një shembje e cila ka bllokuar dy minatorë, të cilët punonin për nxjerrjen e mineralit të kromit.

Kolegët që ndodheshin në galeri në ato momente kanë arritur të nxjerrin jashtë minatorin Astrit Kuka, i cili ka marrë plagë të rënda, ndërsa minatori tjetër, Arjan Duva ka mbetur në galeri dhe nuk dihet nëse është mbuluar nga dherat, apo vetëm është izoluar përtej pjesës së bllokuar. Forcat e policisë kanë mbërritur menjëherë në vendngjarje dhe kanë nisur punën për shpëtimin e minatorit Duva. Ndërkohë, minatori i shpëtuar nga kolegët është dërguar menjëherë në spitalin e qytetit të Bulqizës. Mjekët aty thanë se ai ka pësuar dëmtime të rënda në trup, por nuk rrezikon jetën. Ndërkohë, operacionet për kërkimin e minatorit tjetër kanë qenë pa sukses deri në orët e vona të mbrëmjes së djeshme. Krerët e Policisë së Bulqizës dhe ekspertët e minierave që u thirrën për të dhënë ndihmën e tyre thanë se operacioni për kërkimin e minatorit është shumë delikat. Gërmimet për hapjen e galerisë nuk mund të bëhen shpejt dhe nuk mund të përdoren mjete të rënda, pasi rrezikohet ndonjë shembje tjetër, apo dëmtimi i personit që kërkohet të shpëtohet.

Ndërkohë, mësohet se galeria ku ndodhi aksidenti administrohej nga një firmë e palicencuar, emri i pronarit të së cilës ende nuk bëhet i ditur. Mësohet se firma i kishte nxjerrë minatorët në punë të dielën, jashtë rregullores së funksionimit të galerisë. Ndërkohë, nga dëshmitë e minatorëve mësohet se galerisë i mungonte armatura dhe për këtë arsye ka ndodhur edhe shembja.

PALLATI I SHEMBUR, 15 FAMILJE MARRIN STATUSIN E TË PASTREHUT

Familjet e dëmtuara do të vendosen në një pallat tjetër që do të rikonstruktohet

Dhënia e shenjave të shembjes së pallatit të papërfunduar në Lagjen e Re të qytetit minator të Bulqizës javës që kaloi, ka detyruar këshillin bashkiak t'u japë 15 familjeve që banonin atje statusin e të pastrehut. Dje, Këshilli Bashkiak i Bulqizës, në një mbledhje të organizuar jashtë radhës, me një votim unanim, u ka dhënë këtyre familjeve statusin e të pastrehut. Aktualisht në bazë të një marrëveshjeje midis qeverisjes vendore dhe myftinisë së qytetit, është rënë dakord që për një muaj 56 banorët e këtyre familjeve që rrezikoheshin nga shembja e pallatit, të banojnë në mjediset e xhamisë së qytetit. Bashkia ka furnizuar këta banorë me rroba fjetjeje, ndërsa të afërmit e tyre kanë dhënë ç'të mundnin: veshje, ushqime, enë kuzhine etj. Kushtet në dhomat e myftinisë janë më të mira se atje ku ishim thonë ata, por edhe këtu ndeshen probleme, që kanë të bëjnë me kufizimet që imponon vetë mjedisi fetar dhe nuk mund të rrimë përgjithmonë, pra gjithsesi kjo mbetet një zgjidhje e përkohshme. Sipas vendorëve, është dhënë miratimi nga strukturat shtetërore për të investuar të paktën 22 milionë lekë për rikonstruksionin e një pallati tjetër në lagjen "Gjeologu" të qytetit. Ky pallat është ish-kompleksi i minatorëve, i ndërtuar në vitet '90 dhe ka shërbyer si gardërobë për minatorët e Bulqizës. Burime pranë bashkisë së qytetit sqarojnë se objekti deri tani është pronë e "Albkrom"-it, shoqërisë që ka menaxhuar deri para pak vitesh industrinë e kromit në vendin tonë. Ndër vite, ky pallat pesëkatësh nuk është banuar, sepse shoqëria e kromit nuk ka lejuar askënd të strehohet këtu. Po sipas këtyre burimeve, merret vesh se pas ndërhyrjeve të drejtuesve vendorë në qeveri është rënë dakord që objekti të shndërrohet në shtëpi banimi për 15 familjet. Me paratë e buxhetit të shtetit do të investohet për të krijuar të tjera kushte banimi për familjet, që mbetën të pastreha nga shembja e pallatit. Procedurat e tenderimit gjithashtu do të jenë të shpejta dhe me gjithë të ftohtin e këtyre ditëve, specialistë të ndërtimit do të zbatojnë një projekt emergjent dhe të zbatueshëm për momentin, për krijimin e kushteve të banimit për të gjitha familjet e mbetura pa shtëpi. Ndërkohë këta familjarë këmbëngulin dhe kërkojnë kushte më të mira sesa në pallatin që u shemb.

PALLATET E MINATORËVE, NË RREZIK SHEMBJEJE

Në lagjen "Gjeologu" në Bulqizë, infrastruktura e parehabilituar e para viteve '90 rrezikon shembjen e shtëpive ku jetojnë kryesisht familjet e minatorëve. Më shumë se 100 minatorë jetojnë në apartamente të amortizuara, të cilat nuk plotësojnë kushtet minimale të banimit. Lagjja "Gjeolog" ndodhet pak metra poshtë minierës gjigante të Bulqizës. Dhjetëra pallate kryesisht dykatëshe, ish-fjetore të punëtorëve të minierës, të ndërtuara para viteve '90, rrezikojnë shembjen dhe qindra banorë rrezikojnë jo vetëm të mbeten pa shtëpi, por edhe të aksidentohen.

Minatorë të ardhur nga zona të ndryshme të vendit, në pamundësi për të qenë korrektë për paraqitjen në punë u detyruan të sistemohen në qytetin e Bulqizës, së bashku me familjet e tyre. Ishte pothuajse e pamundur për ata që të udhëtonin me orë të tëra për të qenë në orarin e përcaktuar në punë.

Kështu, vendosën të gjenin si zgjidhje bashkimin me familjet e tyre në këto qytete dhe në mungesë apartamentesh u detyruan t'i vendosin të afërmit në ish-fjetoret e punëtorëve. Kushtet që ofronin këto banesa ishin jo vetëm të papërshtatshme për një jetesë normale. Ish-bujtina minatorësh, ndërtuar në fillimin e viteve '60, me sipërfaqe banimi, rreth 20 metër katrorë për çdo dhomë, aktualisht banojnë familje me nga katër deri në tetë persona. Familjet e minatorëve ushqehen, qëndrojnë, flenë, presin dhe miq në një dhomë me katër mure. Mbi 30 familje në çdo njërën nga këto bujtina, kanë një tualet të përbashkët.

Pallate të amortizuara, shkallë të dëmtuara ku ke frikë se rrëzohesh, tavane të shembura pjesërisht, mure me suva të rënë dhe me lagështirë, tualete në kushte tejet të vështira, është mjedisi ku jetojnë më shumë se 100 familje.

"Të paktën të investohet për shkallët, çatinë që pikon, ujin e pijshëm, tualetet", thonë banorët e pallateve. Ata tregojnë se në çdo fushatë elektorale u premtohen investime për rikonstruksion, ose sistemim në mjedise të reja, por deri tani nuk është bërë asgjë. Amortizimi, varfëria e tejskajshme, mungesa e rehabilitimit, dimri i ftohtë dhe i ashpër rrezikojnë për çdo ditë jetën e këtyre banorëve. *(Gazeta Shqip)*

Posta e Rruga Arbërit

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Redaksia u kujton bashkëpunëtorëve të saj, zotërinjve Agron Tufa, Viron Kona, Perikli Jorgoni, Selman Mziu, Ymer Keta, Bajram Hyseni, Xhelal Roçi, Odise Plaku, Ali Koçeku, Kujtim Boriçi, etj., se shkrimet e tyre, për arsye vendi nuk janë botuar në këtë numër.
Ato do të botohen në numrat e ardhshëm të gazetës "Rruga e Arbërit".

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës. Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.

Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

DREJTOR:
Rakip Suli

Këshilli Botues:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Bashkëpunuan në këtë numër:
Agron Tufa,
Rexhep Torte,
Abdurrahim Ashiku,
Shehat Marku,
Sakip Cami,
Vesel Hoxha,
Ymer Keta,
Adem Bunguri,
Fatjon Pandovski,
Meral Ismaili
Lulzim Çota
Ali Hoxha

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

binjakëzim

Peshkopia ofron resurse të vlefshme si banjat termale, vende historike, si dhe është një qytet që mund të shërbejë si urë lidhëse mes Shqipërisë dhe Maqedonisë.

Peshkopia ofron mikpritjen për Uoterberrin

Ymer Hasani nga Peshkopia ofron ndërmjetësim për një vizitë të delegacionit të qytetit të Uoterberrit në Shqipëri. Në listë si kandidatë për qytete motra janë edhe Korça, Pogradeci dhe Struga. Në këtë qytet amerikan jetojnë 11000 shqiptarë.

Me poshtë po botojmë artikullin të botuar më 15 dhjetor 2008 në gazetën REPUBLICAN-AMERICAN të qytetit amerikan të Uotërberrit, të shkruar nga PENELOPE OVERTON, përgatitur për botim në gazetën "Rruga e Arbërit" nga LULZIM ÇOTA



Në foto: Ymer Hasani dhe kryebashkiaku i Uoterberrit, Michael J. Jarjura, më 28 nëntor 2008, duke ngritur flamurin shqiptar

Qyteti i Uoterberit planifikon të dërgojë një delegacion zyrtar në Ballkan verën e ardhshme, por nuk ka vendosur se çfarë qytetesh apo vendesh, do të vizitojë, në kërkim të një qyteti-motër për t'i paraqitur rritjet e Uoterberit komunitetit shqiptar.

Një banor i qytetit, Ymer Hasani, dëshiron të ndihmojë Uoterberrin të marrë vendimin e tij. Hasani, i lindur në qytetin e Peshkopisë në Shqipëri, e zgjeron ofertën e qytetit të tij të lindjes për të paguar për vizitën e delegacionit në rajon, vizita në qytetet e tjera të konsideruara, përfshi Korçën në Shqipëri dhe Strugën në Maqedoni.

Në shkëmbim, Peshkopia dëshiron që Uoterberi të presë deri pas vizitës zyrtare për zgjedhur qytetin-motër, thekson Hasani.

"Ne do të jemi të gëzuar të kemi një vizitë, shkëmbim idesh. Kjo do të thotë shumë për ne," thotë Hasani, i cili u largua nga Shqipëria për në Uoterberri rreth pesë vjet më pare. Ndërkohë, fëmijët e tij vazhduan kolegjet në Nju-Jork dhe Konektikat. Në Shqipëri Hasani punonte për qeverinë qendrore, si jurist për të drejtat e njeriut. Në SHBA ai nuk ka licencë për të punuar në fushën e jurispredencës, kështu që ka nisur një biznes për të ndihmuar shqiptarët se si të merren me çështjet e tyre europiane dhe gjithashtu, punon si mësues zëvendësues.

Hasani nuk ka asgje kundër Strugës dhe Korçës, madje flet mirë për to, por ai mendon se Peshkopia ka më shumë gjëra të përbashkëta me Uoterberrin se ato – përmasa dhe klimë të ngjashme dhe njerëz të gjallë. Dhe, më e rëndësishmja, Hasani beson se Peshkopia do dhe ka nevojë për një lidhje me Uotërberrin më shumë se qytetet e tjera.

"Ne jemi shumë të uritur për demokraci, dije dhe biznes" thekson Hasani, që më tej shton: "Ne jemi një vend i lashtë, por në një farë mënyre, ne jemi si një fëmijë që ende po mëson. Për shembull, ne kemi burime termale të mrekullueshme, por nuk kemi hotele turistike që të na ndihmojnë ne të zhvillojmë burimet që kemi."

Dy javë më parë Kryetari i Bashkisë së Strugës, Ramiz Merko, i dërgoi një letër Kryetarit të Bashkisë së Uotërberrit, Michael J. Jarjura, në të cilën i kërkonte zyrtarisht që Struga të ishte qyteti shqiptar motër. Në letrën e tij ai vinte në dukje virtutet e qytetit të tij dhe Uotërberrit, duke theksuar se shumica e shqiptarëve që banojnë në këtë qytet, numri i të cilëve, jo zyrtarisht është rreth 15000 veta, vijnë nga zona e Strugës.

"E dimë se shumë shqiptarë, veçanërisht nga Struga kanë gjetur mikpritje dhe të drejta të barbarta në SHBA dhe fatin për një jetë më të mirë në qytetin tuaj të bukur," shkruan në letrën e tij Kryetari i Bashkisë së Strugës, z. Merko. Më tej ai thekson se "lidhjet e shqiptarëve me vendin e tyre të origjinës kanë mbetur të pandërprera, ndërsa kultura që ata fituar në SHBA na bën ne krenarë."

Në ceremoninë e ngritjes së flamurit shqiptar në Bashkinë e qytetit, pak kohë më parë, banorët e ardhur nga Korça shprehën interesin e tyre për të realizuar një binakëzim të ngjashëm edhe me qytetin e tyre të origjinës (Korça) thekson këshilltari i Kryebashkiakut, Steve Gambini. Më tej, ai vuri ne dukje, se zyrtarët bashkiakë së shpejti do të organizojnë një takim me përfaqësuesit e të tre qyteteve për të vendosur "se si të procedojmë me diplomaci."

Ymer Hasani: Çdo qytet shqiptar mund dhe meriton të jetë qyteti motër për Uaterberrin

Menjehërë pas publikimit të lajmit në gazetën amerikane "REPUBLICAN-AMERICAN", u përpoqëm të lidheshim me z. Ymer Hasani. Por, ndërsa ne kërkonim ndonjë adresë kontakti të tij në Amerikë, Ymer Hasani ishte në Shqipëri, pikërisht për këtë çështje.

Hasani tha për gazetën "Rruga e Arbërit" se ndodhej në Shqipëri për të zhvilluar takime me kryetarët e bashkive të Peshkopisë, Korçës, Pogradecit dhe Strugës, në mënyrë që të shohin mundësine e krijimit të një axhende për vizitën e delagacionit të Uaterberrit në Shqipëri. Ai tha se ishte pajisur me një dokumet përfaqësimi nga këto njësi vendore dhe gjithçka tani është e gatshme për të planifikuar vizitën e kryebashkiakut të Uoterberrit (Waterbury) në Shqipëri.

Qyteti i Uaterberri, në shtetin e Konektikatit (Connecticut) ka njëqind e dhjetë mijë banorë, ku rreth dhjetë mijë prej tyre janë shqiptarë. "Është një nga qytetet me një demokraci shumë të zhvilluar, - thotë Hasani. Në këtë qytet, liria dhe të drejtat e njeriut janë gjëja më e rëndësishme. Më 28 nëntor, - vazhdon ai, - bashkia e këtij qyteti ishte në duart e shqiptarëve. U zhvillua ceremonia e ngritjes së flamurit në shenjë respekti për gati 10% të banorëve të qytetit". "Duke parë vlerësimin që ju bë shqiptarëve në këtë ditë të shënuar, thekson Ymer Hasani, une vendosa t'i bëj një propozim kryetarit të bashkisë, z. Michael J. Jarjura, i cili e mirëpriti me shumë kënaqësi. Propozimi im ishte që Peshkopia të ishte qyteti motër, - thotë me shumë dashuri Hasani, por më vonë, duke parë se edhe shumica e shqiptarëve nuk ishin nga Peshkopia, ata shprehën dëshirën që në listëvn e vendeve për t'u vizituar të shtoheshin edhe qytete të tjera shqiptare. Ideja fillestare ishte për Peshkopinë, por në këtë listë janë futur edhe qytete të tjera si: Korça, Struga dhe Pogradeci, pasi shumica e shqiptarëve janë nga këto vise.

A ka shanse Peshkopia për të qenë një qytet motër i Uoterberrit. Zoti Hasani thotë se po. Peshkopia ka shumë të përbashkëta me Uoterberrin. Përfshihen në të njëjtën gjerësi gjeografike, pra kanë të përbashkëta klimën, por Peshkopia ofron edhe resurse të tjera të vlefshme si banjat termale, vende historike, si dhe është një qytet që mund të shërbejë si urë lidhëse mes Shqipërisë dhe Maqedonisë.

Delegacionin bashkiak të Uoterberrit mund ta shoqërojë edhe një senator i shtetit të Konektikatit si dhe një përfaqësues i Kongresit amerikan. Përveç vizitave në qytetet e mësipërme, ky delegacion do të ketë takime të tjera në kryeqyetin shqiptar. Pikat kryesore të vëmendjes së delegacionit amerikan do të jenë mbi autonominë e pushtetit vendor, rendin publik, por kryesorja do te jetë në drejtim të lirive dhe të drejtave të njeriut. Në këtë kontekst ata do të kenë takime në Tiranë me komisionet parlamentare lidhur me këtë problem, si dhe me përfaqësues të Avokatit të Popullit. Por, sipas zotit Hasani, asgjë nuk është vendosur deri më tani. Gjithcka është në fazëne përgatitjes ë vizitës, e cila nuk do të vetëm e rëndësishme për një nga qytetet shqiptare, por për gjithë Shqipërinë. Është hera e parë, - thekson ai, që krijohet mundësia që një qytet shqiptar të gjejë një qytet motër në SHBA.

Cili do të jetë ky qytet? Për zotin Ymer Hasani kjo nuk ka shumë rëndësi. Secili nga qytetet shqiptare mund dhe meriton të jetë qyteti motër për Uaterberrin, por këtë do ta vendosë delegacioni, i cili nga datat 1 dhe 15 qershor mund të jetë në Shqipëri, natyrisht duke respektuar dhjetë mijë shqiptarët që banojnë dhe kontribuojnë në qytetin amerikan të Uoterberrit.

B. KAROSHI

Peshkopi, banorët kundër HEC-it të Skavicës:

Kryeministri të anullojë tenderin

PESHKOPI- Qindra banorë të Dibrës, kryesisht nga fshatrat e komunës Fushë-Çidhën u mblodhën javën që shkoi në një protestë kundër ndërtimit të HC-së së Skavicës. Ata mbanin në duar pankarta ku shkruhej: "Dibra përmbytet", "Ndal projektit italian", "Përmbyten 6800 hektarë tokë", "Jo hidrocentralit të Skavicës", etj. Në krye të protestës qëndronin drejtuesit e shoqatës "Drini i Zi" Nazmi Drizi, Sadin Përnezha, drejtues të komunës Fushë-Çidhën, banorë të fshatrave që përmbyten, qytetarë të Peshkopisë etj. Ka bashkëbiseduar me organizatorët e mitingut sekretari i prefektit të Dibrës, por nuk është prononcuar zyrtarisht në lidhje me qëndrimin e institucionit për këtë çështje. Oratorët në miting ngritën zërin kundër ndërtimit të hidrocentralit të Skavicës duke renditur dëmet ekonomike dhe historike që sjell realizimi i këtij projekti. Më 17 nëntor 2008, qeveria njoftoi se ka shpallur tenderin për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës. Në garë janë vënë disa firma të huaja, ndërkohë që më e lakuara për ndërtimin e kësaj vepre është një firmë italiane. Në krah të protestuesve dibranë ndodhej edhe historiani Ali Hoxha, i cili hapi mitingun dhe tha se "ndërtimi i HC-së së Skavicës përmbyt një qytetërim të lashtë dhe të njohur në trevat shqiptare". "Ndërtimi i Skavicës sjell fshehjen nën ujë të historisë së një treve nga më të lashtat dhe një trevë nga më të lashtat dhe nga më krenaret, një trevë që ka nxjerrë heroin tonë kombëtar, Gjergj Kastriotin – Skënderbeun, i cili, nga 26 beteja fitoresh të mëdha me zë në historinë e Shqipërisë dhe të Evropës kundër dy sulltanëve osmanlinj, 19 ika zhvilluar me dibranët dhe në tokën dibrane", shpreh Ali Hoxha. Më tej ai tha se "Ismail Kadare para pak ditësh deklaroi se "përbaltja e figurës së Skënderbeut është turp kombëtar, ndërsa unë do të shtoja se përmbytja e Dibrës është krim kombëtar". Protestuesit dhe oratorët që morën më pas fjalën i bënë thirrje qeverisë, veçanërisht kryeministrit Sali Berisha dhe ministrit të Ekonomisë Genc Ruli, të anullojnë tenderin që pritet të zhvillohet në fillim të muajit janar 2009, ndryshe banorët e Fushë-Çidhnës do të pengojnë nisjen e punimeve. Sipas tyre, ky hidrocentral përmbyt më shumë se 6800 hektarë tokë, pronë të cilën dibranët e kanë të paktë dhe të shenjtë. Protestuesit deklaruan se përfaqësues të shoqatës dhe intelektualë të njohur të Dibrës kanë kontaktuar me ministrin Ruli dhe i kanë bërë të ditur atij reagimin e banorëve të kësaj treve. Ndryshe nga TEC i Vlorës që ndot mjedisin, për dibranët ndërtimi i Skavicës zhyt përgjithmonë nën ujë të gjithë pellgun e Dibrës.

Hasan Pasha



Ne si komb me vullnet gjithëkombëtar i mbesim besnikë për jetë të jetëve SHBA-ve, të cilat konstatuan objektivisht se si komb kemi qenë të okupuar nga osmanët, e pas shkatërrimit osman u flijuam për interesa të politikëbërjes së mbrapshë evro-ruse...

"Respekti për kombin tënd është kusht për të respektuar kombet e tjera"

Nga: **SHEHAT MARKU**, Dibër

Politikanët shqiptarë në tërë territoret etnike mposhtin vazhdimisht vullnetin gjithëkombëtar, i dhunojnë vlerat e tija nacionale deri në pabesi.

Kjo katandisje e politikës shqiptare në tërë territoret e saja është pasojë e shkaqeve të vetme për të marrë pushtet dhe asgjë më shumë. Kjo tendencë e hapur u ka errësuar sytë, mendjen, ndërgjegjen dhe shpirtin. Janë bërë cirkusantë, karagjozë primitivë, bajraktarë të inkriminuar. Nuk kanë vizion misionarësh për bëma pozitive zhvillimore me interes kombëtar. Del se të gjithë janë dështakë në këto transformime madhore të kësaj epoke. Pa turp na imponojnë politikë problematike, tekanjoze dhe hazardere; bëhen lëndë e vetme trajtimi përballë interesave kombëtare. Për më keq komunikojnë mes veti me egërsi armiqësore, me qëndrime bajraktarësh primitiv, pa ndërgjegjshmëri të zhvillimeve jetike të kombit.

Çdo ditë e pa ndërprerë na hedhin në llume të pakuptimta me të vetmin qëllim të realizohen me interesat personale, klanore e partiake, duke mos u përballur me kërkesat e vullnetit gjithëkombëtar në këtë kohë të rilindjes dhe transformimeve demokratike botërore.

Me parti të panumërta udhëheqin me njerëz të llojllojshëm, të sojeve dështakë, bile edhe të dyshimtë si renegate mafiozë, kriminelë ordinerë të cilët duke i vënë në shërbim të politikës ditore sunduese realizojne bashkë me ta pasuri marramendëse dhe asgjë më shumë.

Nga këto pak rreshta të konstatuara në zhvillimet e vlerave shoqërore në këto trende politike pas tranzicioneve të mëdha shoqërore, del se humbëm rrekjen epokale të demokratizimit shoqëror si proces. Të priturat dhe angazhimet deri me luftë clirimtare si në Kosovë ashtu edhe në Maqedoni për të realizuar dinjitetin nacional të nëpërkëmbur gati për një shekull, të dhunuar deri në mposhtje prej gjëmës sllavo-komuniste; përbrenda kombit në çerekun e qeverisjes vetanake bashkë me pjesën e okupuar nga imperiazmi jugosllav ende nuk dijme ku jemi, çka kemi arrirë, e çka dëshirojmë dhe çka presim nga këto tranzicione.

Faktet e kësaj epoke flasin vetë:

Po Pavarësi në Kosovë, fitore madhore por e çfarë lloji është – e kufizuar dhe pa sovranitet të plotë. Prej një armiku gati njëshekullor, atij të gjenocidit serb që edhe sot zvarritet ndër qarqet ndërkombëtare duke tentuar të realizojë edhe më tej shtrirje dhe okupime në Kosovën martire.

Partitë politike shqiptare në RM me Marrëveshjen e Ohrit, prodhim ndërkombëtar pas luftës, e bënë lodër politike në hypje dhe zbritje të pushtetit, e sakatosën deri në palcë, e vënë në llogari sipas interesave individuale e klanore vetëm për përfitime financiare të papara gjatë qeverisjeve të tyre; e përjashtojnë pa turp interesin kombëtar.

Konstatojmë se drejtësia e vonuar nuk mund të prodhojë drejtësi të cunguar, sepse është e papranueshme, bashkë me servilizmin politik të politikanëve tanë gjoja të moderuar, të cilët nuk e kanë kuptuar antarësimin në Evropën e Bashkuar se ajo nuk anëtarëson banorë, por kombe.

Në këtë kuptim del se Evropa është nacionaliste, jo internacionaliste, në të përforcohet identiteti kombëtar veç e veç me zhvillimet e globalizmit don të thotë shkurt e prerë të respektosh kombit tënd është kusht për të respektuar tjetrin. Manipulimi me globazmin prej politikanëve tanë është njësoj si manipulimi me internacionalizmin proletar sllavo rus, është pra politikë bastarde.

Politikanët tanë bëlbëzojnë pa turp mëshirë për lirinë tonë në sytë e Evropës, që është tejet armiqësore me interesat tona kombëtare, jo pse unë konstatoj por janë fakte që flasin vetë; mbase politikanët tanë janë pa koncept, pa vizione, pa projekte të dëshiruara dhe të domosdoshme. Të drejtat e fituara nuk i legjitimuan në ndërrimet e qeverisjeve partiake, premtimet i lanë rrugëve ku i premtuan. Institucionet e ndërtuara me interes kombëtar i shkatërrojnë për turp dhe pa ndërgjegjshmëri, duke deklaruar se ata para nesh nuk bënë asgjë, prandaj ato institute janë të pavlera.

Kjo mënyrë e qeverisjes tregon haptazi se privilegjet qeveritare u kanë zënë sytë, arsyen, deri në atë nivel saqë të mirat e tyre i konsiderojnë me interes për të gjithë kombin, bile kërkojnë edhe mbrojtje për ta. Kjo është një papërgjegjësi moralo-politike, në praktikë bëjnë manovra partiake me shkarkime të garniturës së kaluar dhe emërime të garniturës që ka fituar; me hypje - zbritje dhe me kështu qeverisje krijojnë pasiguri, armiqësi brendashqiptare.

Me fudullëk prej primitivizmi tejet të degjeneruar, lirinë nacionale e monopolizojnë, e kushtëzojnë botërisht se demokracia funksionon vetëm me pushtetarët që fituan shumicën. Ja kjo është dhe kështu funksionojnë partitë tona në këtë periudhë të zhvillimeve demokratike.

Sundimi i diktaturës parlamentare bëhet instrument i vetëm për të realizuar njëmendësinë partiake bajraktareske si e të shkuarës komuniste. Partitë tona shfrytëzojnë mentalitetin primitiv masiv të politikës shqiptare i cili ende hiqet zvarre ndër ne, prandaj i përjashtojnë vlerat e individit të kultivuar i cili ka ditur të luftojë pa hezitim për të realizuar vullnetin masiv për liri të plotë, për bashkim të etnisë të natyrshme territoriale, gjuhësore dhe historike të definuar.

Kjo është vlerë e pashuar e shqiptarizmit, mburrje për kombin në tërësi, nuk ka pësuar ndryshime ndër kohëra dhe hapësira tejet të egra kundër vullnetit tonë. Kjo vlerë historike është ngrehinë e ngulitur thellë në zemrën e shqiptarizmit, ka një përmbajtje për vetëmbrojtjen nacionale e cila siguron perspektivë të padiskutueshme, realizon të drejtat e lënduara historike, është prodhim i idealit të urtësisë masive shqiptare e përbotshme, realja e vetme për të realizuar nevojat masive kombëtare; ngjit lartë civilizimin shekullor që trashëgojmë historikisht. Ai ka të drejtë për ti dalë zot vetes, është absolut dhe nuk mund të manipulohet nga politikanë të kësaj dore.

Të bashkuar sigurojmë zhvillim të fuqishëm ekonomik, kulturor, politik, mbrojtje kombëtare, siguri për liri dhe barazi në integrimet e kombeve në Evropë. Është me interes të papërjashtueshëm për paqen e kombeve të Evropës e më gjerë. Kjo e drejtë ka konsensus të plotë mbarëkombëtar.

Parë nga aspekti juridik, kjo alternativë konsensuale përjashton kolonializimin. Gjendje e prodhuar për interesa hegjemone strategjike të fuqive të mëdha nga e kaluara e shekullit XX e cila ka kushtuar me miliona jetë njerëzish, varfëri permanente, prapambeturi ekonomike, politike dhe kulturore, dhe vazhdimisht armiqsira ndërnacionale dhe konflikte të gjëra me dimensione deri botërore.

Prandaj për politikanët tanë në tërësi del se mungesa strategjike e projekteve për bashkim nacional në këto tranzicione demokratike është në kundërshtim të rreptë me sigurinë e paqes në Ballkan, Evropë dhe më gjerë.

Për ta vërtetuar të vërtetën e mësipërme në aspektin juridik, me rezultatet e deritashme të eksperimentuara të shteteve multinacionale është ide e zvarritur komuniste e qeverisjes sllavo ruse, si ai i ish imperializmit rus dhe imperializmit jugosllav nga e kaluara e djeshme e të cilëve deri me shkatërrimin e tyre ishin kampe vrastare për lirinë e njeriut, kampe ekzekutimi të panumëruar, terrore të papara dhe varre të tëra të paemër. E gjithë kjo e keqe që pësuam del se shtetet multinacionale janë vazhdimësi, ngrirje dhe shkrirje të zhvillimeve demokratike shoqërore jostabile.

Prandaj vullneti gjithëkombëtar si ai shqiptar i cunguar kundër vullnetit të tij është i pamposhtur. Bashkimi i natyrshëm i tij është i domosdoshëm. Do të sjellë liri të plotë ndër trojet ballkanike dhe më gjerë; zhvillim të fuqishëm ekonomik, kulturor dhe barazi;

së treti, liri të sigurtë për zhvillim të gjithanshëm individual dhe kolektiv; së katërti me integrim natyral përfundimisht tendencat hegjemoniste në Ballkan nuk mund më të funksionojnë me sisteme gjenocidiale, bëhen të përjashtuara përfundimisht. Bashkimi i kombeve në Evropë është ardhmëri e sigurtë, paqe për kombet në tërësi. Kjo siguron taban kombëtar të dinjitetshëm, të sigurtë, të cilat kanë një emërues të bashkët: Kombi mbi të gjithë, vlerë madhore dhe imperative.

Ne si komb me vullnet gjithëkombëtar i mbesim besnikë për jetë të jetëve SHBA-ve, të cilat konstatuan objektivisht se si komb kemi qenë të okupuar nga osmanët, e pas shkatërrimit osman u flijuam për interesa të politikëbërjes së mbrapshë evro-ruse e ngarkuar me koncepte shtetërore atë kohë të shovenizmit krishterë në Evropë. U vërtetua definitivisht se Evropa e bashkuar duhet patjetër të çlirohet njëherë e përgjithmonë nga kjo e keqe e luftërave të pandërprera, prodhim i vullnetit evrorus. Shqiptarët ende terrorizohen nga interesat e sllavizmit serbogrek, për të realizuar kolonializëm në Evropë, me të vetmin qëllim që të mposhtin të drejtën e lirisë të vetëvendosjes së kombeve në Evropë. Shovenizmi i krishterizmit sllavorus dhe serbogrek dëshiron edhe më tej me strategjinë e saj të sundojë në Evropën juglindore duke i vënë popujt në armiqësi të pafund. Por, armiqësia e popujve nuk ka prodhuar kurrë vlera civilizuese për botën. Ato e shëmtojnë dhe e zhvlerësojnë gjithë vullnetin botëror të popujve për paqe, për mirëkuptim, mirëqenie dhe liri njerëzore.

Njeriu i këtij shekulli ka një vlerë të vetme si orientim përfundimtar të pakontestueshëm se paqja do të sundojë vetëm me lirinë dhe vetëvendosjen e lirisë së kombeve.

Skënderbeu, personazhi më i gjallë i gjithë historisë së shqiptarëve

(Vijon nga faqja 1)

Ndonjë mendje e robëruar, e pajisur me një guxim regresiv, përpiqet sot të tjetërsojë rolin e Skënderbeut në historinë tonë apo në historinë e qytetërimit Europian. Kjo është një përpjekje e mjerueshme, sepse historia nuk pranon leksione: ajo jep leksione. Hipotezat e humbasin terrenin përballë fakteve. Interpretimi kërkon moralitet të lartë dhe profesionalizëm.

Dokumentet arkivore, vlerësimet e bashkëkohësve si Papët e Romës, apo familjet mbretërore, me të cilat ai ishte në aleancë e bashkëpunim, ato të Humanizmit dhe Iluminizmit Europian, tekstet e historiografëve më në zë të kohërave janë për ne, një burim i ligjshëm krenarie dhe sasi e bollshme informacioni për një histori objektive të këtij burri, që u bë shpirti i historisë së Mesjetës. Mjafton të sjellim ndërmend Volterin, që nga katedrat e Parisit u kujtonte bashkëkohësve se: "Në qoftë se perandorët bizantinë do të kishin qenë Skënderbegë, Perandoria e Lindjes do të ishte ruajtur." Kjo për të kuptuar se sa i gjerë është areali Skënderbegian. Janë të shumta përkufizimet dhe vlerësimet për Skënderbeun si strateg, si njeri i politikës dhe i diplomacisë, por ne, shqiptarët e sotëm duhet të reflektojmë thellë, për "idealin e tij atdhetar, si një cilësi që edhe sot në kohët moderne, përcakton fizionomitë politike të burrave të shtetit".

Sot shqiptarët në të gjithë hapësirën ballkanike, e shohin Skënderbeun dhe Arbërinë e tij, si një model të madh integrues në familjen e popujve të Europës së bashkuar. Falë tij, historia jonë e asaj periudhe është pjesë e lavdishme e historisë së Europës e sigurisht Skënderbeu, një personazh shumë i spikatur i saj.

Sot Shqipëria po anëtarësohet në NATO dhe po bën hapa domethënës drejt BE-së, akte, të cilat unë i shoh të projektuara si dëshira të hershme të shqiptarëve për të jetuar në paqe, liri e siguri, brenda familjes natyrale që është Europa, të asaj familje, mbrojtës i së cilës ishte Gjergj Kastrioti Skënderbeu.

Brez pas brezi, dyert fisnike i gjejmë në rrugëtimin tonë nëpër histori, në kryengritjet anti-osmane, në Rilindjen kombëtare, në Lidhjen e Prizrenit, në shpalljen e Pavarësisë, në agun e shtetit të ri shqiptar, në Kongresin e Lushnjes dhe luftën e Vlorës, në konsolidimin e shtetit shqiptar, në Luftën e Dytë Botërore, në rezistencën anti-komuniste si dhe në ndërtimin e shtetit dhe shoqërisë demokratike.

Familjet e mëdha nuk u bënë të tilla vetëm nga rangu shoqëror, që trashëguan, apo pasuria, por mbi të gjitha për shërbimet, që bënë ndaj vendit në momente të vështira, kur prej tyre kërkohej sakrifica. Ato i dhanë çdo gjë kombit dhe nuk pretenduan të merrnin nga ai.

I shohim pasardhësit e këtyre familjeve, tek lënë shenjën e devotshmërisë ndaj atdheut dhe kombit kudo ku ata kontribuan gjatë konsolidimit të shtetit shqiptar të para luftës. Në debatin politik, në administratë, në diplomaci e ekonomi, ushtri e arsim duke sjellë përvojat perëndimore të vendeve ku u shkolluan.

Një fjalë e urtë shqiptare thotë se: "rrufeja bie mbi lisat e gjatë", dialektika e regjimit komunist ishte konfirmim i saj.

Goditja e elitave tradicionale, politike, intelektuale, ekonomike synonte të prishte komunikimin e popullit shqiptar me pikat e referimit. Komunistëve u duhej që të shpikej "Armiku i klasës apo i popullit" dhe për këtë stigmatizuan dyert e mëdha shqiptare. Si pasojë ata provuan asgjësimin fizik, burgun, internimin, konfiskimin e pronës, humbjen e të gjitha të drejtave, veprime këto me pasoja afatgjata të mirëmenduara.

Para se të jetë një titull hierarkik shoqëror, fisnikëria është diçka etike e brendshme, shpirtërore që mund të ndrydhet nga rrethanat, por nuk shuhet, duke na lënë trashëgim shembuj të rrallë lirie, rezistence e morali gjatë kohës së errët të diktaturës ndonëse paguan çmimin e gjakut.

Viti 1990 e gjeti këtë shtresë si komponentin më të vetëdijshëm, që kërkonte ndryshim dhe mbështesë e patjetërsueshme në ndërtimin e demokracisë.

Gjatë tranzicionit të gjatë, duke qenë pikërisht këto familje një pjesë e rëndësishme e të persekutuarve politikë dhe ishpronarëve, u ndeshën jo pak me iluzionin e drejtësisë në raport me të kaluarën, me iluzionin e rikthimit të pronës, me atë përfaqësimit politik dhe të integrimit në shoqëri, duke u bërë në disa raste pré e retorikës politike.

Megjithatë, ato dëshmuan se janë në lartësinë e traditës së tyre duke shprehur një cilësi të lartë demokratike, atë të tolerancës dhe besimit tek institucionet.

Personalisht në cilësinë e Kreut të Shtetit nuk do t'i resht përpjekjet që këto familje të gjejnë vetveten në shoqërinë shiptare, sepse Shqipëria, për t'u bërë më e mirë, si gjithmonë, ka nevojë për kontributin tuaj.

Fjala e Presidentit Bamir Topi në Konferencën Kombëtare "Familjet e Mëdha Fisnike Shqiptare", 17 janar 2009. Titulli është i redaksisë

ese

"A mendon se librat e tu dhe të bashkëmendimtarëve të tu do të mund të ndikojnë sado pak në rikthimin e një kujtese tjetër, e cila, është minimizuar aq shumë, sa duket e përlargët, a thua se 3-4 breza njerëzorë në diktatur na qenkëshin një sajesë e gojdhanave antike".



Kuvendim për misionet e papërmbushura

Nga **Agron TUFA**

Duke kaluar mespërmes Pjacës, u ndesha ballas me shkrimtarin dhe intelektualin e shquar L. F, si gjithmonë, të veshur sa thjeshtë, po aq dhe stil. Ndërsa zinim vend në një tavolinë të lirë buzë shatrivanit, desha ta pyes se pse në kombinimin e veshjeve të tij zotërojënë ngjyrat e kafta - nga të çelëtat gjer tek tonet e errëta. Sepse, gjykuar nga vitet e shumta të burgut që ka kaluar, pikërisht këtë ngjyrë ai duhej ta urrente, sikundër u ndodh atyre që kanë kaluar shërbimin e detyrueshëm ushtarak, të cilëve u përzien nga e gjelbra ushtarake. Nuk di pse e sprapsa këtë pyetje, ndoshta duke menduar se gjatë bisedës do ta sillte rasti i volitshëm, andaj, pas klisheve të zakonshme ritualore e pyeta, sa për të hapur bisedën, me një tjetër klishe:

- Me se po merresh këto kohë... kuptohet, përveç shkrimeve dhe analizave në shtyp?

- Me personazhet e burgut. A e di? Kam frikë se nuk do të kem kohë, ndërkaq po kuptoj se koha vërtet nuk do të më mjaftojë, edhe sikur të mos kisha detyrime të tjera dhe të merresha vetëm me ta.

- Mendon se kjo është ende një mënyrë bashkëkohore për të bërë letërsi?

- Si the? – u mundua të përqendrohej L.F.

- Desha të them: a mendon se ka kush interes të të ndjekë në ato tema?

- Epo pyetje më budallaqe s'më kishin zënë veshët... më fal, por ajo është jeta ime për shtatëmbëdhjet vjet... madje vitet më të çmuara të jetës sime. Si mendon ti, më plasi mua në i intereson kujt apo jo? Mos do të ishte më bashkëkohore të shtiresha sikur këto shtatëmbëdhjetë vite të burgut nuk kanë ndodhur fare?

- Jo, por, mendova se lexuesin tonë e kanë orientuar në përjetime të një natyre tjetër emocionale, si në romanet e... (këtu përmenda disa emra shkrimtarësh të socrealizmit, të cilët kanë qenë pjesë e gjyqit dhe e ekspertizave në dorëshkrimet e tij). Ti vetë e di se çfarë fati pësoi tek ne letërsia e burgut!

- Është tjetër hesap ajo, - u mbrojt duke nxjerrë të dyja pëllëmbët para L. F. – Unë nuk mund t'u shes dëngla romantike shqiptarëve, pavarësisht se në pazar nuk po ecka letërsia e burgut dhe pavarësisht se qeveritë tona kuazikomuniste i shpërfillin prej programesh.

- Atëherë kush do t'ju lexojë?

- Ore zotni, unë nuk po flas për kultivim kastravecash që të m'i blejnë medoemos... se libri, - i mëshoi fjalës ai, duke picëruar syrin e majtë, - libri do të lexohet nga 10-15 lexues, një ndër të cilët, fjala vjen, do të jesh ti. Më kupton? E pra, nëse e lexon ti, do t'ua rekomandosh edhe nja 10-15 të tjerëve, e kështu me radhë, gjersa për disa vjet, do ta lexojnë disa qindra e, ndoshta, një mijë vetë. Aq dua dhe unë, s'pretendoj më shumë.

- Të kuptohemi drejtë: a mendon se librat e tu dhe të bashkëmendimtarëve të tu do të mund të ndikojnë sado pak në rikthimin e një kujtese tjetër, e cila, siç po e sheh edhe vetë, është minimizuar aq shumë, sa duket e përlargët, a thua se 3-4 breza njerëzorë në diktatur na qenkëshin një sajesë e gojdhanave antike.

- Po si duket... askujt nuk i intereson të kthejë kokën prapa, të shohë, të mbajë flegrat hapur, duke ndjerë kutërbimin e qelbit që fryn nga plagët e asaj kujtese...

- Çdo të thotë kjo "nuk i intereson", kur, nga ana tjetër, lumi i gazetave të përditshme, me vrapin e tyre të pandalshëm mbajnë gjallë një kujtesë tjetër, atë të bëmave të diktatorit me suitën apo diavoliadën e tij, duke shpalosur një inventar të imtësishëm të të gjithë rekuizitës, që nga shërbetorët, gjellëbërësit, rrobaqepësit, rojat... të gjithë këto personazhe të krimbur në kujtime, kujt i "interesojnë"?

- Ja, tani na hape punë, - tha duke mërmëritur shkrimtari L.F. - Duhet thënë se çdo pushtet i pjellë nga gjiri i këtij populli, e vendos vetë se çfarë kujtese kolektive legjitimon. "Kujtesën tjetër" ai (pushteti) e bllokon nëpërmjet mekanizmave të vet në nivelin zyrtar dhe jozyrtar, përderisa "kujtesa tjetër" e kompromenton atë me ndërgjegjen aspak të lavdshme. Është pak a shumë si me njeriun, që aspektet e turpshme të privatësisë së tij i spraps në kujtesë, sepse, të jetosh me turpet e tua, është një ndjenjë jo komode. Të kuptohemi, nuk ka pushtet që ta shtrijë diktatin e vet mbi instrumentin individual të kujtesës. Kësisoj, nëse ke një kujtesë të përkundërt me atë që sundon në rrafshin kolektiv, ti mund ta mbash, madje mund të ngordhësh me të, por ama mekanizmi i regullatorit kolektiv ta nxjerr jashtë loje, d.m.th, nuk lejon t'i imponohesh.

- Megjithatë, kam përshtypjen, i nderuar L.F., se ju po i ngatërroni konceptet. Pse? Sepse pushtetet politike që dalin nga ky popull e kanë zanafillën në shtresa të caktuara shpqërore, apo jo?

- Po. E pastaj?

- Nëse, fjala vjen, pushtetet e së majtës janë pjellë e një elektorati të formësuar historikisht dhe të identifikuar me të privilegjuarit e PPSH-së, atëherë këto pushtete të majta do t'i hapin udhë, ose më saktë, do të stimulojnë kujtesën nostalgjike të bëmave të diktatorit dhe bashkpunëtorëve të tij, duke bllokuar, natyrisht, "kujtesën tjetër", pa e lënë këtë të diktojë botën e saj në kujtesën Kolektive. Pikërisht ky elektorat të "kënaqurish" nga komunizmi, ka prodhuar kundërpolin e tij me njërëz të pakënaqur, dyert e mëdha, nacionalistët, klasat e deklasuara, kulakët, etj., që kanë atë "kujtesën tjetër", të cilën, priren ta dëshmojë e s'ia dalin dot. Dhe pushtetet politike në qeverisje që janë pjellë e këtij elektorati, nuk kanë pse e bllokojnë atë "kujtesën tjetër", përkundrazi, mendoj se është në interesin e tyre ta mbështesin lulëzimin e kësaj kujtese të djathtë.

- Ndërsa vazhdon demarshi i kujtesës nostalgjike, të majtë, madje në pikun e lulëzimit të saj, megjithëse, në mos gabohem, qeverisemi nga një pushtet i djathtë... megjithëse nga të katër anët e botës na kërkojnë të dënojmë krimet e komunizmit. Kështu? Më duket se të kuptova drejt, apo jo? Por, siç e dimë, shtypi ynë është i lirë dhe asnjë pushtet nuk mund t'i imponojë atij se çfarë kujtese duhet të dëshmojë, apo jo? Pronarët e këtij shtypi mbajnë gjallë me këtë kujtesë nostalgjik një lexues nostalgjik, i cili na rezulton të jetë i shumtë, derisa përditë blihen këto speciale me bëmat dhe thashathemet mbi diktatorin dhe rekuizitën e tij. Si t'ia bëjmë?

- Si t'ia bëjmë? T'i kundërvihemi kësaj kujtese të turpshme e të pamoralshme me një formë efikase. Pushteti i së djathtës, vërtet nuk mund t'i imponojë shtypit të lirë ndalimin e kësaj sage të pandalshme, anipse sanksione mund të vendosen, duke i klasifikuar këto përrenj nostalgjikë si recidive të komunizmit, ndërkohë që Europa na kërkon të dënojmë pikërisht krimet e komunizmit. Të klasifikohen këto recidive të barazvlefshme me recidivet e nazizmit...

- Kaq?

- Si fillim kaq. Me tej, qeveritë e djathta mund të projektojnë një platformë të studiuar mirë me një aktivitet serioz botimesh në kolana ku të botohen të sistematizuara veprat që dëshmojnë "kujtesën tjetër", kujtesën e rezistencës ndaj diktaturës, të martirizimit nëpër burgje, kampe përqendrimi, internime, persekutime, procese gjyqësore e pushkatime, memuare, ditare, epistolare. Vetëm kështu mund të dëshmohej në mënyrë koherente ekzistenca e një kujtese të dhimbshme, porse tepër dinjitoze. Mandej këto vepra të promovoheshin duke u bërë pjesë e një diskursi të gjerë intelektual e publik, ngjashëm me, fjala vjen, veprën e At Zef Pllumit "Rrno vetëm për me tregue". Madje, sensibilizimit mund t'i paraprinte përfshirja e veprave më të mira të këtij zhanri në leximet e detyrueshme shkollore e universitare. Kjo do t'ia shtonte identitetin e trashëgimisë gjithë spektrit të politikës së djathtë në Shqipëri.

- Interesante, - tha, duke picëruar syrin e majtë shkrimtari L.F. – Teksa të dëgjoja ty, po mendoja se sa i thjeshtë ka qenë për t'u realizuar ky projekt që në vitin 1992 e këtej, po a e di ti mor i dashur, se këta, kinse të djathtët tanë, jo vetëm nuk e çajnë menderen për kësi gjerash, por s'po na japin as shpërblimin e viteve të burgut. E more vesh ti? Kanë djegur skemën e shpërblimit për ish- të dënuarit politikë, je në vete! Si i thua ti kësaj?

- Unë i them kësaj: të presësh degën mbi të cilën qëndron. Sepse votat në votat e këtyre njerëzve bazohet ekzistenca e së djathtës. Dhe po me këta njerëz sillet në mënyrën më të pashpirt: i braktis, u tadhëton interesat, nuk i përkrah, qeveris me njerëz me të shkuar komuniste dhe, që të gjitha këto, janë forma të alternuara të përbuzjes. Si shpjegohet prania kaq e dendur e njerëve me origjinë puniste në instanca të larta të qeverisjes së djathtë? Sepse po na dalin të gjithë drejtuesit, me këshilltarë e ministra, që të gjithë, bij komunistësh të shquar...

- Dihet kjo tashmë: Berisha e ka parë gjithmonë me platonizëm këtë kontigjent dhe kjo dobësi, për mendimin tim, na çon në një moment të errët të zanafillës së opozitës shqiptare. Ne nuk e dimë se si ka qenë "nata e themelimit" të kësaj partie, ose më mirë, "nata e bigëzimit" të partive politike të opozitës së parë shqiptare.

- S'ka rëndësi... kush kërkon, mëson dhe artin e leximit mes rreshtash; por një gjë më bën përshtypje të zymtë: nëse Partia Demokratike mori përsipër një mision të madh në historinë tonë – të bashkojë forcat e djathta nën kauzën antikomuniste, tani, pas kaq vitesh, bëhet e qartë se ajo ka tradhëtuar pikërisht këtë kauzë, duke marrë më qafë ndoshta forcat më progresive të shoqërisë sonë, më të sinqertat e më të pafajshmet.

- Vërtet, ju thatë diçka thelbësore dhe unë, megjithëse jam një liberal i majtë në bindjet e mia (por të mos ngatërrohemi, jam liberal i majtë në atë kuptim që ka ky togfjalësh në realitetin botëkuptimor europian, jo në surrogatin shqiptar), pra, edhe pse i majtë, mendoj se formacinet klasore të djathta në Shqipëri janë tradhëtuar, shfrytëzuar dhe përbuzur, gjersa, duke kaluar në një opozitë të gjatë tetë vjeçare, ashtu të flakur e të papërkrahur, janë tëhuajësuar politikisht dhe ekonomikisht, me një vitalitet tashmë të vyshkur. Ky është një varfërim tragjik i peisazhit tonë politik...

- E pra, këto shtresa u tradhëtuan, pa e formësuar fizionominë dhe identitetin e tyre. Ato u braktisën shi në atë kohë kur pritej të realizonin misionin e tyre historik, duke krijuar, e mandej thelluar një boshllëk të llahtarshëm edhe tani, gjashtëmbëdhjetë vjet pas rënies së diktaturës. Dhe ky boshllëk në përfaqësimin politik të realitetit tonë shoqëror është mungesa e një partie antikomuniste. Një parti e tillë do të kishte mundur të realizonte një mision të domosdoshëm në realitetin shqiptar, por, ajme...

- U sabotua?

- Kjo ndoshta është fjala më e saktë që i shkon përshtat.

Na shkruajnë...

XHAFER SEITI, prefekt i Qarkut Dibër shkruan: *"Me kënaqësi e kureshtje lexova librin e Zotit Bashkim Lleshi "Gjeologjia e Rrugës së Arbërit" dhe në fund të leximit një numër i konsiderueshëm mbresash u memorizuan në kujtesën time. Kureshtja nuk vinte nga fakti që ishte materiali i parë që lexoja të shkruar nga pena e zotit Lleshi. Përkundrazi, kam patur rastin të lexoj mjaft shkrime të tjera që me pak fjalë do t'i konsideroja "me logjikë të rrjedhshme, bindës, plot argumenta e trajtim dinjitoz shkencor". Duke e konsideruar zotin Lleshi si një nga pionierët nismëtarë të formulimit të idesë për domosdoshmërinë e ndërtimit të Rrugës së Arbërit dhe me kontribut të çmuar konkret në realizimin e kësaj ideje, si Prefekt i Qarkut të Dibrës, si një njeri që për shkak të detyrës, por dhe përgjegjësisë morale për një jetë më të mirë të banorëve të trevave të Qarkut të Dibrës, kam dhënë një ndihmesë modeste në nxitjen e instancave dhe strukturave vendimarrëse për realizimin e këtij projekti të madh tashmë në startin e tij të pakthyeshëm, sinqerisht dua që nëpërmjet gazetës "Rruga e Arbërit" të falenderoj zotin Bashkim Lleshi për punën e bërë jo vetëm në kornizat e një libri, por dhe përtej tij, për gjithë gamën e veprimtarisë e përkushtimit në dobi të njerëzve duke i uruar njëkohësisht arritje të tjera po kaq cilësore në fushën e studimeve dhe garantuar se bashkëpunimi im si Prefekt do të jetë korrekt e i vazhdueshëm për të gjitha problemet e me përparësi ato që kanë të bëjnë me Rrugën e Arbërit".*

Shkruan ODISE PLAKU: *Ju uroj shume suksese ne kete vit dhe me shkrime akoma me interesante. Jam nje lexues i rregullt i gazetes tuaj permes internetit. Shpresoj se afermi tju dergoj disa poezi per botim nese deshironit. Kam botuar disa vellime ne poezi dhe proze si dhe vene ne skene monodramat "Klithma e nje nene te marre" interpretuar nga Hajrie Rondo dhe vleresuar me cmimin e karrieres ne festivalin e monodrames shqiptare ne vitin 2006. Ne 2008 u vu ne skene monodrama "Velloja e bardhe" interpretuar nga aktorja Zamira Kita dhe drama "Ylli i Mengjesit" nga trupa e teatrit "Migjeni" ne Shkoder.*

"Figura e atdhetarit Fuad Dibra të na shërbejë si shembull të vetëdijesohemi e të bashkohemi në zgjedhjen e rrugës së drejtë në këto çaste vendimtare për kombin tonë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Kosovë Lindore (Luginë e Preshevës), Mal Të Zi e Çamëri."

FUAD DIBRA - PATRIOT I SHQUAR PËR SHQIPËRINË ETNIKE (1886-1944)

PËR ÇËSHTJEN SHQIPTARE SHKRIU JETËN DHE PASURINË



Nga **REXHEP TORTE**



Përkundër interesimit tonë nuk kemi arritur të gjejmë qoftë edhe një fotografi të këtij personaliteti kombëtar me bëma të mëdha. Ky tekst le të shërbejë edhe si apel për ata që kanë ose dinë për ndonjë fotografi të Fuad Dibrës.

PERSONALITET QË RREZATON SHËMBËLLTYRË

Në turbulencat që po përjeton sot lidershipi shqiptar në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, kur pa përjashtim partitë politike shqiptare në vend të afrimit dhe të shtrëngimit të duarve, kanë drejtuar gishtërinjtë e shtangur për t'ia nxjerrë sa më thellë sytë njërit- tjetrit, duke ndarë popullin shqiptar copa- copa, kur gogolat nga brenda dhe shtetet fqinje rreth nesh gëzohen dhe fërkojnë duart, duke i parë me sehir zënkat tona, me shpresë se do të rrjepin edhe pak nga territoret tona, nga gjaku ynë, apo nga shkelja e të drejtave tona, sot kur ne më shumë se kurdoherë lypset të mësojmë nga historia jonë, për të konsoliduar forcat dhe energjitë tona, aty ku mbrohet, ruhet e ndërtohet dinjiteti ynë mbarëkombëtar, vendosëm të paraqesim para opinionit tanë lexues, Fuad Dibrën, patriotin e shquar nga Dibra e Madhe, patriotin dibran dhe mbarëshqiptar (1886-1944),për të na qenë shembëlltyrë dhe për të parë se si duhet punuar dhe sakrifikuar për kombin tonë të përvuajtur,për të mos na u përsëritur gjërat, dhe se si duhet të sillemi, po qe se vërtet ia duam të mirën kombit dhe vetes sonë.

Fuad Dibra, ky patriot dibran dhe mbarëshqiptar me shpirt martiri për çështjen kombëtare shqiptare, shkriu tërë pasurinë e madhe që kishte, refuzoi ofiqet mashtruese, dhe në Konferencën e Paqes në Paris më 1919-1920, ku u arrit që Shqipëria të njihet si shtet i pavarur, vuri në dispozicion dhe harxhoi më shumë se 500 mijë franga ari.

Kjo fytyrë e lavdishme e patriotizmit dhe e atdhedashurisë shqiptare, si gjithnjë edhe sot shndrit me shëmbëlltyrën e saj, kur të gjithë duhet të bëhemi si një grusht i vetëm, e t'i tregojmë botës seriozitetin tonë për kauzën mbarëshqiptare, sepse ende nuk e kemi punën të sillemi komodë, krahas këtyre rreziqeve që i kemi pranë.

E pashë të udhës të vë dritë në figurën e patriotit Fuad Dibra, që të na shërbejë si shembull të vetëdijesohemi e të bashkohemi në zgjedhjen e rrugës së drejtë në këto çaste vendimtare për kombin tonë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Kosovë Lindore (Luginë e Preshevës), Mal Të Zi e Çamëri..

SAKRIFICA PËR SHTETIN ETNIK SHQIPTAR

Fuad Dibra u takon figurave më të shquara të patriotëve të denjë dhe të pastër që për Shqipërinë e Pavarur Etnike shkriu tërë pasurinë e tij të madhe, tërë arin, shkriu jetën e tij, dhe nga Shqipëria as mori e as kërkoi gjë. Ky burrë mbi burra, siç e quan populli, tërë jetën e tij ia dedikoi popullit dhe kauzës së Shtetit Etnik Shqiptar, duke sakrifikuar dhe duke mos pritur që të jetë atje ku e lypte nevoja dhe të sillet ashtu si e lypte nevoja e popullit, ku bisedohej për vendosjen e bazave të shtetit shqiptar.

Kur shqiptarët me karakter të lig asokohe vraponin pas posteve dhe pasurisë, duke grumbulluar pasuri mbi pasuri dhe ar mbi ar, Fuad Dibra zgjodhi rrugën e drejtë e të ndershme të atdhedashurisë dhe të patriotizmit, duke u përpjekur gjer në vetëmohim për shqiptarët e Shqipërinë, duke luftuar kundër cungimit dhe grabitjeve të tokave shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër më 1912-1913 dhe në përsëritjen e kësaj padrejtësie në Konferencën e Paqes në Paris me 1919-1920. Këto ngjarje e tronditën pamasë shpirtin e Fuadit, i cili me me ngulm vazhdoi përpjekjet e tij për t'i bashkuar shqiptarët rreth një programi, siç thoshte ai, "të aftë për të siguruar shpëtimin tonë kombëtar, konkretizimin e ëndrrës së qindramijëra martirëve të kombit për realizimin e të drejtës për Shqipërinë Etnike dhe për ta shpëtuar nga kthetrat grabitqare të fqinjëve". Ai ishte më se i bindur dhe i patundshëm për plotësimin e këtij ideali të shenjtë dhe thoshte: "Do ta bëjmë Shqipërinë me kufijtë e saj etnikë patjetër, pse edhe sikur Evropa të dëshirojë me na i dhunuar të drejtat tona legjitime, na të bashkuar rreth flamurit të Kastriotit, do të jemi një bllok i pathyer që me fuqinë e armëve tona do t'i fitojmë vetë të drejtat që na takojnë".

Fuad Dibra ithtar dhe lëvrues i palodhshëm për Shqipërinë Etnike, në krye të Kolonisë së Shqiptarëve të Stambollit shkrinte pamëshirë çdo gjë që kishte, edhe pasurinë e tij shumë të madhe, për të mbrojtur të drejtat e shqiptarëve dhe të Shqipërisë kudo në Evropë, dhe su pendua asnjëherë. Ky martir edhe në momentet e fundit të jetës së tij na len tri porosi : " Me u bashkuar tërë shqiptarët rreth një ideali të vetëm, rreth realizimit të shtetit tonë etnik shqiptar, me u vëllazëruar dhe me u bashkuar në mënyrë të përsosur, që përçarjet e nxitura nga propagandat e huaja, të cilat mundohen drejtpërdrejt të na ndajnë, të mos munden me gjetur vend ndër ne, dhe së fundi, me çfarëdo çmimi të jetë, me përmbushur idealin e konkretizimit të Shqipërisë s'onë Etnike. Këto porosi të trashëguara prej martirëve brez pas brezi, do t'i dëgjojnë me krenari dhe shpresë zogjtë e shqipes", thoshte Fuadi.

Qeveritë e shumta që shkonin e vinin në Shqipëri kërkonin bashkëpunimin dhe rënien dakord të Fuad Dibrës për poste të ndryshme, bile edhe me lutjet direkte të drejtuesve italianë, mirëpo shpirti i pastër dhe patriotik i Fud Dibrës, i refuzoi të gjitha dhe asnjëherë nuk u dakordua që të vihej në shërbim të të huajve. Kjo sjellje e tij prej patrioti bënte jehonë të madhe dhe ngushëllonte zemrat e motrave shqiptare të mbetura pa vëllezër, të nuseve pa burra dhe të nënave pa djem, të cilët kishin dhënë jetën e tyre për mbrojtjen e atdheut.

PËRPJEKJE PËR T'I AFRUAR SHQIPTARËT RRETH NJË PROGRAMI

Deri në fund të jetës së tij ai punoi për bashkimin e trojeve shqiptare, për bashkimin e tërë shqiptarëve, "se të drejtat tona mund t'i fitojmë vetëm po të jemi të bashkuar", thoshte ai.

U lind në Dibër të Madhe në vitin 1886 dhe qysh në moshën e re u vu në radhët e lëvizjes kombëtare shqiptare ku bënte pjesë edhe i ati Ismail Pasha, deputet i Dibrës në Parlamentin turk, i cili ishte njëri nga personalitetet e para dhe organizues i Kongresit të Dibrës më 1909, që u mbajt në shtëpinë e tij, ku morën pjesë delegatë nga të gjitha vendet shqiptare, dhe ku u morën vendime të rëndësishme për fatin e ardhmërisë së kombit shqiptar. Ismail Pasha ishte patriot i dëshmuar dhe me pasurinë e madhe të trashëguar radhitej si njëri nga zengjinët më të mëdhenj të Ballkanit.

Fuad Dibra pasi mbaroi shkollën fillore në vendlindje shkoi te i ati në Selanik, ku mbaroi shkollën e mesme dhe studimet universitare – fakultetin e drejtësisë në Selanik dhe Zvicër. Babë e bir influencën e tyre në mesin e pasanikëve e përdorën për t'i dhënë shpirt çështjes kombëtare shqiptare. Fuadi me pjekurinë e tij universitare që dispononte, bashkë me të atin Ismail Pashën, bënë një veprimtari të madhe edhe për organizimin e Kongresit të Manastirit, ku u vendos fati i alfabetit shqip. Lufta që u bë në këtë kongres për të bindur pjesëmarrësit për përdorimin e gjuhës shqipe, për nga forca i ngjante luftës së pushkës, dhe askush nuk e përdori këtë armë morale më shumë dhe më bukur se sa Fuad Dibra, për t'i bindur ata që preferonin alfabetin arab në vend të atij shqip. Ky patriot veç ndihmës morale, çështjen shqiptare e ndihmonte edhe materialisht, duke përballuar shpenzimet e aktiviteteve të shumta, ose duke blerë lokale për mbajtjen e mbledhjeve të ndryshme me rëndësi historike kombëtare. Ndoqi me vëmendje lëvizjen e Xhon Turqve dhe shpejtonte të përfitonte nga rasti i krijuar në horizontin ballkanik, duke ndje nevojën se duhet vepruar shpejt para se të bëhet vonë. Punoi aktivisht me delegatë të ndryshëm dhe organizoi e financoi dy komisione të kryesuar nga Haxhi Ismail Manastiri dhe Haxhi Vildani ku merrnin pjesë figura të shquara si Abdyl Ypi, Fadil Pashë Toptani, Fuad Pashë Prishtina dhe Ali Pashë Velikarda, që shëtitën anekënd trojeve shqiptare dhe përgatitën terrenin për reformat e Kongresit të Manastirit dhe për veprimtari tjera mbarëkombëtare shqiptare.

MË SHUMË SE GJYSMË MILIONË FRANGA ARI PËR MBROJTJEN E ÇËSHTJES SHQIPTARE

Pas vdekjes së tet, Fuadit i propozuan të vinte kandidaturën për deputet në parlamentim turk, por ai nuk pranoi.

Si edhe shumë herë tjera në vitin 1921 nuk pranoi ofertën e Kabinetit të Sulejman Delvinës për postin e ministrit.

Nuk duhet të lëmë pa përmendur edhe vitin 1913, kur dibranët ishin të detyruar nga masakrat serbe t'i braktisin shtëpitë e tyre, ndërsa Fuadi u ndihmoi të gjithëve si vëlla dhe mik, duke ua lehtësuar dhembjen.

Menjëherë pas Luftës së Parë Botërore vazhdoi me vrull aktivitetin e tij patriotik në Koloninë Shqiptare të Stambollit dhe me përkrahjen e tij materiale. U themeluan shumë klube dhe u hapën shkolla shqipe me 450 nxënës shqiptarë, në krye të të cilëve ndodheshin mësuesit si Riza Drini, Mumtaz Kokalari, Nesip Voshtina, Qemal Baci etj.

Kolonia Shqiptare e Stambollit dërgoi delegacionin e saj në Konferencën e Paqes në Paris që u mbajt më 1919-1920, të kryesuar nga Fuad Dibra ku merrnin pjesë anëtarët Halil Pashë Gjirokastra, Mihal Shan Tepelena, Pier Bonati dhe Benedik Bilishti. Këtu kishin ardhur edhe përfaqësues të Kolonive tjera shqiptare nga Amerika, Rumania dhe trojet e tjera shqiptare. Me këtë rast Fuad Dibra vuri në dispozicion dhe harxhoi më shumë se gjysmë milionë franga ari për mbrojtjen e çështjes kombëtare shqiptare. Në Paris të deleguarit qëndruan 17 muaj me shpenzimet e këtij patrioti, dhe pas shumë peripecive të krijuara nga shtetet e mëdha dhe armiqtë, u arrit në këtë Konferencë të Paqes në Paris dhe nga Lidhja e Kombeve, që Shqipëria të njihet si shtet i pavarur, por nuk u arrit për fat të keq që të ndreqeshin padrejtësitë që ishin bërë me copëtimin e tokave shqiptare nga Kongresi i Berlinit më 1878, dhe nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër më 1912-1913.

Duke shkrirë tërë pasurinë e vet për çështjen kombëtare dhe duke mos pranuar postet joshëse të ofruara nga të huajt, Fuad Dibra u dha të kuptojnë të gjithëve, se duhet të dallohet vullneti për t'i shërbyer atdheut nga ambiciet për pozitë. Ai ishte shumë i pasur, por kur çështja kombëtare shqiptare u vu në tryezën e negociatave të Fuqive të Mëdha, nuk u hamend fare dhe nuk nguroi të sakrifikonte, duke u hedhur në luftën e tmerrshme dhe të padrejtë që i bëhej atdheut të tij të dashur, duke luftuar si hero gjersa shkriu tërë pasurinë e tij, për një Shqipëri Etnike. Këtë parim e ndoqi gjatë tërë jetës së tij, por edhe në Konferencën e Paqes në Paris më 1919-1920 dhe në Komitetin Kombëtar të Kongresit të Lushnjës.

Populli shqiptar e din fare mirë dhe nuk do ta harrojë kurrë, rolin që luajti ky patriot në çastet kur ishin në lojë fatet e Shqipërisë.

Biografëve të Fuad Dibrës iu desh shumë kohë për ta bashkërenditur rrugëtimin e këtij patrioti, sepse ky bënte punë të mëdha, por nga ana tjetër ishte shumë modest, duke i dhënë atdheut gjithçka, e duke mos kërkuar asgjë prej tij.

Kjo shëmbëlltyrë e shqiptarizmit si parim nuk pranonte kurrë tu jepte ndonjë shënim gazetarëve për jetën e tij dhe për veprimtarinë atdhetare. Megjithatë për veprimtarinë e tij hasim shkrime të shkruara nëpër gazeta, por edhe më shumë tregonin shokët dhe miqtë e tij, për këtë patriot me shpirt graniti që me vendosmëri të pashoqe nuk u lodh së kontribuari për atdheun, për Shqipërinë e Pavarur dhe Etnike në trojet e veta shekullore.

Në fund të jetës së tij Fuad Dibra u kthye në atdhe. Ndërroi jetë më 22 shkuet të vitit 1944 në Tiranë, ku iu bë një varrim madhështor dhe e qau i tërë populli me lot në sy dhe me dhembje të thellë në zemër, sepse u nda përgjithmonë nga luftëtari i palodhshëm për të mirën e atdheut.

Përkundër interesimit tonë nuk kemi arritur të gjejmë qoftë edhe një fotografi të këtij personaliteti kombëtar me bëma të mëdha. Ky tekst le të shërbejë edhe si apel për ata që kanë ose dinë për ndonjë fotografi të Fuad Dibrës.

emigracion

"Me Dibrën më lidh shpirti, zemra. Atje kam lindur, atje jam rritur. Atje i kam tërë kujtimet dhe ëndrrat e mia. Sa herë shoh ëndrra në gjumë, atje shkoj. Nuk mund ta shoh në vend tjetër."

ME DIBRËN MË LIDH SHPIRTI, ZEMRA...



Nga: **ABDURAHIM ASHIKU**

Ierapetra është qyteti më jugor i Greqisë, madje edhe i tërë Evropës. Prej portit të tij të vogël shkohet më shpejt në Tripoli të Libisë se sa në Pire. Është vendosur në qendër të një bregdeti me gjatësi 51 kilometra, bregdetit më të bukur të ishullit të Kretës, me një rërë të pastër e të imtë si rërat e bregdetit të Shqipërisë, nga Vlora në Velipojë...

Në Ierapetra jeton një komunitet goxha i madh emigrantësh shqiptarë, komunitet me njerëz të nderuar në sajë të punës dhe kulturës së jetesës, një komunitet që ka fituar dashurinë dhe respektin e banorëve por edhe të komuniteteve të tjera që punojnë e jetojnë tashmë prej vitesh këtu.

Në udhëtimin tim katërditor nëpër qytetet e ishullit të madh të Kretës takova disa dibranë, njerëz të nderuar dhe të respektuar nga vendasit dhe nga emigrantët nga të gjitha trevat shqiptare. Disa prej tyre do të jenë në serialin e udhëtimit katërditor në "Polin jugor" të Greqisë...

...Shkëlzen Muça mu prezantua se është nga Ostreni i Vogël, fshati i bukur gollobordas me shtëpitë "një mbi një", me çatitë në Testikamen e themelet në gurrën ujëftohtë...

Kohët e fundit hapat e mia në hapësirën greke më kanë çuar çuditërisht në takime me ostrena-voglas. Dhe të gjithë në breg të detit, në Sarantin e Thivas dhe në Ierapetran e Kretës, tek fisi i nderuar i Suleve dhe tek ai i Muçeve...

Dhe në të gjithë rastet ata do të më merrnin e ngjisnin në "tetëqind metra lart", në Ostrenin e Vogël, për të mbushur duart me ujin e gurrës, për të m'i ngjyer ato me lëngun e freskët të arrave e shpuar me gjembat e boçeve të gështenjave...

Shkëlzen Muça do të më befasonte në atë udhëtim të shkurtër nga bregdeti tek pallati i sportit i Ierapetrës kur biseda do të sillej rreth jetës së tij, jo thjesht si emigrant por si pjesë në hallet e tyre, si motor i zgjidhjes së tyre...

Ja biseda që fiksova me të...

* * *

- Ju jeni drejtues i një shoqate. Si quhet ajo?

- Emri i shoqatës sonë quhet "Shoqata Skënderbeu". I kemi vënë këtë emër sepse Skënderbeu është Hero i gjithë Kombit Shqiptar dhe përfshin të gjitha trevat e shqiptarëve. Janë bërë shumë shoqata në Greqi të cilat janë shoqata krahinore. Ne nuk donim që të kishim një shoqatë të tillë ndaj edhe bëmë një shoqatë që të përfshijë të gjithë shqiptarët.

- Cila është hapësira, gjeografia e shoqatës suaj?

- Shoqata jonë është në skajin e Kretës, në rrethin e Lasifit siç quhet këtu dhe përfshin vetëm këtë rreth. Nuk kemi hapur celula të shoqatës sonë në rrethe të tjerë për shumë arsye. Në radhë të parë jemi familjarë, kemi punë, nuk kemi edhe kohë shumë që të merrem më gjerë. Kjo se, siç e dini, puna e shoqatave është punë vullnetare. Nuk investohet ose paguhet nga dikush. Ato që konsumojmë, sa t'i konsumojmë në familje, merremi me punët e ndryshme, me hallet e patriotëve tanë.

- Çfarë veprimtarish ka shoqata?

- Shoqata jonë është krijuar këtu e katër vjet e pak. Në pranverë mbushim pesë vjetorin e shoqatës. Gjatë kësaj periudhe ka kryer disa veprimtari të lidhura me lehtësimin e qëndrimit të shqiptarëve, problemet që kanë pasur me dokumentet, me sqarimin se si duhet t'i plotësojnë ato, ditët e punës etj. Kemi pasur probleme me ata që janë të siguruar në bujqësi. Këtu u bë një allishverish. Secili duhet të paguante 20 euro, të gjithë refugjatët, shqiptarë, bullgarë e të çdo kombësie, për të plotësuar ditët e punës. Këtë ata nuk duhet ta paguanin. Kjo është detyrë e përfaqësuesit të OGA – s të zonës dhe e pronarit që e merr përsipër. Nuk duhet të paguante askush lekë për këtë punë. Për këtë shkuam deri në Ministri të Bujqësisë në Athinë. Ata na thanë që nuk duhet të paguani. Na kërkuan një ankesë me shkrim. E bëmë, e dërguam atë edhe në kryeministri, iu drejtuam edhe ambasadës për njoftim. Morëm përgjigjen me shkrim nga Ministria e Bujqësisë në të cilën thuhej se nuk kanë të drejtë t'ju kërkojnë lekë. Që atëherë ndryshoi diçka, por prapë nuk donin që ta ulnin kokën dhe ta pranonin. Arritëm sa u bëmë edhe denoncim. U shkri ajo si shoqatë se ishte shoqatë e bujqësisë, greke, e cila merrte rreth 60 – 70 mijë euro në vit pa të drejtë. U shkri, u riorganizua si shoqatë por nuk marrin më lekë.

Në lidhje me dokumentet, me zvarritjet që bëhen kemi bërë ankesa të ndryshme. Disa i kemi zgjidhur dhe disa ende jo. Kjo sepse ankesat tona shpesh herë bien në vesh të shurdhër, humbin nëpër sirtarë. Na thonë keni të drejtë, do t'i zgjidhim, çfarë të bëjmë, personel nuk kemi dhe të tjera justifikime.

Në krahasim me zonat tjera, me sa kemi dëgjuar, prapë themi që jemi më mirë, më pranë njerëzve dhe halleve të tyre.

- Sa shqiptarë ka në Ierapetra dhe në tërë rrethin e Lasifit?

- Vetëm bashkia e Ierapetrës ka rreth 6000 – 6500 shqiptarë. Prej këtyre rreth katër mijë janë me dokumente të rregullta.

- Cila është veprimtaria e tyre?

- Shqiptarët këtu bëjnë punë të ndryshme. Merren me bujqësi, me ndërtim, me tregti, turizëm, me çdo gjë. Kryesisht merren me bujqësi, ndërtim dhe shërbime në shtëpi e në turizëm.

- Më thatë pak më parë që shqiptarët merren edhe me administrimin e serrave për prodhimin e perimeve...

- Po. Këtu e disa vite, rreth 7 – 8 vjet, shumë shqiptarë morën përsipër administrimin e serrave. I kanë marrë me qira. Kjo sigurisht jo në dëm të grekëve por në fitim të tyre. Ata paranë e marrin të pastër, pa asnjë lloj mundi e problemi. Shqiptari, siç e dini, si puna e shqiponjës që donë të fluturojë e lirë, të mos ketë njeri mbi kokë, merr përsipër riskun. Është risk vërtet që mund të të çojë në të mirë por edhe mund të zhytesh.

Këtu e dy vjet diskutonim që veprimtarinë e tyre bujqësore ta shfrytëzonin vetë. Prodhimet e tyre të serave shkonin në kooperativat tregtare të grekëve, shiteshin atje. Atje puna dhe djersa e tyre zhvleftësohej në sajë të përqindjeve që merrnin ata dhe në sajë të tendencës për çmime të ulëta të grumbullimit. Që ata të mos e humbasin përqindjen dhe që prodhimi i tyre të vlerësohej mirë, u organizuan vetë. Kjo u arrit vitin e kaluar. Me përpjekjen dhe ndihmën e tyre dhe të shoqatës. Është krijuar ndërmarrja e tyre e mbledhjes dhe përpunimit të prodhimeve bujqësore ku vijnë tregtarët e shumicës dhe e marrin. Vjet, si viti i parë, vit i sakrificës, guximit dhe mëdyshjes, gjithçka doli me sukses dhe këtë vit e kanë nisë përsëri hapin. Në behar serat nuk punojnë. Jam i sigurt se do të ecim shumë mirë.

- Kanë drejtues këta organizime?

- Kuptohet. Kryetar është një djalë nga Korça, Thanas e quajnë. Nënkryetari i shoqatës sonë "Skënderbeu" është njëkohësisht edhe nënkryetar atje. Shumë pjesëtarë të shoqatës merren me sera.

- Me Dibrën të lidh gjë?

- Me Dibrën sigurisht që më lidhin shumë gjera. Më lidh shpirti, zemra. Atje kam lindur, atje jam rritur. Atje i kam tërë kujtimet dhe ëndrrat e mia. Sa herë shoh ëndrra në gjumë, atje shkoj. Nuk mund ta shoh në vend tjetër.

- Ku i keni njerëzit e familjes?

- Tani i kam në Durrës.

- Kë keni atje?

- Kam babanë dhe mamanë, prindërit. Kam edhe një motër të martuar atje. Një vëlla e kam në Angli, një vëlla tjetër dhe një motër i kam në Athinë. Jemi të larguar pothuajse të gjithë. Në Dibër ne jemi fis i madh. Atje kam një hallë dhe një gocë tezeje.

- Ku i keni?

- Në vendlindje, në Ostren të Vogël. Të tjerët janë larguar. Disa në Elbasan, të tjerë në Tiranë e Durrës, të tjerë nëpër Evropë. Shumë janë edhe në Greqi.

- Cila është familja juaj e ngushtë?

- Jam me gruan. Kam edhe dy çuna. Gruan e kam nga Fieri. Me origjinë është nga Çamëria.

- Ndonjë gjë tjetër?

- Para tre vjetësh një djalë nga fshatrat e Elbasanit u mbyt nga gazi në dhomën ku banonte. Nga të ftohtit ngrohej me gaz. Kishte ndodhur që një natë të rridhte gazi dhe ai vdiq. U mblodhëm të gjithë sa ishim, mblodhëm kush pak e kush më shumë lekë dhe e dërguam trupin e tij në Elbasan. E shoqëruam edhe me një njeri që ta përcillte dhe të shprehte ngushëllimet në emër të të gjithë shqiptarëve të Ierapetrës.

- Si i keni marrëdhëniet me vendasit?

- Shumë të mira, na nderojnë dhe na respektojnë për punën dhe kulturën e sjelljes dhe të jetesës. Po ju jap një shembull. Dola dhe fola në radion lokale për ardhjen e Ansamblit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore Shqiptare. Më kishte dëgjuar në atë moment kryetari i shoqatës së prodhimit të luleve, Jorgos Markaqis. Hyri menjëherë në linjë dhe tha se lulet për këtë veprimtari janë dhuratë nga shoqata jonë. Ka sjellë rreth dyqind trëndafila...

Ierapetra, Kretë, tetor 2008

Janë në qarkullim nga shtëpia botuese "M&B"



Botimet "M&B"
ISBN 978-99956-04-19-6
Çmimi: 700 lekë

Mund ti porosisni
me tel:
+ 355 4 2 233 283





Botimet "M&B"
ISBN 978-99956-04-14-1
Çmimi: 500 lekë

Mund ti porosisni
me email:
mbbotime@gmail.com

Botimet "M&B"
ISBN 978-99956-04-12-7
Çmimi: 1000 lekë

Botimet "M&B"
ISBN 978-99956-04-13-4
Çmimi: 1200 lekë



Në të gjithë Qarkun e Dibrës
janë klasifikuar rreth 90 Monumente Natyre.



Në foto: Lisi i Kabe , 3 km larg nga qyteti i Peshkopisë

Monumentet e Natyrës në Qarkun e Dibrës

Nga **SHAQIR SKARRA**

Tashmë krahas Monumenteve të Kulturës janë edhe Monumentet e Natyrës që gjejnë mbrojtje nga vetë shteti. Sipas një shkrese nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave dërguar Drejtorive të Shërbimit Pyjor Dibër, Bulqizë dhe Mat, më datë 22.1.2006 kërkohet verefikimi i gjendjes së Monumenteve të natyrës në të gjithë Qarkun. Këto, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 676, datë 20.12.2002 mbrohen nga vetë shteti. Në Qarkun e Dibrës të tillë Monumente ka shumë, ndoshta mund të jetë një ndër vendet që ka më shumë Monumente natyre.

Klasifikimi i tyre është bërë tani dhe ato kanë një shtrirje të madhe gjeografike duke filluar nga Kalaja e Dodës, Lurë, Selishtë, Zerqan e Bulqizë e deri në Martanesh e Gurë të Bardhë të Matit. Fakt është se secili nga këto monumente ka nga një histori, një gojëdhënë apo qoftë dhe legjendë që tregohen ende nga vetë vendasit.Shumica e njerëzve kanë njohuri të mjaftueshme për to edhe pse disa nga këto monumente janë të mveshura me legjenda dhe bestytni si Uji i Ftohtë në Vleshë, Liqeni i Zi në Radomirë, Pisha e Zogje, Lisi i Peladhisë apo Kodra e Pareve në Blliçe. Sot edhe pse shteti duket sikur kujdeset për këto monumente natyre, vetë populli është më shumë i interesuar për t'i mbrojtur dhe ushtron një përkujdesje të madhe e të vazhdueshme. Kështu mjafton vetëm po të vështrosh Pishën e Zogje e cila ka një moshë mbi 300-400 vjeçare, asnjëherë nuk i është prerë as dhe një degë e vetme. Ajo është kthyer në një vakëf ku vijnë shpesh herë njerëz për sëmundje të ndryshme dhe sipas bestytnive thonë se vetë hija e madhe e kësaj pishe shëron. Po kështu ndodh dhe me Ujin e Ftohtë në Vleshë ku njerëzit pretendojnë se i shëron nga sëmundjet e reumatizmës ndaj është kthyer në një vend pelegrinazhi ku në stinën e verës njerëz të moshave të ndryshme vërshojnë drejt Ujit të Ftohtë dhe jo vetëm nga zona por dhe nga trevat e tjera.Uji i Ftohtë i Vleshës ka dhe legjendën e bukur të tij .Po kështu dhe Liqeni i Zi në Radomirë ka një legjendë që i mbet nga mallkimi që i bënë njerëzit për mbytjen e një nusje të re nga i njëjti fshat. Edhe shumica e liqeneve të Lurës kanë nga një legjendë.Domsdo që vetë toponimet janë të mveshura me legjenda.E këto toponime tashmë janë klasifikuar si Monumente Natyre.

Në të gjithë Qarkun e Dibrës janë klasifikuar rreth 90 Monumente Natyre.

NË RRETHIN E DIBRËS

1-Shpella e Gurit të Kuq
2-Karsti i Malit të Bardhë
3-Burimi dhe shpella e Sopanikës
4-Liqenet e Kacnisë
5-Pasqyrat e Gramës
6-Gropat e Panairit
7-Liqeni i Zi (mbi Radomirë)
8-Ujëvara e Pocestës në Maqellarë
9-Bjeshka e Zonjave në Zimur
10-Gryka e Setës
11-Shpella e Rusit
12-Shpella e Qytezës
13-Shpella e Akullit (Bulaç)
14-Uji i Ftohtë (Vleshë)
15-Burimi i Kërçinit
16-Kroi i Mbretit
17-Burimi terminal i Llixhave të Peshkopisë
18-Liqeni i Luleve
19-Liqeni i Zi
20-Liqeni i Madh
21-Hartinat e Lurës
22-Shllinasi
23-Guri i Kërçinit
24-Krasta e Pocestit
25-Boroviku i Begjunecit
26-Burimet e Bellovës
27-Gryka e Madhe e Lurës
28-Rrafshet e Korabit
29-Morenat e Fushë Lurës
30-Cirku i Kurorës së Lurës
31-Kodra e Pareve(Blliçe)
32-Fusha e Pelave
33-Rrapi i Kërçishtit
34-Pisha e Blliçes
35-Ahu i Blliçes
36-Lisi i Dobit
37-Vakufi i Çangës
38-Lisi i Kabe
39-Vakufi i Sinës së Epërme
40-Rrobulli i Lurës
41-Rrapi i Çidhnës

NË RRETHIN E BULQIZËS

1-Zabeli i Madh Zerqan
2-Shpella e Urës së Qytetit
3-Shkëmbi i Qytetit
4-Tre Çezmat e Zerqanit
5-Bregu i Papesë
6-Qarri i Muharremit
7-Gurra e dhe Shpella e Zerqanit
8-Gurra e Vakëfit të Zerqanit
9-Liqeni i Zi
10-Ujëvara e Duriçit
11-Xixëll Martanesh
12-Shpella e Xixëllës(Valikardhë)
13-Shpella e Ftohtë Gjuras
14-Qarri i Kovashicës
15-Qarri i Gjinovecit
16-Pisha Zogje
17-Qarri Peladhi Zerqan.

NË RRETHIN E MATIT

1-Guri i Gjatë në Urxuall
2-Kepi i Skqëndërbeut në Varosh
3-Kanioni i Urakës
4-Rrapi i Marqethit
5-Lisi i Qershizës
6-Puset e Valcës
7-Maja e Boshtrës (Macukull)
8-Guri i Vashës
9-Lisi i Tushës (Frankth)
10-Bërshini në Groshot
11-Kanioni i Flimit
12-Kroi i Gjeneralit (Gurë i Bardhë)
13-Tisat e Mbasdejës
14-Lisat e Lam Pores
15-Burimi Shutresë
16-Lisi i Qafë Shënkollit
17-Rrapi i Pazarit në Klos
18-Qarri i Bardhë në Shoshaj
19-Lisi i Fushë Lores (Barbullej)
20-Lisi i Bërshinit
21-Lisi i Varreve të Rexhës
22-Lisi i Varrit të Mirë
23-Lisi i Varrit të Turkut
24-Lisat e Shkollës
25-Lisi tek varret e Shqypit
26-Lisi i Kodrës së varreve
27-Lisi në varret e Kurmetës
28-Lisi i Teqes së Domit
29-Rrapi i Çelës
30-Lisat e Kishës Groshot
31-Lisi i Xhamisë
32-rrapi i Zabelit.

Tani më pranë jush me një market të ri Pallatet KARAVAN, Laprakë

Maxi 2

Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

AURORA GROUP SH.P.K

PROJEKTIM - ZBATIM

koha kalon, cilësia mbetet



Autostrada Tirane - Durres, Km.9
Tel: +355 48 30 2046
Tel: +355 48 30 2040
www.auroragroup.com.al
e-mail: auroragroup@auroragroup.com.al

botime

Naim Plaku me librin "Po të mos ishte Drini, ku do të mbytej Seta" i ka bërë një shërbim shumë të mirë kulturës dhe traditës sonë kombëtare.

Një libër me vlera për kulturën dhe traditën tonë kombëtare

"Po të mos ishte Drini, ku do të mbytej Seta?!"
- Urtësia dibrane nëpërmjet tregimeve të Naim Plakut

Nga: **SAKIP CAMI**

Tani lexuesi shqiptar kudo që ndodhet brenda dhe jashtë vendit, dhe veçanërisht lexuesi dibran, ka në duar një perlë të urtësisë dibrane, librin e Naim Plakut "Po të mos ishte Drini...". Shtëpia botuese "M&B" bëri të mundur që të kemi këtë libër me vlera të mëdha artistike, historike, kulturore, folklorike dhe edukative për brezat.

Autori i qindra poezive dhe këngëve, i dy librave me poema dhe vjersha, Naim Plaku, vjen këtë herë me një sukses të ri, me lëvrimin e tregimit popullor dibran të përpunuar, që është padyshim një zhanër i bukur dhe shumë i kërkuar për të gjithë brezat.

Një pjesë të këtyre tregimeve, rrëfimeve, meseleve dhe historive i kisha lexuar edhe në gazetën "Rruga e Arbërit" dhe më kishin pëlqyer shumë.

Sigurisht, Naimi nuk është i pari në këtë fushë, por ndoshta është më i talentuari, më punëtori dhe më i duruari. Kjo është një punë kolosale në gjurmët e Haki Stërmillit, Hazis Ndreut, Hilmi Kolgjegjës, Xhafer Martinit, Bajram Hysenit, Xhelal Ndreut e të shumë shkrimtarëve e studiuesve dibranë që e kanë ngritur urtësinë dibrane në ato nivele që meriton të jetë.

Ky është një libër që nuk duhet ti mungojë asnjë shtëpie dibrane, asnjë emigranti dhe pse jo edhe asnjë shqiptari që kërkon të dijë nga vjen dhe ku do të shkojë.

Libri hapet me novelën historiko-artistike "Po të mos ishte Drini..." kushtuar kohës së Skënderbeut. Autori u vjen në ndihmë edhe historianëve me ato hulumtime të kryera me ato toponime të nxjerra dhe me ato fakte të reja të padëgjuara deri më sot. Ai godet me veprën e tij edhe ato studiues të huaj dhe shqiptarë të shitur apo injorantë që godasin Skënderbeun dhe historinë e tij. Autori është pikërisht nga vendlindja e të atit të Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriotit, Skënderbeut, nga Çidhna, nga Sina dhe Gardhi i Poshtëm, që siç thotë Barleti ynë i famshëm në vitet 1500 ishin trojet e Kastriotëve dhe të të atit të Skënderbeut, Gjonit. Edhe sot në këtë fshat ndodhet një vend që quhet Gjergjishte (Gjergj + ishte)

Personifikimi i Drinit edhe si lumë edhe si perëndi, personifikimi i Setës edhe si lumë edhe si vajzë e bukur, si grua, është një arritje dhe gjetje artistike që do ta kishte zili çdo autor.

Dhe pikërisht me vdekjen e Gjergj Kastriotit në Lezhë dhe me njoftimin piskamë dhe jehonë të vdekjes së tij fillon novela "Po të mos ishte Drini..." , me krismat e kalave të Çidhnës, Koxhaxhikut (Sfetigradit), Modriçit (Steblevë), Meçadit (Borovë), Kojavecit, Krajkës, Kubenit, Obokut etj. për bashkim dhe për luftë të mëtejshme ndaj turqve dhe tingëllon si kushtrim edhe sot.

Dhe më tej dy personazhet e novelës Vidani dhe Seta, dy të rinj të dashuruar, janë kurbanët e kësaj lufte që do të vazhdojë për pesë shekuj.

Për tu bindur i dashur lexues me stilin, organizimin e shkrimit, subjektin e famshëm dhe burimin e pashtershëm popullor po japim vetëm një pasazh të kësaj novele që për stilin dhe përmbajtjen është unikale.

...Vidani hapi prapë sytë. Para tij qëndronte Seta, gruaja e ëndrrave të tij, Seta e butë, Seta e egër, Seta e bukur, nusja e tij e re, duke përkëdhelur mes gishtërinjve të bardhë unazën e çmuar, që e kish ruajtur në gjirin e saj tash sa mote. I mori dorën e majtë Vidanit, ja afroi mbi zemrën e saj që gufonte, ia vuri në gisht, lidhi dorën e saj me të Vidanit, siç e kishte të lidhur unaza, i puthi dorën e përgjakur ku shkëlqente porosia e Bip Hutës dhe amaneti i madh i Gjergjit. Të dy ranë në lëndinë si dy krahët e këputur të shqipes mbi mbi gjoks të njëri tjetrit. Kur Seta u zgjua, Vidani qëndronte si gjeth i verdhë në krahët e saj. Sa i lehtë ishte bërë ky burrë vigan ! Seta i hapi aty



një gropë me tehun e shpatës së Martinit. E mbuloi me dheun e shkriftë të zallit dhe e lagu me lotët e syve të kaltër. Këtu, po, vërtet këtu është dhe varri i Vidanit.

Po varri i Setës, vallë ku është ?! Ka vdekur Seta apo është akoma gjallë e rron mes nesh ?!"

Libri përmban edhe 15 tregime popullore të tjera të zonës së Dibrë, të cilat shprehin humorin e hollë të popullit dhe godasin veset dhe gabimet e kohës.

Në fund, mund të themi se Naim Plaku me këtë libër i ka bërë një shërbim shumë të mirë kulturës dhe traditës sonë kombëtare.

Një dëshmi për historinë



Nga: **ALI HOXHA**

Duke marrë shkak nga shkrimi i z. Sakip Cami, me titull "Mutafa Qemal Ataturku, shqiptari nga Steblleva që u bë reformatori dhe krijuesi i Turqisë moderne", e gjykoj që për të përforcuar origjinën shqiptare të Mustafa Qemal Ataturkut të shtojmë edhe ne një argument tjetër, duke bërë publike një dëshmi të Prof. Eqrem Çabejt për këtë çështje, para 30 vjetësh, në qytetin e Peshkopisë, pikërisht më 19 maj 1978.

Më 19 maj 1978, Prof. Mahir Domi dhe Prof. Eqrem Çabej erdhën në Peshkopi me rastin e një sesioni shkencor "Për probleme të gjuhësisë dhe të dialektologjisë", që u bë më datë 20 maj 1978, i organizuar nga Shoqata e gjuhëtarëve të rrethit të Dibrës, në bashkëpunim me Institutin e gjuhësisë dhe të letërsisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Në pritje të tyre kishte dalë z Myfit Trepça, me cilësinë e kryetarit të shoqatës së gjuhëtarëve të rrethit të Dibrës; Ali Hoxha, me cilësinë e nënkryetarit të shoqatës dhe z. Hilmi Sadikaj, anëtar i shoqatës. Pas stabilizimit në hotel dhe pas pushimit të çastit, me kërkesën e prof. Eqrem Çabejt, bëmë një shëtitje në bulevardin kryesor të qytetit, për t'u njohur me qytetin, sepse, siç na tha vetë profesori, ajo ishte vizita e tij e parë në Dibër të Poshtme.

Sesioni shkencor u zhvillua në kuadrin e manifestimeve të 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (të vitit 1878), prandaj edhe biseda e rastit gjatë shëtitjes, u përqendrua kryesisht rreth asaj teme. Ndër të tjera, ra fjala edhe për aktivitetin e Mustafa Qemal Ataturkut. Kur më erdhi rasti, unë bëra këtë ndërhyrje:

"Këtu në Dibër kemi shumë pleq që kanë qenë bashkëluftëtarë me Mustafa Qemalin dhe që na kanë folur për origjinën e tij shqiptare. Disa prej tyre janë ende gjallë, nga të cilët unë i njoh personalisht, si: Ramadan Cani nga Qani i Dardhës, i cili ka qenë adjutant i Ataturkut dhe Maliq Gjoni nga fshati Mustafaj. Me këtë të fundit kam folur personalisht për këtë çështje dhe më ka thënë se ai vetë ka folur personalisht me Mustafa Qemalin disa herë kur ai shërbente në ushtrinë e Perandorisë Osmane dhe më ka pohuar origjinën shqiptare të Mustafa Qemalit. A thua të jenë të vërteta këto pohime apo mos kemi të bëjmë me një diçka emocionale tonën si shqiptar?!".

Në ato moment ashtu siç ishim duke shëtitur në bulevard, pikërisht në vendin ndërmjet turizmit dhe kinemasë, e mori fjalën prof. Eqrem Çabej, i cili tha shprehimisht kështu (citoj në ligjëratë të drejtë):

"Unë njihem me një dhëndër të Zija Dibrës, (Zija Dibra është ish-bashkëluftëtar, shok dhe mik i Mustafa Qemalit, dhe ish-deputet i Dibrës në Parlamentin e A. Zogut – A.H.). Ai më ka thënë: "Zija Dibra më ka treguar se në një banket që ishte shtruar pas fitores së forcave ushtarake turke në një betejë kundër forcave greke (në atë banket kishte qenë i pranishëm edhe vetë Zija Dibra), Mustafa Qemali kishte ngritur një dolli për nder të një gjenerali shqiptar nga Kosova, që ishte dalluar në atë betejë, duke e përshëndetur shprehimisht kështu: "Ju kosovarët jeni trima, por ne dibranët jeni më të zgjuar".

I entuziazmuar nga një përgjigje e tillë dhe e papritur, unë nuk e përmbajtja dot vetveten, por ndërhyra në këtë pyetje:

"Profesor! Ne mendonim me rezerva për origjinën shqiptare të Ataturkut, kurse ju na e bëtë dibran! Nga se vërtetohet kjo?".

Profesor Eqrem Çabej u përgjigj:

"Nëna e Mustafa Qemalit është nga katundi Sebisht i Dibrës...".

Të gjithë të pranishmit e tjerë në momentin e këtij deklarimi historik të profesor Çabejt, tashmë janë të vdekur përveç meje.

Duke gjykuar se një pohim i tillë, si i lartpërmenduri dhe nga një personalitet i lartë shkencor si prof. Eqrem Çabej, është një dëshmi me vlerë për historinë e kombit tonë, mendova ta bëj publike në shtyp, sepse unë jam i vetmi dëshmitar okular i mbetur i gjallë nga të pranishmit e atij momenti.

Për të qenë i besueshëm për lexuesin lidhur me saktësinë e deklarimit të lartpërmendur të prof. E. Çabejt, për origjinën dibrane të M. Qemalit, si dhe për të përkujtuar me respekt në shenjë nderimi për referuesit, shumica e të cilëve tashmë janë të vdekur, po përmend këtu edhe rendin e ditës të atij sesioni shkencor, të zhvilluar të nesërmen e asaj dite më 20 maj 1978:

"Në seancën e parë të sesionit shkencor u mbajtën këto kumtesa:

- Nga prof. Mahir Domi: "Problemet e dialektologjisë dhe të onomastikës në fazën e sotme"; nga prof. Eqrem Çabej: "Dialektologjia historike dhe toponimia"; nga mësuesi Ali Hoxha; "Një vështrim i shkurtër gjuhësor mbi toponimet e fshati Çidhën" dhe nga Qani Përtafi: "E folmja e fshatrave të kooperativës së bashkuar Qendër".

Edhe në seancën e dytë u mbajtën kumtesat nga Bashkëpunëtor i Vjetër Shkencor Jorgji Gjinari: "Atllasi dialektologjik i shqipes – hap i rëndësishëm në studimin e gjuhës me metodën e gjeografisë gjuhësore. U lexua kumtesa e B. Shk. Minella Totoni: "Çështje të sintaksës dialektologjike" dhe u mbyll me kumtesën: "Përpjekje për të shpjeguar disa toponime të krahinës së Zerqanit", nga mësuesi Fiqiri Novaku ("Ushtima e Maleve", 24 maj 1978, f. 1).

Duke publikuar këtë deklarim të prof. Eqrem Çabejt, për origjinën e Mustafa Qemal Ataturkut, shpresojmë se i kemi shërbyer historisë së kombit tonë.

Shqipëria është e vogël në hartë, inxhinier!



Nga **VESEL HOXHA***

(Vijon nga numri i kaluar)

Pasi vendosëm në makinë edhe ato pak materiale që mora në ekspedite, u nisëm për në destinacion. As vetë nuk e kisha të qartë se ku do të shkonim. Shkoja për herë të parë. Rruga me asfalt nuk vazhdonte më tutje. Do të kalonim nga Muhurri, jo vetëm se aty na priste Sufa, por nga Sllova as që bëhej fjalë.

- Do të kalojmë nga Škavica dhe Vila – thotë Bujari, është pak larg, por nuk kemi variant tjetër. Duhet të shpejtohemi që të vemi me dritë. Kësisoj do të kemi mundësi të shkarkojmë e sistemojmë plaçkat pa rënë errësira, diku atje afër postës, saktësoi Bujari, pasi kishte ardhur edhe herë të tjera. Kur mora vesh se Bujari kishte njohje për vendin se ku do të arrinim, sikur ndjeva **një farë lehtësimi dhe sigurie** në vetvete. Tek Ura e Muhurrit na priste Sufa. Pasi përshëndetemi me të, e prezantoj me Bujarin. Aq deshi Sufa dhe tërë rrugës ata patën një muhabet të ëmbël sikur ishin njohur prej vitesh. Ishin **"kolegë",** njëri me makinën **tip zis** (model kinez), kurse Sufa me **"veturën e tij"** model vendi. Që të dy kryenin punë transporti për ekipin. Kësaj radhe Sufa do të vinte pa veture, **siç kishte dëshirë ta thërriste mushkën** e tij që e donte aq shumë dhe tregonte për të një përkujdesje të madhe. Do të vinte të më ndihmonte në ngritjen e bazës dhe të mësonte vendndodhjen e saj, pasi do të na furnizonte gjatë gjithë verës. Pas disa orësh udhëtimi i ishim afruar nahies (krahinës) së Kalasë së Dodës. Sapo kalojmë Taben e Nizamit (Kullën e Sinanit) dhe para nesh shpaloset me madhështi malësia e Korabit, Gjipset e Përroit të Veleshicës e të Urës së Druve dhe në të majtë Malësia e Sorokolit me relievin e tij të rrumbullakosur dhe livadhet alpine të pafundme. Ku ta dija unë, që në ditën e parë të punës në këtë rajon, se Mali i Sorokolit do të ishte stacioni kryesor i punës për kërkimzbulimin e mineraleve oksido – silikate të hekurit, që në fjalorin e kohës quheshin me emrin e Hekurit pa nikel. Unë do të vazhdoja të udhëtoja për në Bjeshkën e Shehut, për të ngritur sa më parë atje bazën nga ku do punoja për të kërkuar e zhvilluar më tej të dhënat e gjeologëve rilevues për shfaqjen e hekurit oksid të Gurëve të Pëllumbave. Arritëm në fshatin Ploshtan. Bujari na propozoi të pushonim pak dhe të pinim nga një kafe. Të them të drejtën u habita pak se në fshatin tim p.sh. nuk kishte lokal kafeje. Ka lokal këtu për të pirë kafe i drejtohem Bujarit. Po – përgjigjet shkurt ai, duke treguar se kishte pirë dhe radhë të tjera ku kishte mbetur i kënaqur. Këtu bëhet kafe e mirë e pa hile – përfundoi bisedën ai. Ashtu bëmë. U futëm në lokal dhe zumë vend në një tavolinë boshe. Vura re se drejt nesh u drejtuan shumë sy. Kjo është normale kur në një zonë të thellë vijnë njerëz **"jabanxhi".** Kurioziteti kërkon që ato të njihen shpejt se cilët janë e nga vinë, aq më tepër po të kemi parasysh periudhën për të cilën flasim. Më i moshuari (vite më vonë do të mësoja se ai quhej Sherif Brika nga fshati ku kishim ndaluar, punonjës i sektorit të tregtisë, një njeri fisnik dhe bujar) që ndodhej aty, na u drejtua me fjalët: "Nga u kemi e përse kini ardhur në këto ane?"

"Jemi të **gjeologjisë,** vijmë nga Bulqiza" – u përgjigj Bujari.

Me të dëgjuar fjalën gjeologji, m'u duk sikur interesi i tyre u zgjua shumë dhe menjëherë vazhduan me pyetje të tjera për të marrë vesh hollësira se ku do të punonim dhe për çfarë **mademi.** Ky është inxhinieri që do të drejtojë punimet – duke bërë me shenjë nga unë. Ngaqë isha i habitur, i impresionuar e mjaft i ngarkuar emocionalisht – mendova një çast që nuk bëhet fjale për mua, po për ndonjë inxhinier tjetër. Ishte fillimi dhe fjala inxhinier këtu në mes maleve, sikur më emocionoi shumë dhe më ngarkoi me përgjegjësi edhe më të mëdha. Në Bulqizë nuk na bënte përshtypje kur na thërrisnin me **"nofkën inxhinier",** pasi atje **"kishte me shumicë"**.

- Ne jemi zonë malore – ngacmoi bisedën Sherifi. Këtu ka punë në bujqësi vetëm për 3 – 4 muaj. Pjesa tjetër e kohës pothuaj është bosh. Edhe shtegtimi po vështirësohet nga dita në ditë. Ardhjen tuaj ne e shohim **si rreze drite**, e shohim të lidhur me shpresën e hapjes së ndonjë miniere dhe me punësimin e popullatës. Ju priftë e mbara – e mbylli bisedën Sherifi. Si mysafir që ju kemi sot, **kafenë e kini të paguar prej meje** dhe, të më falni se do të marr leje, pasi kam një punë tek magazina e po më presin disa vetë.

- T'u shtoftë ndera e mirë u takofshim - ndërhyri në bisedë Sufa. Ndërkohë që ne prisnim kafenë, mua më kishte tërhequr vëmendjen mënyra se si po bëhej ajo. Në një tepsi të madhe llamarine të mbushur **me rërë të imët** ishin të vendosur filxhanët e kafesë të mbushura me ujë. Nga poshtë ajo merrte nxehtësinë, duke ngrohur rërën dhe filxhanët e kafesë. Kur uji vlonte, ajo i hidhte masën e kafesë së bluar në çast me një mulli **Stambolli** të vjetër. Pra, kafeja nuk bëhej në **xhezve** dhe të shpërndahej nëpër filxhanë, siç i bëjmë sot rëndom nëpër shtëpitë tona. Çdo fixhan përgatitej veçmas, me të gjitha asortimentet dhe ashtu i nxehtë të shërbehej në tavoline, e cila nuk e kishte lënë pa e **dokumentuar** këtë fakt. Në mbulesën e tavolinës ishin të stamposura fundet e filxhanëve të kafesë. Të them të drejtën më bëri shumë përshtypje. Mua edhe sot e kësaj dite nuk më ka rastisur të pi kafe me këtë teknologji. Kjo që na bëri kafenë ishte **Zarifka Skeja**, një grua serioze e fisnike, me djalin e të cilës, **Padishahun,** vite më vonë do të punoja në Malin e Sorokolit, ku ai do të drejtonte sondat si teknik që ishte. Pasi pimë kafetë me kënaqësi të madhe, falënderojmë zonjën që na shërbeu dhe u nisëm për rrugë. Si i ri që isha më bënte përshtypje çdo gjë, jo më respekti që na bëhej e dashuria që na shfaqej nga këta njerëz të thjeshtë të këtyre zonave të thella malore që, me aq vështirësi e mundime e bëjnë jetesën. Kishim akoma rrugë për të bërë. Pas disa minutash arritëm në Ceren. Ai ishte fshati ku kisha pune, pasi ishte qendra e kooperativës dhe e Këshillit të Bashkuar. Aty u takova me **z. Destan Visha**. Destani, për nga profesioni, ishte mësues. Kishte një komunikim me humor. Ishte tepër kurajoz dhe shumë praktik. Nuk fliste për gjëra që nuk i realizonte. Thoshte të vërtetën, por harronte se në disa raste duhej të thoshte atë që donte **nëna parti** dhe jo atë që me të drejtë thoshte dhe mendonte Destani. Ai ishte zgjedhur kryetar i këshillit të Bashkuar të Kalasë së Dodës. Kisha punë me të. Me Destanin kisha gjetur rastin të takohesha e të bisedoja në Peshkopi, kur vinte për mbledhje. Do të merrja konfirmimin për punëtorët që do të punonin me mua gjatë gjithë verës si dhe, kisha kërkuar ndihmën e tij për të më siguruar numrin e nevojshëm të kafshëve për transportin e bazës nga Tejasi për në Bjeshkën e Shehut. Në Tejas do të kesh nesër në mëngjes shumicën e punëtorëve dhe pas dy-tre ditësh do t'i kesh të gjithë. Bëhej fjalë për dhjetë punëtorë sezonalë që do të hapnin punimet sipërfaqësore të kërkimit. Sa për kafshët, do të bisedosh vetë në fshatin Tejas, se kanë fshatarët pothuajse të gjithë – përfundoi bisedën kryetari Destan Visha. Nuk kishte më shumë se një ore e gjysmë ditë. Hipa në makinë ku më prisnin Sufa dhe Bujari. Për njëzetë minuta jemi në Tejas, po nuk patëm pengesa, na orientoi Bujari për pjesën e rrugës që na kishte mbetur pa bërë për të arritur në destinacion. Për fat nuk patëm ndonjë makinë rrugës që të vinte kundra nesh, pasi ndërrimi do të humbiste shumë kohë. Rruga ishte tepër e ngushtë dhe jo në gjendje të mirë. Arritëm tek posta kufitare në Tejas, e cila ishte në krye të fshatit, aty ku Bujari kishte menduar që më parë për të shkarkuar materialet dhe për t'i siguruar gjatë natës. Me ndihmën e disa fshatarëve që u ndodhën aty, me kujdes u shkarkuan të gjitha materialet dhe u vendosën me një farë rregulli nën drejtimin e Sufës dhe Bujarit, për ta pasur sa më lehtë ruajtjen e tyre gjatë natës. Ndërkohë që po shkarkoheshin materialet, unë mora kontakt me komandantin e Postës, ku e vura në dijeni për ardhjen tonë dhe punën që do të kryenim në zonën kufitare. Kështu ishin rregullat në atë kohë. Duhej të ishe i pajisur me leje nga Dega e Brendshme në Peshkopi. Kthehem tek shokët. Bujari po pastronte makinën dhe po bëhej gati të kthehej. Si thua inxhinier, më duket se gjithçka na vajti mbarë e mirë dhe dua të më jepni leje. Të gjitha materialet erdhën në rregull, asgjë nuk është mangut. Rrofsh Bujar, ju na ndihmuat shumë dhe asnjëherë nuk do ta harroj se për herë të parë në Korab më sollët Ju. Ndonëse unë do dëshiroja që Bujari të qëndronte më në atë nate, pasi ishim shumë të lodhur nga gjithë ajo rrugë e gjatë, por gjithsesi ai duhej të nisej. Punë të tjera na prisnin si ne dhe Bujarin. Ndezi makinën dhe u nis. Pasi kaloi disa dhjetëra metra, uli shpejtësinë, nxori kokën në xhamin e makinës e thirri: "Suksese e mirupafshim inxhinier Veseli!" Instiktivisht vazhdova ta ndjek makinën, derisa ajo së bashku me Bujarin nuk u dukën më. Ndërkohe Sufa vazhdonte të sistemonte e "maskonte" disa materiale të imta që edhe mund të merreshin nga elemente keqbërës, pasi të tillë ka kudo e në çdo kohë. Po rrija në heshtje i mbështetur mbi disa pajisje, duke shënuar disa gjëra që duhej të organizoja për nesër. Do të niseshim herët për të vajtur në destinacionin final, aty ku do të punonim. Duheshin marrë masat për të siguruar kafshët. Na duheshin rreth 16. Për të gjitha këto vajta dhe bisedova me kryetarin e fshatit, ku ramë dakord për pagesat dhe shtesat për kafshët. Sa kthehem tek vendi ku kishim shkarkuar materialet, afër postës kufitare, Sufa më drejtohet me fjalët: "- Inxhinier, ju kërkuan dy veta, ishin nga anët tona. Juve nuk ju njihnin personalisht, por kishin njohje për njerëzit e familjes Tuaj. Ju presin te dhoma." E kishin atë fare pranë shkollës. Mirë i them Sufës. Unë po vete t'i takoj, por ki kujdes. Nuk do të vonohem shumë. Kemi ende punë për të bërë. Ndoshta mungesa e eksperiencës m'i shtonte edhe më shumë punët dhe problemet. Në shkollë kisha bërë pak nga këto gjëra. Por edhe sikur të kisha bërë shume, praktika ka të fshehtat e të papriturat e veta. Shkolla nuk të mëson gjithçka. Ajo të mëson të **"vjedhësh dije**", të dish ku t'i kërkosh ato. Eksperienca është tjetër gjë, është ajo që ta japin vitet e punës.

* * *

Vajta drejt e në banesën e tyre. Më pritën me shumë dashuri. Më thirrën me parashtesën inxhinier, me të cilën nuk isha mësuar. Ç'të shikoja! Nga dera futeshe direkt e në dhomë, pa asnjë lloj shtroje poshtë, direkt në tokë. Komunikimi me jashtë ishte i drejtpërdrejtë. Ishte fillim qershori e prapëseprapë atje bënte freskët, por në dimër si mund të banohet këtu - thashë me vete. Ishte një kasolle me katër mure, e pa suvatuar, e lyer me gëlqere direkt, pa tavan dhe e mbuluar me katroma, ku brimat nuk kishin të numëruar. Nuk besoj se ishte më shumë se 3 x 3 m. Në të dy anët e saj ishin sajuar dy krevate të ndërtuara me drurë të hollë e të lidhur me furde, të cilat shërbenin dhe si shtroje për dyshekun. Të them të drejtën u tmerrova për ato kushte jetese që kishin, por nuk e dhashë veten. Ishin Mersim Sopoti nga fshati Brezhdan dhe Nazmi Laçi nga fshati Brest i Poshtëm. Të dy ishin me shërbim në këtë fshat si mësues në shkollën fillore në qoftë se nuk gaboj. Në zona të thella, ***sidomos në atë kohë kur makinat numëroheshin me gishta,*** njerëzit bëheshin kurajozë për të ditur se kush erdhi a po kush ishte. Nëna parti e donte popullin **në këmbë** e **vigjilent,** ndërsa vetë rrinte **në ballë**, por jo në Tejas, **në Tiranë**. Ato jetonin e punonin prej vitesh në këtë fshat. Ishin larg familjeve. Vetëm në fund të muajt mund të shkonin pranë tyre, duke shfrytëzuar ndonjë makinë të postës që sillte drutë e dimrit apo ndonjë furnizim tjetër. ***Në mendje bluaja organizimin e punës për ngarkimin e materialeve në kafshë, të nesërmen në mëngjes herët, për të pasur mundësi e kohë të ngrinim bazën pa perënduar dielli, të ngrinim çadrat e gjithçka që duhen për një qendër pune fushore në mal. A do të na vinin të gjithë fshatarët dhe a do të na i sillnin të gjitha kafshët që u kërkuam, aq sa kishim nevojë. Vetëm me Sufën isha. Tekniku më mungonte. Do të më vinte pas disa ditësh, por unë tani për tani ndjehesha në hall.***

Ishim andej nga posta dhe deshëm të takohemi me ju, siç ju ka thënë Sufa. Hajde Suf - thashë me vete - shpejt u bëre i njohur. Pse të mos bëhet, Sufa sot për sot është Nr. 2. - Lajmet popullore na thanë për ju se jeni të gjeologjisë – vazhdoi bisedën si me humor Mersim Sopoti.

- Po i them. Këtë verë **do të punojmë lart në bjeshkë**, më shumë në Bjeshkën e Shehut, për të verifikuar disa **shfaqje mineralizimesh hekuri pa nikel**.

Në bisedë e sipër me ta - **gjuha vajti tek dhëmb dhëmbi** - siç thotë populli. Ju kërkuam për të biseduar rreth disa nevojave që kemi – vazhdoi bisedën Mersimi.

- Unë jam fare i ri në detyrë (detyrë për të punuar në mal – thashë me vete) dhe nuk besoj se kam mundësi e kompetenca për t'u ndihmuar. Megjithatë – vazhdova bisedën - diçka me iniciativën time edhe mundet.

- Të dy palët jetojmë e punojmë në vështirësi e larg familjes dhe duhet ta ndihmojmë njeritjetrin. Siç e shikon ne kemi nevojë për ca katrama dhe disa batanije.

- Po, - i them, ne kemi marre materiale te tilla, siç mund t'i kini parë dhe vetë, por duhet ngritur baza dhe të shikojmë ç'na ngelet për t'u ndihmuar.

- Mirë, mirë belbëzuan ata. Si duket, pritën tjetër përgjigje.

U largova për tek vendshkarkimi i materialeve afër postës ku qëndronte Sufa në krye të detyrës, ndërsa në mendje vuaja diçka. **Ata duheshin ndihmuar**. Ne e kishim një çadër dhe kishim marrë disa pajisje për kushte jetese edhe në mal, kurse mësuesit m'u dukën jashtë kujdesit e vëmendjes së shtetit. Si mund të jap mësim një njeri me kushte të tilla jetese! Nejse, kjo nuk ishte detyra ime të mendoja për ta. **Detyra ime si specialist** ishte të shkoja sa më parë në bjeshkë e të filloja punën, **detyra si njeri** ishte nëse do t'i ndihmoja apo jo **për ato që më kërkuan**.

* * *

Për hir të së vërtetës komanda e postës na ndihmoi shumë. Ajo jo vetëm na lejoi që materialet të shkarkoheshin në oborrin e postes, por në një farë mënyre na garantoi dhe ruajtjen e tyre gjatë natës, pasi keqbërës **ka në të gjitha kohërat** dhe unë e Sufa sado vigjilent që të ishim, nuk i ruanim dot, falë dhe faktit se ishim dhe në një zonë të panjohur, ku vinim për herë të parë. Akoma nuk kishim krijuar njohje dhe baza në këtë zonë. Pasi hëngrëm pak bukë nga ajo që kishim marrë me vete, mua më mori gjumi. Fjeta disa orë dhe me porosi timen më zgjon Sufa. Më erdhi keq të të zgjoja, por zbatova **urdhrin**. Jemi në zonë ushtarake, - i thashë me të qeshur, dhe këtu, më shumë se kudo tjetër ai duhet zbatuar. Edhe ai ishte po aq i lodhur sa unë, ndoshta dhe më shumë. Tani fli pak, Suf, se do të rri unë roje, - i thashë.

- **A bre inxhinier, -** m'u drejtua Sufa - i ruan frika e atij **"shokut"** se për ne të dy ..... e mbylli bisedën, duke qeshur me mimikën e tij domethënëse e karakteristike. Rreth orës pesë të mëngjesit filluan të dëgjohen trokitjet e para të kafshëve që po vinin. Unë dhe Sufa tashmë ishim të zgjuar dhe po prisnim. Nuk vonoi shumë dhe disa ushtarë të postës kishin marrë porosi nga

shënime

"Shqipëria është e vogël në ato hartat që punoni Ju!
Me mushkën time të ngarkuar anash e në shalë dhe me Sufën
e moshuar pas në këmbë, është e madhe inxhinier"



Një grup specialistësh gjatë punimeve fushore në kërkimet gjeologjike

komanda për të na ndihmuar gjatë ngarkimit në kafshë.

- Më duket se po na vijnë të gjithë, - më thotë si me gëzim Sufa.

- Po, - i them. Ndonëse kafshët nuk kishin ardhur të gjitha, filluam ngarkimin e tyre. Kishim bërë që më parë një farë plani që në përgjithësi ngarkesa të ishte e njëjtë për çdo kafshë. Të them të drejtën nuk m'u dukën shumë pajisje, por kur i ngarkuam në kafshë na dolën shumë. Një pjesë e pajisjeve vërtet nuk kishin volum, por peshë kishin. Rreth orës shtatë të mëngjesit ngarkesa e kafshëve kishte mbaruar dhe gjithçka ishte gati për rrugë. U nisëm. Për mua kishin rezervuar një kalë, por të them të drejtën nuk pranova. Më erdhi turp ngaqë isha më i ri në raport me të gjithë ata që kishin ardhur për të na ndihmuar në transport. Pas shumë vështirësive gjatë rrugës, pas 3 orë udhëtim në ato malore të forta, arritëm në vendin ku do të ngrihej baza. Sufa ishte në lëvizje si asnjëherë tjetër. Ndiqte me vëmendje shkarkimin e materialeve. Pasi verifikuam se gjithçka ishte në rregull dhe ato kishin ardhur të gjitha, përshëndetemi dhe ndahemi prej tyre. Ua bëra të qartë pagesën dhe datën kur do t'u vinin lekët me borderotë shoqëruese nga Peshkopia. Sufa nuk harroi të porosiste dikë për punëtorët që do të vinin këtu si për vendndodhjen e ekipit tonë gjeologjik dhe për datën e paraqitjes në punë.

* * *

Baza do të ngrihej afër postës verore të Venishtit, në Bjeshkën e Abazallarëve. Ballë për ballë kishim Bjeshkën e Shehut dhe Gurët e Pëllumbave. Sipas rregullit paraqitem tek posta dhe kërkoj takim me komandantin. Komandant ishte **Kozma Ziu, nga Berati i largët**. Një burrë zeshkan, trup mesatar dhe i pasionuar pas punëve të kufirit. Më priti pa as më të voglin hezitim, duke shprehur gatishmërinë për të na ndihmuar dhe kënaqësinë që për disa muaj do të ishim komshinj me ta. Shkurt, komandant Kozmai doli nga posta bashkë me mua dhe erdhi drejt e tek vendi ku do të ngrihej baza. Urdhëroi disa ushtarë që nuk i kishte me shërbim për të na ndihmuar dhe filluam menjëherë nga puna për ngritjen e çadrave. **Asnjëherë nuk kisha ngritur çadër**. Nevoja të mëson, - thotë një fjalë e urtë popullore. Pas disa orësh baza filloi të marrë pamjen e saj. Ngritëm të tre çadrat italiane me ngjyrë jeshile të errët. Në pamje ato dukeshin të forta dhe të bukura. Ne bëmë kujdes që litarët të shtrëngoheshin mirë dhe fort për të përballuar erërat e fuqishme. Pastaj me radhë sistemuam të gjitha materialet në vendet e tyre dhe rregulluam pajisjet në çadrën dy vendëshe ku do të flinim atë natë unë dhe Sufa. Kishte dhe pak ditë, por ne tashmë ishim tepër të lodhur. Malorja nga Tejasi e deri këtu në Bjeshkë na lodhi shumë. **Tre orë në këmbë, në terrene të tilla dhe pa pushuar, është shumë.** Po ashtu dhe ngritja e bazës, falë ndihmës së ushtarëve. Ishin marrë masat që të nesërmen të vinin të ngarkuar me kafshë nga fshati Sllatinë materialet eksplozive si dinamiti, fitili dhe kapsollat, rreth **14 kv ngarkesë.** Nga Bulqiza do t'i sillte me makinë në Sllatinë zjarmtari **Lik Skarra** nga fshati Shumbat dhe, së bashku me zjarmtarin tjetër nga Dipjaka, **Ramadan Palin**, do t'i shoqëronin deri në bazën tonë, të ngarkuar në kafshë për afro 4 orë rrugë në një terren malor. **Këtë detaj kisha harruar ta bisedoja me komandantin.** Pra ai nuk e dinte se ne do të kryenim punime me lëndë plasëse dhe diku ato do të ruheshin. Ku do të ruheshin, **kjo ishte çështja**. Punët me lëndët plasëse janë me zarar dhe kanë rregulla të ngurta administrimi e përdorimi, rregulla të sigurimit teknik. Këtë gjë unë e dija. Vajta përsëri tek posta për ta takuar, ashtu i lodhur e i rraskapitur me gjithë hallet e ditës. Në ndërmarrje më kanë thënë se është biseduar me Degën e Brendshme në Peshkopi se lënda plasëse do të ruhet në postën e kufirit – fillova bisedën. – Jo, - përgjigjet shkurt ai, unë nuk e mora përsipër një gjë të tillë. Ju i dini më mirë se sa unë rregullat. **Bo, bo ç'më gjeti, - thashë me vete**. Në atë kohë nuk kishte telefona celularë. Lidhja me Liken apo me Ramadanin për të anulluar ardhjen e tyre ishte e pamundur. Ku do ta strehoja gjithë atë sasi që do të vinte për gjithë periudhën fushore. Mesa duket, ai e lexoi mirë mimikën e prishur në fytyrën time dhe m'u drejtua me fjalët**:** "Ne **e kemi një vendstrehim**, nuk e kam parë në ç'gjendje është dhe a është i mbrojtur nga lagështia? Nuk di gjithashtu a është në rrezen e shikimit të rojes tonë?" Dakord komandant – i them - dalim ta shikojmë sa më pare, pa rënë errësira. Ashtu bëmë. Për fat, vendstrehimi ishte i pranueshëm. Po ashtu, hyrja ishte brenda rezes së shikimit të rojes së postës. Me pak punime riparimi e pastrimi, me vendosjen e disa metrove linear katrama, lagështia mund të eliminohej. **Në gjithë atë përshtjellim që kisha në mendje, m'u kujtuan mësuesit,** të cilët më kërkuan pikërisht **këtë material**. Ishallah tepron pak dhe për ata. Na u bë e rëndësishme dhe **katramaja** - thashë me vete. Kështu është, kur një mall të duhet, ai bëhet më me vlere, aq më tepër në majë të maleve. Duhet të porosisni një derë të salduar me shufra hekuri dhe të veshur me llamarinë për vendstrehimin apo **depon fushore** të lëndës plasëse – vijoi kamandant Kozmai. Çelësin e depos ta mbajë zjarmtari, duke bërë kujdes maksimal për çdo tërheqje ditore që bën dhe duke na vënë në dijeni për shqetësimin më të vogël. Mirë, - i them unë, do ta porosisim në Bulqizë portën metalike me dimensionet e hyrjes së vendstrehimit dhe së bashku me dy thasë çimento, shpresojmë të na i sjellin nga java tjetër. Disa ditë do të lëmë roje ditën, derisa porta të vendoset e të dylloset sipas rregullave. Ashtu ramë dakord. U morën masat që ngarkesa ta gjente vendstrehimin të gatshëm për vendosjen e materialeve eksplozive. **E kalova dhe këtë prove, - thashë me vete. Me korrentin dhe lëndët eksplozive gabohet vetëm një herë.** Komandant Kozmai **donte rregullin**. Rregulli **e mban botën,** do të ma përsëriste shpesh këtë shprehje në bisedat e mëvonshme, kur midis nesh do të ishte forcuar miqësia. Komandant Kozmai ishte një njeri i thjeshtë dhe familjare. Në të shumtën e rasteve ai e mbante familjen në postë, pa punë. Këto ishin kushtet e asaj kohe. Ndërtesa e postes kufitare i ngjante një stani. Brezi i sotëm e ka të vështirë t'i besojë këto që po tregoj, por realiteti është kokëfort. Nga ajo ditë nuk do të pranoja të filloja punë pa siguruar më parë lëndën plasëse dhe pa bërë instruktimin e sigurimit teknik.

* * *

Përshëndetem me komandantin e postës dhe drejtohem te baza e sapo ngritur. Sqaroj Sufën për sa bisedova dhe futem në çadër, duke u shtrirë mbi rrobat e fjetjes, ashtu siç isha, i veshur. Bluaja në mendje gjithë atë odise që kisha kaluar për të ardhur gjer këtu, në rrezen e maleve të Korabit, për dy ditë rresht. Ndërsa tentoja të merrja një sy gjumë, ndërkohë që Sufa po përgatiste diçka për të ngrënë **me furnellën e vajgurit, të cilën mezi e vumë në punë**, mendja më vajti tek disa shënime të babës për këtë vend, pikërisht këtu në stanet e Bjeshkës së Shehut dhe Abazallarëve, ku ai qëndroi vitin e tretë të verimit në bjeshkë, për t'u shëruar nga sëmundja e turbekulozit. Në fund të atyre shënimeve ai nënvizonte: "....**pas verimit të tretë në Bjeshkën e Shehut, pata shenja përmirësimi prej sëmundjes...".** Rreth 44 vite më parë ai kishte ardhur këtu, ndërsa unë i biri, vija 44 viteve më pas me një mision tjetër, për të kërkuar minerale, për t'i kthyer **"reston"** këtyre bjeshkëve mahnitëse e hijerënda. Ja çfarë shkruan prof. Xhafer Martini në librin **"Hoxha i Blliçes": "**Dihen vetitë shëruese të klimës malore për sëmundjen e tuberkulozit. **Sanatoriumet, për këtë qëllim, ngrihen në vende të tilla. Po klima e Korabit, mbase është më e dobishmja për këtë sëmundje.** Korabi jo vetëm ka bukuri mahnitëse, që në vetvete edhe ato shërojnë, po edhe ujë të ftohtë, ajër të kulluar dhe lloj - lloj lulesh që lëshojnë aroma të këndshme. Një mjek i shquar hebre**, dr. Shyqyriu** i mbetur në vendin tonë në mbarimin e Luftës së Dytë Botërore, dhe që ka shërbyer në spitalin e Peshkopisë vitet e para e pas luftës, në ditarin e tij ka shkruar: **"Dibra ka një nga sanatoriumet më të mira në botë, që shëron me ajrin e pastër, me ujin e pakrahasueshëm dhe me ato mijëra lule e bimë aromatike. Ky qeshtë Korabi".** Kur u largova nga ekipi ku kisha ngritur çadrën e parë të punës si gjeolog, vajta drejt e në fshat ku kisha prindërit. I tregova babës për gjithçka dhe i premtova se do ta çoja përsëri për t'i parë ato vise, por puna e solli që unë nuk e mbajta fjalën. Kështu ndodh në jetë. Jo të gjitha realizohen.

* * *

Gati darka, inxhinier – thirri Sufa plot gëzim, **sikur të na kishte skuqur në hell një qingj**. Menuja e ushqimit ishte me dy-tre asortimente. Nga NFP-ja e Bulqizës kishim marrë disa ushqime, midis tyre djathë dhe çaj kine me ca kuti të bukura. Darka më shijoi shumë. Ishim të lodhur dhe të uritur. Pasi shkëmbeva disa shaka me të (siç do ta praktikoja shpesh vite më vonë, sa herë që ai do të na sillte furnizime), i drejtohem me këto fjalë: Më thuaj të drejtën Suf, më mirë në male me mua apo në kooperativën e Muhurrit, duke punuar në fusha? Mos u tall me mua inxhinier, **kush nuk e din që petullat janë më të mira se buka** – përgjigjet Sufa në mënyrën luznake e me të qeshurën e tij karakteristike. Herët në mëngjes Sufa do të nisej për shtëpi, për të ardhur pas disa ditësh me furnizime ushqimore, ndaj fjetëm më heretë se zakonisht. Të nesërmen na prisnin punë të tjera. Rreth drekës erdhi lënda plasëse. Lika dhe Ramadani u morën me magazinimin e tyre në vendstrehim, duke u ndihmuar nga të zotët e kafshëve që bënë transportin. Ca kohë vajta dhe unë aty për ta ndjekur procesin, derisa u siguruan kapsollat, fitili dhe lënda plasëse. Atë natë në çadër ndenji vetëm Ramadani, pasi Lika u kthye. Nuk do të punonte atë verë me ne. Kishte ardhur për ndihmë meqë e njihte mirë rajonin dhe sigurimi teknik e kërkonte një gjë të tillë. Në darkë erdhën dhe një pjesë e punëtorëve si Enver Lamollari, Misim Daku, Xhevat Shehu, Esat Selmani dhe Sherif Ferati. Ishin nga fshatrat e kooperativës së Kalasë së Dodës si Kullasi, Tejasi, Cereni, Vasija, Ploshtani etj. Erdhën para perëndimit të diellit dhe patën mundësi të sistemohen në çadër. Të tjerët do të vinin të nesërmen në mëngjes. Bashkë me ta kishte ardhur dhe **guzhinieri Gani Kolgjini**, nga fshati Ceren, një djalë i ri, i mirë e i urte, por jo një guzhinier i aftësuar. Dalëngadalë ekipi po plotësonte organikën e vet. Pasi prezantohem me punëtorët, i drejtohem më të riut, Sherif Feratit, që të bënte roje te dera e vendstrehimit të lëndës plasëse. Ashtu kemi rënë dakord me komandantin e postës – vazhdova unë - gjersa të na vijnë nga Bulqiza pajisjet e derës dhe të bëhet betonimi i saj do të vendosim roja natën. Nuk e bëri fjalën dysh. Ashtu do ishin të gjithë punëtorët që do të punoja atë verë. Pa fjalë, pa ankesa, pa pretendime. Edhe nga çadrat ku ishim stacionuar, punën do ta kishin 1 deri ne 2 orë larg. Lodhje e madhe. Kështu e kanë kërkimet gjeologjike.

Për fat koha gjatë transportit dhe ngritjes së bazës së ekipit na mbajti mirë. Kjo na favorizoi shumë. Po të kishte rënë shi punët do të na shkonin keq e më keq. Koha e mirë në të tilla raste është më shumë se gjysma e punës dhe nuk ka të paguar kur thonë.

Ditën e tretë ekipi u plotësua. Erdhën me radhë edhe punëtorët e tjerë si Skënder Domi, Avni Përzhilla etj. Në drekë erdhi dhe teknik **gjeologu Ali Bardhi**. Kishte udhëtuar 7 orë nga **Sina e largët e Skënderbeut,** për të ardhur në rrezë të maleve të Korabit. Me Aliun nuk kisha punuar, por kisha dëgjuar për të. Ishte nga ana ime dhe kishte një përkushtim të madh në punë. Atë punë që bënte ai, **nuk qante**. Gjatë punës pata rastin të punoj dhe me teknikë të tjerë, por si Aliu nuk ishin. Aliu shkëlqente sidomos në drejtim të aftësive profesionale. Ai ishte inxhinier. I mungonte formalisht vetëm titulli i inxhinierit. Ishte shumë serioz në punë. Kur nuk kishim shumë punë, kaloja shpesh pasditet, duke lozur shah, pasi shahun e luante mirë.

Në darkë, meqenëse ekipi u kompletua mendova të bëj një takim të shkurtër. Pata shumë emocione. Prezantova programin e punimeve fushore dhe vendet ku do të punonim. Sqarova detyrat dhe pozicionin e secilit në ekip. Bëmë instruktimin teknik së bashku me Aliun dhe në fund ju them dy fjalë për kushtet e jetesës në ekip dhe rregullat e punës. Kjo ka qenë mbledhja e parë në këtë detyrë. Nuk do t'i harroj kurrë ato shqetësime që kam pasur gjatë gjithë atyre ditëve për stabilizimin e bazës dhe fillimin e punimeve. Pas gjithë asaj lodhje punët në ekip u futën në rrjedhën normale. Kanalet e kërkimit në të shumtën e rasteve merrnin rezultat. Fusha e kërkimit zgjerohej nga dita në ditë. Punimet e kërkimit u shtrinë dhe në shfaqje të reja që gjendeshin në punë e sipër. Sufa me veturën e tij ia kishte marrë dorën punës dhe na përballonte me furnizime. Kishte dhe raste që nuk vinte në ditën e caktuar. Në një ndër ato ditë që duhej të na sillte furnizimin nga Peshkopia, **nuk erdhi. Nuk erdhi as ditën tjetër.** Rezerva në ushqime për t'i mbajtur gjithë punëtorët në pune nuk kishim. Në këto kushte punëtorëve ju dhamë leje të shkonin në shtëpi dhe të vinin pas dy-tre ditësh, duke llogaritur se Sufa do të vinte. Bëmë si bëmë me Aliun, kaluam me ushqime, duke u ndihmuar dhe nga posta. Pas ca ditësh në darkë vonë Sufa do të vinte. Meqë kishte rënë errësira dhe shpresonim në ardhjen e Sufës, **kishim ndezur dy qiri** dhe po punonim mbi një hartë të detajuar gjeologjike të zonës së Gurëve të Pëllumbave. Nuk vonon shumë dhe zhurma për ardhjen e **"veturës"** (mushkës) së tij u dëgjua. Ashtu ishte. Sufa ndalon mushkën në sheshin para çadrave dhe thirri në emrin tim, pasi nuk dinte nëse kishte ardhur Aliu. Doli Aliu, u përshëndetën dhe së bashku shkarkuan mushkën. Unë ç'është e vërteta isha mërzitur pak, pse Sufa u vonua. Nuk ndejta pa i folur për vonesën. Ai nuk më ktheu asnjë fjale. Durimi mbi të gjitha, - thotë një fjalë popullore. Ishte tepër i lodhur. Këtë unë e dija. Kishte udhëtuar mbi 12 orë për të ardhur këtu. I kishte rënë rreth e qark qytetit për të blerë ato që i kishim shënuar në listë. Pas gjithë asaj lodhje së bashku me Aliun filluan të na përgatitnin diçka për të ngrënë. Unë e kisha ndërprerë punën në hartë dhe po pushoja i shtrirë mbi krevatin tim portativ në çadër. Pasi hëngrëm darkë, me qetësinë më të madhe dhe me zë të ulet m'u drejtua mua: Kishe të drejtë që më fole për vonesën. Duhej të kisha ardhur në datën e caktuar, pasi me bukën e punëtorëve nuk bëhet shaka por – vazhdoi Sufa – **Shqipëria është e vogël në ato hartat që punoni Ju**! Me mushkën time të ngarkuar **anash e në shalë dhe me Sufën** e moshuar **pas në këmbë, është e madhe inxhinier**! Nuk e lash të komentonte më tej, pasi donte të më shpjegonte arsyet e vonesës. Çfarë filozofie – thashë me vete! E shënova diku që të mos e harroja, se vitet kalojnë, gjërat harrohen, e shkruara mbetet. E shumta që pranohet t'u bëjë njeriu shënimeve e kujtimeve është t'i zbukurojë pak ato, por pa devijuar të vërtetën që ato mbartin. **Shkolla në auditore të mëson në një drejtim të caktuar** profesional, **kurse shkolla e madhe e jetës** të mëson edhe në shume drejtime të tjera.

**) Autori i këtij shkrimi ka gradën shkencore "Doktor", punonjës në Institutin e Gjeoshkencave, Universiteti Politeknik i Tiranës.*

Artikujt e saj mbi Shqipërinë janë botuar në shkrimin e kohës, por botohen si libër për herë të parë si rezultat i punës së shkëlqyer të historianes dhe përkthyeses Ilda Poda.

Një libër me vlera për miqësinë shqiptaro-zvicerane

Dy fjalë për autoren Nowlle Roger dhe bashkëshortët Helene e Eugen Pittard.

Nga **SAKIP CAMI**

Nowlle Roger është pseudonimi i sh krimtares zviceriane Helene Pittard.

Helene Pittard-Dufour ishte e bija e botuesit të njohur zvicerian Theophile Dufour, botues i korespondencës së iluministit të shquar të shek. 18 nga Gjeneva Zhan Zhak Ruso.

Ajo ka lindur më 25 shtator 1874 dhe ka vdekur më 14 tetor 1953.

Është e njohur si shkrimtare me një sërë romanesh si "Trojanët", "Doktor Germaine", "Zjarr mbi mal", "Shënimet e një infermierje", "Zgjedhja e Andromakës" , "Adami i ri" etj. Shkroi me pseudonimin Noëlle Roger.

Artikujt e saj mbi Shqipërinë janë botuar në shkrimin e kohës, por botohen si libër për herë të parë si rezultat i punës së shkëlqyer të historianes dhe përkthyeses Ilda Poda.

Bashkëshorti i saj Eugen Pittard (1867-1962) ka qenë professor dhe antropolog i njohur i Universitetit të Gjenevës, një nga themeluesit e antropologjisë në Zvicër.

Ai ka marrë udhëtime të shumta në vendet e Ballkanit dhe ka bërë studime të shumta në fushën e antroplogjisë. Së bashku me të shoqen erdhën edhe në Shqipëri.

Ndër botimet e tij shkencore janë: "Popujt e Ballkanit" 1920, "Racat dhe historia.Hyrje etnologjike e historisë"1924, "Historia e njerëzve të parë" 1944.

Pittard ka meritën historike sepse vendosi disa piketa vendimtare në fushën e arkeologjisë parahistorike dhe antropologjisë fizike. **Sipas Pittard shqiptarët i përkasin, në pjesën më të madhe një grupi njerëzor, karakteristika kafkore e të cilit është brakicefalia. Sipas këtij studimi shqiptarët kanë ruajtuar të paprekur tipin e veçantë të ilirëve të mëdhenj me kafkë hiperbrakicefale, një prej racave më të lashta dhe më të bukura të Europës.**

Eugen Pittard zhvilloi gërmime arkeologjike në Shqipëri, pranë Liqenit të Prespës ku zbuloi shtresa të neolitit. Sipas këtij studimi, pas gërmimeve arkeologjike, del se origjina e shqiptarëve shkon thellë në kohë, përtej ilirëve, përtej përëndive të Homerit, përtej pellazgëve. (Buzë Liqenit të Prespës, Skicë nga Shqipëria, 21.12.1921.

Për kontributin e tij në favor të Shqipërisë Eugen Pittard është emëruar nga Qeveria Shqiptare e vitit 1921 Konsull Nderi i Shqipërisë në Zvicër. (Dekreti i Këshillit të Lartë të Shtetit 29.01.1921, AQSH MPJ F251 V.1921,D.4, f15-16)

Bashkëshortët Helene dhe Eugen Pittard kanë qenë miq të shquar të Shqipërisë dhe kanë dhënë një kontribut të shquar për forcimin e miqësisë tradicionale midis dy popujve tanë.

SHQIPËRIA E VITEVE 1914-1924 SIPAS SYRIT TË SHKRIMTARES ZVICERIANE

Noëlle Roger erdhi në Shqipëri në një kohë tepër të vështirë, në periudhën e Luftës së I Botërore, fill pas fitores së pavarësisë nga sundimi 500 vjeçar otoman dhe në vitet e para të përpjekjeve pët tu bërë shtet normal europian në vitet 1914-1924.

Roger është dëshmitare e ardhjes së Princ Vidit në Shqipëri dhe e përpjekjeve për formimin e një shteti modern në një kohë kur fuqitë e mëdha kishin plane për copëtimin e saj.

Në këto vite të vështira kur Shqipëria vuante nga varfëria e tejskajshme dhe mungesa e arsimit dhe zhvillimit, Roger me mendje të mprehtë dhe me dashuri njerëzore vuri re dhe shkroi për vetitë dhe vyrtutet e mrekullueshme të shqiptarëve duke e vënë theksin tek karakteri i tyre i fortë, bukuria, forca shpirtërore, dinjiteti, mikpritja, bujaria dhe besa.

Shkrimtari dhe studiuesi Prof.Nasho Jorgaqi e quan Roger një Edit Durham zviceriane.

Shqipëria dhe Zvicra kanë patur miqësi tradicionale. Rilindasit tanë e kanë patur modelin e tyre, për ta bërë Shqipërinë si Zvicra. Intelektuali erudit Mithat Frashëri (Lumo Skëndo) në vitin 1915 pasi jetoi për një kohë të shkurtër në Zvicër shkroi dhe botoi librin „Letra mbi një udhëtim në Zvicër".

„Modeli" zvicerian ka luajtur një rol të madh në vitin 1912 për lëvizjen kombëtare shqiptare në krijimin e shtetit shqiptar .

Kushtetuta demokratike dhe ideja e neutralitetit të Shqipërisë janë frymëzuar nga Zvicra neutrale.

Libri me shënime udhëtimi i Rogerit , përkthyer dhe përshtatur për botim me kujdes dhe profesionalizën nga pwrkthyesja dhe studiuesja e historisë Ilda Poda, hapet me shkrimin "Shkodra e Shqipërisë".

Përveç Edith Durhamit, edhe Noëlle Roger përshkruan me realizëm luftimet për mbrojtjen e Shkodrës nga pushtuesit malazezë, duke e vënë theksin tek gjëndja e shkatrruar e Shkodrës së Shqipërisë.

Më pas libri vazhdon nëpër gjithë Shqipërinë, Durrësin, Tiranën, Elbasanin, Lushnjën, Beratin, Korçën etj.

Çifti Eugen dhe Helene Pittard (Noëlle Roger) udhëtuan nëpër Shqipëri në kushte tepër të vështira materiale. Ata ecën herë në këmbë dhe herë me kuaj, rrallë herë me makinë. Ata i njohën nga afër fshatarët shqiptarë, sepse kryesisht udhëtuan nëpër fshatra, njohën zakonet dhe traditat e tyre.

Ata kontaktuan dhe jetuan me myslimanët, me katolikët, me ortodoksit, me të gjithë shqiptarët nga veriu në jug. Vizituan xhamitë, teqetë dhe kishat shqiptare, vizituan pazaret karakterisitike të Shkodrës dhe Krujës, kontaktuan me deputetë e fisnikë shqiptarë dhe kudo gjetën mirëkuptim dhe bujari. Rogër përshkruan ngjarjet dhe figurat kryesore të Shqipërisë, periudhën e Skënderbeut dhe periudhën e shpalljes së pavarësisë. Ajo mban qëndrim të prerë në favor të shqiptarëve duke kritikuar vendimet e padrejta të fuqive të mëdha për copëtimin e Shqipërisë në vitin 1913.

"Ky popull i vogël malsorësh, shkruan autorja zviceriane, nuk ka kërkuar dhe nuk kërkon veçse paqe, me qëllim që të ndreqë rrënojat e shkaktuara nga luftrat e vazhdueshme dhe të shijojë lirinë e sapofituar." Duke u ndalur në copëtimin e Shqipërisë në vitin 1913, këtë vepër autorja e quan "ironi mizore" , sepse jeta e shqiptarëve në ato vite ishte tragjike, si pasojë e vendimeve të mohimit të të drejtave të ligjshme. Ajo përshkruan me dhimbje edhe viset e copëtuara të Shqipërisë, duke treguar lidhjet organike me trungun amë.

Në përshkrimet e Rogerit ndjehet dashuria dhe dashamirësia për këtë popull e për këtë vend. Ajo evidenton se populli shqiptar nuk është një popull i mbyllur, primitiv e agresor siç përpiqen ta përshkruajnë disa shkrimtarë të huaj keqdashës, por një popull i qytetëruar, mikpritës e miqësor, gjithnjë në kërkim të rrugëve të progresit.

Ajo i paraqet shqiptarët, ashtu siç janë në vërtetë ata, të vytytshëm, të thjeshtë e punëtorë, të varfër e të ndershëm, me një botë të pasur shpirtërore, krenarë e dinjitozë, luftëtarë për çështjen e madhe kombëtare.

Shqiptarët kanë ditur dhe dinë të jetojnë në fqinjësi të mirë me fqinjët sllavë e grekë, me gjithë përpjekjet e qeverive të tyre për aneksime territoresh.

Shqiptarët janë ndoshta i vetmi vend me një tolerancë dhe bashkëjetesë të admirueshme fetare.

Ja si e përshkruan Roger këtë bashkëjetesë në artikullin " Shqipëria përballë Europës" :

"Disa ditë më parë në një kishë ortodokse të Tiranës po kremtohej shërbimi funebër për një oficer shqiptar të krishterë, i cili kishte vdekur. Në këtë ceremoni merrnin pjesë edhe myslimanë, të cilët mbanin edhe një prej kurorave. Hoxhallarët mbanin qirinjtë. Prifti i krishterë nderoi Muhametin dhe hoxha mysliman nderoi Jezu Krishtin…

Ndodh që myslimanët martohen me gra të krishtera dhe të krishterët me gra myslimane…

Kështu e kuptojnë bashkimin e kryqit me gjysmën hënën shqiptarët , gjë që përëndimi nuk ka rrështur kurrë së kundërshtuari.

Dashuria për atdheun trashëgohet brez pas brezi tek shqiptarët. "Mendo gjithnjë për Shqipërinë, i thoshte një prind pak para se të vdiste djalit të tij 13 vjeçar." Dhe këtë vyrtyt nuk kish si ta kalonte pa vënë re shkrimtarja dhe sdudiuesja dashamirëse zviceriane Noëlle Roger.

Kujtimi për Skënderbeun kalon nga një brez në tjetrin. Ky është heroi kombëtar i shqiptarëve , të cilët e kanë të shenjtë, dhe jo vetëm shqiptarët por tërë Europa sepse ky kalorës legjendar mbrojti tërë krishtërimin europian.

Pasi përshkruan tërë Shqipërinë me udhëtime dhe me kujtime të shkruara e të botuara autorja e mbyll librin e saj me artikullin simbolik:"Ku shkon Shqipëria?" dhe "Revolucioni shqiptar" të qershorit 1924 dhe me shqetësimin e sinqertë se si do të ecte Shqipëria.

Në këto shënime të sinqerta udhëtimi përshkruhet Shqipëria siç ka qenë në ato vite, por në këto shënime ka edhe shpresë edhe rrugëdalje që di ti japë një shkrimtare, një vëzhguese e mprehtë shoqërore si Noëlle Roger.

Libri është përkthyer dhe përshtatur me mjeshtëri nga përkthyesja, studiuesja dhe historiania Ilda Poda dhe është një kontribut me vlera të mëdha në mardhëniet miqësore midis Shqipërisë dhe Zvicrës.

Kush është Ilda Poda (Cani)

Ilda Poda (Cani) ka lindur në Peshkopi me 22 qershor 1965. Është e bija e mjekut të shquar Dr. Mehdi Cani dhe e zonjës Tefta Cami ish ministre e Arësimit dhe Kulturës së Republikës së Shqipërisë në vitet 70-80.



Me prindër dibranë, babai nga Zerqani dhe nëna nga Viçishti, ajo trashëgoi një dashuri të madhe për vendlindjen e saj dhe të prindërve, Dibrën. Ajo ec me dëshirë dhe passion në gjurmët e patriotizmit të gjyshit të saj Ahmet Cami, dëshmor i Atdheut, e të stërgjyshërve të saj dëshmorë të atdheut në luftën për liri e pavarësi kombëtare.

Ilda ka mbaruar shkollën e mesme të gjuhëve të huaja për gjermanisht dhe shkollën e lartë për histori e gjuhë gjermane, në Fakultetin Histori-Filologji.

Nga viti 1987 deri në vitin 1993 ka punuar si punonjëse shkencore në Institutin e Historisë dhe nga viti 1993 e në vijim ka punuar në përfaqësitë diplomatike të Shqipërisë në Zvicër dhe Kanada në Ambasadën e Republikës Gjermane në Tiranë, në Shkollën e Magjistraturës si pedagoge e gjuhës gjermane, dhe në shumë projekte ndërkombëtare.

Aktualisht punon në Ministrinë e Punës, të Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në sektorin e Politikave Sociale.

Në vitin 1998, pas një pune dy vjeçare nën drejtimin e Profesorit zvicerian Carsten Goehrke dhe Prof. Arben Putos mbrojti temën për "Historinë e mardhënieve Shqipëri-Zvicër 1918-1944.

Në Universitetin e Zyrihut , Zvicër nga viti 1993-1996 ka kryer studimet pasuniversitare në fushën e historisë dhe gjermanistikës.


Në periudhën 2007-2008 ka mbrojtur titullin Master për Studime të Thelluara për Punë Sociale në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës.

Ka kryer dhjetra trajnime e specializime brenda e jashtë vendit në fushën e sociale dhe të historisë.

Ka botuar disa artikuj dhe përkthime në shtypin shqiptar dhe atë zvicerian , ku më i rëndësishmi është studimi mbi Historinë mardhënieve Shqipëri-Zvicër 1918-1944.

Vjen para lexuesit me librin e ri "Nëpër udhët e Shqipërisë".

Ky botim është jo vetëm përkthimi i artikujve të shkrimtares dhe gazetares zviceriane Noëlle Roger , e pranishme në Shqipëri në vitet 1914-1924, por edhe përzgjedhje dhe përgatitje për botim.



rekuiem

Kujtime të një historie të dhimbshme, por që dëshmojnë për kurajo dhe dashuri njerëzore...

"11 heronjtë e Batrës"

Me rastin e 34-vjetorit të rënies së 11 heronjve. Sipas bisedës me të mbijetuarin, Bajram Cara



Nga: **YMER KETA**, Bulqizë

Rekuiem për Neshat Qokun, Emin Pershakun, Mynir Nurçen, Hysen Toskën, Dilaver Rukilen, Reshat Rukilen, Skënder Tomjen, Subi Kadriun, Shaban Hoxhen, Myslim Mazarin dhe Avdyl Vërlakun.



Në foto: Bajram Cara

Ishte ditë e një mes shkurtit e vitit në Batër. Ekipi gjeolog kërkues ishte instaluar në këto majë malesh. Malet e Lopës, Dhoksit e të Martaneshit ishin ngarkuar me dëborë të madhe që i kalonte 2 m. Si çdo herë tjetër, në këtë muaj dëbora e rënë ngrinte dhe këmbësorët e kishin më të lehtë për të lëvizur. Çdo gjë dukej si një shkretëtirë e bardhë e ftohtë që shpesh e lëpinte era e rreptë. Jeta në këto male ishte e qetë. Hyrja në barake ishte bërë si tunel. Në mbrëmje gjeologët ktheheshin të lodhur dhe me duar të mpira nga të ftohtit e acari, duke u përshëndetur me njëritjetrin, duke u grumbulluar rreth stufës, duke treguar ndonjë anekdodë, hanin e më pas shtriheshin për të fjetur.

Po çfarë s'ndodh në jetë! Gjithë kjo qetësi e bardhë vjen te data 16 shkurt dhe kjo qetësi u prish. Dikujt i hyri dyshimi. Pse xhanëm, po vonohet Neshat Qoku? Ky ishte një specialist (kryesondist) në sondat e kërkimit të mineralit të kromit në Batër, njeri me karakter të fortë, që kurrë nuk e bënte fjalën dysh.

Neshati kishte marrë leje për 4-5 ditë (pushimet e muajit) pasi gruaja e tij kishte lindur një vajzë, por koha po ikte dhe Neshati s'po bëhej i gjallë. Brigadieri Muharrem Tyçi pasi kaluan pesë ditë, i thërret shokët e punës të Neshatit dhe jo thotë se duhet njoftuar ndërmarrja në Bulqizë për vonesën e Neshatit. Të nesërmen në mëngjes u nis korrieri i sektorit për në qytezën e Bulqizës, ku ishte e vendosur ndërmarrja.

Dëbora binte pa pushim. Era e fortë e hidhte atë sa në një tjetër të atyre përrenjve e grykave të Batrës. Korrieri dhe pse ishte i ri e i fortë fizikisht e pati mjaft të vështirë për të ngjitur e zbritur qafat e grykat e mbuluara me dëborë. "Sikur të mos jetë nisur nga shtëpia Neshati mendonte korrieri!". Së fundmi gjatë asaj rruge të vështirë, në të errur korrieri mbërriti në drejtorinë e ndërmarrjes. Bëri takim me drejtuesit, ku një nga inxhinierët i thotë korrierit: - Çdo Neshati në të gjithë këtë kiamet, or t'u mbylltë! Neshati nuk ka ardhur në punë. Jo, jo se ai ka kohë që ka...

Dhe dyshimi kaloi nga Batra e gërxheve e pyjeve dhe erdhi në Bulqizë. Po sikur?...

- U lajmërua Kllobçishti. Deshati i thonë ata ka një javë që është nisur.

Ishte i hidhur ky lajm për shtëpinë e Qokeve. Djali erdhi në zijafet, piu e këndoi e tani ku ta dish se nga do të ketë mbetur! Ngrihet Baftjari, i vëllai Neshatit, ashtu siç ishte i sëmurë, ngrihen dajot e tij e kushërinj nga fshati dhe marrin rrugën për në Bulqizë.

Kishin kaluar shumë vështirësi gjatë rrugës por ashtu të mërzitur për Neshatin nuk e ndienin lodhjen.

– Nuk ka ardhur Neshati? – Mbajeni veten i thonë drejtuesit. Nuk kanë humbur të gjitha shpresat, - u dha zemër drejtori. Pastaj u tha të merrni me vete dhe 4 shokë të tjerë nga Bulqiza e të dilnin të nesërmen të kërkonin nga Qafa e Buallit, në Lugun e Shtyllës e në Batër. Në mëngjesin e së nesërmes së bashku me Baftjarin, i pari printe korrieri së bashku me nëntë vetë të tjerë filluan udhëtimin në atë shkretëtirë të bardhë, që era e fortë të priste si brisk. Ata të gjithë bashkë ecnin, ecnin. Asgjë s'pitëtinte, asgjë s'dukej. Ecnin e heshtnin. Ndërronin njëri-tjetrin për të hapur udhën se ishte mjaft vështirë. Të gjithë së bashku kërkonin shokun e të dashurin e tyre, mikun të afërmin. Ngatërrohen mendimet e përfytyrimet. Një shkurre që nxin, një dru që ka mbetur i pambuluar nga bora u dukej si njeri i ekipit të kërkimit, sikurse është ai... Ai tani mund të jetë atje, mund të ketë rënë poshtë në...

Të lodhur e të rrahur nga era, pasi kanë kërkuar gjithë ditën ata në të errur arrijnë në Barakat e Batrës. Mblidhen shokët e Neshatit rreth tyre. Flasin rrallë e mendohen. Nga të ketë shkuar, vallë? Kujtojnë ndonjë ngjarje të Neshatit, sjellin në mend ndonjë shaka të tij. E bre, se dhe për mua vjet ashtu menduan, sikur vdiqa, kurse unë shkova në Valikardhë – tha Hysen Toska, normist në këtë sektor.

- Ty të bëmë kivolin. Menduan se kishte rënë nga shkëmbi.

- E pashë arkivolin. Po ku më nxinte ai mua! – tha Hyseni duke qeshur. E megjithatë përpjekjet për të ngushëlluar të afërmit e Neshatit e miqtë e tij, njerëzit prapë heshtnin, rreth stufës së skuqur nga zjarri, e dukej sikur prisnin diçka të kobshme. Errësira kishte pllakosur atë rrëzë mali ku jetonin ato gjeologë, sa herë që hapej e mbyllej dera e barakës, futej brenda së bashku me erën dhe bora që s'po pushonte së rëni, ku trashësia e saj sa vinte e shtohej. U shtrinë për të pushuar në ata shtretër dërrase por gjumi, s'po i zinte. Sapo mbyllnin sytë shikonin ëndrra të trazuara. Të afërmit e Neshatit s'vunë gjumë në sy, prisnin të dalë drita.

Drita doli e prapë mbi çatitë e bakave filloi të dali tym. Të gjithë mendjen e kishin te Neshati. Shoku është i dhëmbshëm, shoku është i dashur, shoku ka humbur... Gjithë ditën e djeshme 10 veta e kërkuan Neshatin e nuk e gjetën. Atëherë me këto 9 veta u bashkuan dhe 11 të tjerë të ekipit gjeolog, duke krijuar kështu një ekip kërkimi. Nën drejtimin e brigadierit Muharrem Tyçi, u pezullua puna në sonda u pajisën me lopata, dolën nga baraka për të kërkuar Neshatin të cilët menduan se do të ketë rënë nga shkëmbi i Batrës duke ardhur në Kazermë. Së bashku me këtë ekip u bashkua dhe Avdyl Vërlaku që ishte i vjetër në punë dhe e njihte mirë këtë sektor. Muharremi nuk e lejoi duke i shpjeguar se neve jemi ndarë në dy turne, njëri turn do të bëj kërkime paradite, ndërsa tjetri mbas ditë.

Ata mendonin që Neshati gjatë kthimit të jetë ulur të pijë ujë në ndonjë vend dhe, nga të ftohtit mundet të ketë pushtuar gjumi ...

Era vërshëllente në drurët e zhveshur njëzet burra kërkonin Neshatin e dashur. Ata u sollën poshtë e përpjetë, zbritën në përroin e Zallit të Limonës, nën shkëmbinjtë e Batrës. Të dëshpëruar të heshtur, ata vendosën të ktheheshin në Barakë, ku papritur njëri thirri duke ngritur diçka të zezë në dorë:

- Një dorashë, një dorashkë! Rreth asaj dorashkë të vjetër prej leshi u mblodhën kërkuesit dhe drejtuan sytë nga ne heshtje. Baftjari i vëllai i Neshatit e mori në dorë dhe, me pikëllim në zemër tha:

- E Neshatit... e vëllai dorashka.

Dorashka kishte mbetur mbi një majë guri. Deshatit me siguri do t'i kishin shkarë këmbët dhe do të ketë rënë në përroin e mbushur me dëborë, diku poshtë këtij shkëmbi... Dorashka.

Dhe filloi puna në shkëmbin e Batrës, një punë e rëndë, e heshtur dhe e pikëlluar.

- Po edhe i vdekur të jesh more Neshat, ne do të jemi pranë teje si gjithnjë. Neshat i dashur! Hape këtu, më duket se...

Edhe pak! Bora që po binte i kishte kaluar 3 m. Në këtë kohë, papritmas një zhurmë e madhe që i ngjante një shpërthimi dinamiti, ku buçiti e gjithë lugina e mali i Batrës. Valet e nxehta të ajrit u përplasën në fytyrat e njerëzve që kërkonin Neshatin, ku 10 prej tyre orteku i shkëputi dhe i fundosi në përrua, duke i mbuluar me një masë të mëdha borë, kurse 4 prej tyre i përplasi në faqen tjetër të malit, siç ishin Muharrem Tyçi, Isuf Duriçi, Baftjar Qoku i vëllai i Neshatit dhe Bajram Cara që ngelen të gjallë...

Orteqet pasonin njëri-tjetrin, pasi borës së re s'po i bënte vend e vjetra që kishte zënë vend më parë në ato rrëza shkëmbinjsh. Në ortekun e parë humbën 10 veta kështu që numri i të zhdukurve arriti në 11. Për këtë katastrofë natyrore u aktivizuan instancat e pushtetit lokal e qendror, duke u mobilizuar dhe ushtrinë, Korpusi i Burrelit më shumë forca u nisën në drejtim të Batrës, për t'i vajtur në ndihmë ekipit të dëmtuar, duke u dhënë ndihmën e nevojshme, morale, psikologjike, fizike duke u shoqëruar atyre që i shpëtuan vdekjes nga orteqet.

Forcat e ushtrisë si garanci ndërprenë udhëtimet duke mos lejuar asnjë person të lëvizë në drejtim të Batrës, apo të hynte në atë zonë ku ndodhi orteku e nën dëborë ndodheshin 11 viktimat. U dha urdhër nga forcat komando që ekipi që ndodhej në Batër të lëvizte në mënyrë të organizuar në drejtim të Krastës, ku udhëtimi ishte tepër vështirë pasi trashësia e borës i kalonte 3.5 m, ku me ndihmën e ushtrisë dhe të banorëve të zonës, me lopata hapen rrugën pas 5 orësh dhe bënë të mundur lëvizjen e gjeologëve në Kraste. Ditët kalonin tërë ankth. Erdhi data 27 shkurt neve vazhdonim në Krastë. Bora s'po pushonte. Orteqet vazhdonin ku zhurma e tyre oshtinte në të gjithë krahinën e Martaneshit. Më dt. 29 shkurt 1965 u organizua lëvizja e gjeologëve që kishin ngelur të gjallë. Nisja u bë nga Krasta-Staveci, në Qafë të Madhe dhe prej aty me makinat ushtarake për në qytezën e Bulqizës. Pritja u bë në klubin minatori, nga drejtues të pushtetit të rretheve Dibër e Mat, ku u evidencuan saktësisht viktimat e ortekut, nga ku u dhanë ndihmat e nevojshme familjeve të tyre. Njëkohësisht u morën masa të rrepta që në zonën ku kishte ndodhur kjo fatkeqësi e trupat e pajetë ishin nën dëborë të mos futej këmbë njeriu.

Neve, shpjegon Bajram Cara, filluam pushimet pranë familjes, por mendja na rrinte te shokët që ishin nën dëborë. Iku marsi, sa filloi të hiqej bora nga mesi i muajit prill, filluan përsëri kërkimet. Pas një pune të rëndë, të heshtur e të pikëlluar. Të lodhur e të rraskapitur, ktheheshim në baraka. Mendja ishte fiksuar te shokët tanë që akoma s'po i lironte bora. Ata ishin Neshat Qoku, Emin Pershaku, Mynir Nurçe, Hysen Toska, Dilaver dhe Reshat Rukila, Skënder Tomja, Subi Kadriu, Shaban Hoxha, Myslim Mazari dhe Avdyl Vërlaku.

Erdhi fundi i prillit, nga kërkimet e bëra herë pas here u bë e mundur gjetja e trupave të pajetë të shokëve tanë. Zona e Martaneshit u vesh në zi. Edhe pse të gjithë të rënit nuk ishin nga zona e Martaneshit por nga fshatrat e Dibrës, ata u mblodhën dhe shoqëruan kortezhin në zonat e tyre.

Për këtë ngjarje u mblodh Këshilli i Ministrave dhe Presidiumi i Kuvendit Popullor, ku me vendim të veçantë u shpallën dëshmor dhe Miniera e Kromit të Batrës mori emrin "11 heronjtë".

Pajtohuni në gazetën "Rruga e Arbërit"

www.dibra.org

BËHUNI PJESË E GAZETËS!

*Pajtimi në gazetë kushton 600 lekë në vit dhe gazeta ju vjen me postë në shtëpinë tuaj**

Tel. (04) 22 33 283. E-mail: rrugaearberit@gmail.com.

Numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit.

* Për ata që duan që gazeta t'ju shkojë me postë në shtëpi, ju lutem konfirmoni në redaksi adresën e saktë

Rruga Arbërit nr. 33
kujtesë

Një profil i Bashkim Gazidedes, me rastin e 57 vjetorit të lindjes, shkruar me shumë dashuri dhe realitet nga prof. dr. Adem Bunguri.

Bashkimi i kishte shokët e rrallë



Nga **ADEM BUNGURI**

Me 2 shkurt 2009 Bashkim Gazidede do të mbushte 57 vjet! Por ai iku nga kjo botë shumë më shpejt, në një moshë ende të re, më 25 tetor 2008. Që prej asaj dite nuk është më në mesin tonë qytetari i dashur e i ndershëm, shkencëtari brilant, pedagogu i shquar, nëpunësi i lartë shtetëror dhe atdhetari i flaktë Bashkim Gazidede! Të gjithë ne që e kemi njohur, bashkohemi me mendimin se për njerëz polivalent si Bashkimi, jeta nuk duhet të ishte aq e shkurtër! Por kjo mbetet vetëm një dëshirë njerëzore, pasi jeta drejtohet nga ligje të tjera. Megjithatë, në analizë të fundit, meqë të gjithë jemi shtegëtarë të përkohshëm në këtë botë, nga jeta e gjithësecilit, në substancë mbetet trashëgimia që lë çdonjeri pas vetes. Se vlera e jetës nuk matet gjithnjë me jetëgjatësinë! Se mund të rrosh edhe 100 vjet dhe të ikësh nga kjo botë anonim! Në këtë kontekst Bashkim Gazidede është dhe do të jetë shumë gjatë në mesin e të gjallëve! Për vlerat e tij të shumëanshme, ai ishte dhe do të mbetet një ikonë e njeriut të gjithëvyrtytshëm, që Zoti e kishte dërguar në tokë, si model për njerëzit e tjerë!

Ai ishte kthyer në Tiranë më 10 dhjetor 2005, gjithë shpresë e optimizëm, pas 8 vitesh të vështira të ekzilit politik. Të një ekzili të lodhshëm e të varfër, dhe të një izolimi të plotë e të gjithanshëm. Megjithatë, si rallë kush, ai i kishte rezistuar kësaj sprove të rëndë e cfilitëse. Madje, ai kishte përgatitur dhe kishte sjellë me vete edhe 8 libra matematike për studentët e tij, teori dhe ushtrime të zgjidhura, me mbi 800 faqe secili, që të mbledhura bashkë i kalojnë 6500 faqet! Një nga dëshmitë e karakterit të tij të fortë e të papërkulshëm dhe një prej trashëgimive më të shkëlqyera intelektuale, që do ta përjetësojnë emrin e tij në historinë e zhvillimit të matematikës në Shqipëri si dhe në memorien e studentëve të shumë brezave. Për 8 vjet rrjesht ai nuk u pa me njerëzit e dashur, nuk u pa me prindërit e tij të dhëmshur, ndërsa nënën, Nujen e tij të mirë, nuk do ta shihte më kurrë! Ishte maji i vitit 2004 kur Nuja e tij, në shtratin e vdekjes, kërkonte të shihte birin e dashur, të cilit, vetëm zërin ia dëgjonte rrallë në telefon! Por nuk qe e thënë! Në vitin 1968, kur Bashkim Gazidede, vetëm 15.5 vjeçar, mbaronte parakohe me rezultate të shkëlqyera gjimnazin e Peshkopisë, pushteti komunist i kohës, në vend që t'i ofronte këtij djaloshi të talentuar të zgjidhte shkollën më të mirë brenda ose jashtë vendit, e dërgonte si mësues në një nga zonat më të thella të rrethit(Selishtë)! Megjithëse në moshë ende të njomë, ai do të shkonte të mësonte fëmijët e këtij fshati midis malesh, 40 km larg shtëpisë së tij, ku mund të kthehej vetëm të shtunave, pasi të kishte ecur në këmbë 8-9 orë rrjesht! Në tri vitet e tjera, 1969-1972 ai do të shërbente si mësues i matematikës në shkollën 8 vjeçare të Muhurit, 10 km larg shtëpisë së tij. Pikërisht në këtë kohë, duke ecur çdo ditë në këmbë, në shi e në borë, 4 orë në ditë, djaloshi 17-20 vjeçar Bashkim Gazidede do të sëmurej nga reumatizmi artrit i gjurit të majtë!

Viti 1972 do të ndryshonte përgjithnjë jetën e tij. Pas kërkesash të përvitshme për të ndjekur shkollën e lartë, do të organizohej më në fund një takim i hapur politik në fshatin e tij të lindjes Brezhdan, *për të ndëshkuar ose për të lejuar* Bashkim Gazideden të vazhdonte studimet. Arsyeja e kësaj pengese ishte e paimagjinueshme! Babai i tij i nderuar, Osman Gazidede ishte besimtar islam, si të gjithë banorët e Brezhdanit, të Dibrës e më gjërë! Por ndryshe nga shumica e tyre, ai nuk kishte pranuar të mohonte qenjen dhe besimin e tij islam! Një karakter i fortë për t'u patur zili e për t'u admiruar! Pas debatesh të shumta pro dhe kundër, më në fund, forcat e errta komuniste ishin tërhequr. Në shtatorin e atij viti Bashkim Gazidede do të fillonte studimet e larta për matematikë-fizikë, jo në Tiranë ku ai dëshëronte, por në Universitetin e Shkodrës, që në atë kohë shihej si i një rangu të dytë.

Megjithëse i vijonte mësimet pas 4 vjet shkëputje, ai ishte në të njëjtën moshë me studentët e tjerë, falë faktit që i kishte filluar mësimet në klasën e parë në shtator 1957, kur ishte vetëm 5.5 vjeç(!) si dhe pasi arsimi 8 vjeçar në atë kohë ka qenë 7 vjeçar! Shumë shpejt ai do të spikaste si student i shkëlqyer duke tërhequr vëmendjen e pedagogëve dhe të të gjithë studentëve. Ai ishte studenti i vetëm që i mori të gjithë provimet me vlerësimin maksimal 10, e po të kishte notë 20, ai sigurisht që do ta merte! Megjithatë u gjet një lëndë ku ai u vlerësua me notën 9, dhe ajo paradoksalisht ishte stërvitja ushtarake! E pikërisht kjo 9, e vetmja në të gjithë jetën e tij shkollore, e rastit apo e qëllimshme, mjaftonte për ta privuar fenomenin Bashkim Gazidede nga marja e medaljes së artë! Që student, ai përgatiti për botim një vëllim me ushtrime dhe lojra tërheqëse matematike në shqip dhe në anglisht (puzzles), që megjithëse nuk u botua kurrë, dëshmonte për polivalencën e tij shkencore! Për vlerat e tij si student i shkëlqyer, dëshmon edhe diploma e mirënjohjes e dhënë nga Universiteti i Shkodrës me 22 prill 2008, të cilën dua t'ja përcjell të plotë :

"M I R Ë N J O H J E"

Z. Bashkim Gazidede

"Departamenti i Matematikës së Universitetit të Shkodrës " Luigj Gurakuqi" shpreh respektin e tij të veçantë për ish studentin tonë Bashkim Gazidede, matematicienin dhe pedagogun e shquar. Falenderojmë z. Gazidede për ndihmesën e madhe që ai ka dhënë në drejtim të përmirësimit të proçesit mësimor tek Departamenti i Matematikës, në mënyrë të veçantë me librat e përgatitur me profesionalizëm prej tij. Shprehim konsideratat tona të sinqerta për punën e palodhur, respektin dhe mirënjohjen për figura të shkencës dhe të arsimit si z. Bashkim Gazidede, i cili na ka nderuar edhe ne si ish pedagogë të tij".

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Fakulteti i Shkencave të Natyrës
Departamenti i Matematikës
Shkodër, më 22. 04. 2008

Dhe shokët e miqtë e tij erdhën me zemër të dridhur dhe lot në sy, për ta përcjellë Bashkim Gazideden në altarin e përjetësisë. Erdhën nga Amerika dhe Europa, nga Kosova dhe nga e gjithë Shqipëria! Se Bashkim Gazidede është i të gjithë Shqipërisë! Dhe Shqipëria e vërtetë u përul para tij duke e nderuar si hero!

Mirënjohje e respekt të thellë për Bashkimin shfaqën jo vetëm shokët e tij të studimeve e të punës dhe miqtë e tij anë e kënd Shqipërisë, që vinin dhe e vizitonin periodikisht kur ai ishte sëmurë, por edhe qindra qytetarë të thjeshtë të Shkodrës, kryeqyteti i kulturës sonë, që ndjeheshin krenarë, që ai ishte shkolluar në qytetin e tyre! Ylber Meraja, një nga shokët e tij të studimeve, tregon se sapo ishte marrë vesh sëmundja e Bashkimit, çdo ditë në rrugë dhe në shtëpi do ta takonin me qindra njerëz të thjeshtë, që të shqetësuar e pyesnin për shëndetin e Bashkim Gazidedes! Në takimin përkujtimor të 52 ditëve pa Bashkimin, me 18 dhjetor 2008, Ylberi, me sytë gjithnjë të përlotur, nuk e pranonte mendimin se ***"Bashkimi i kishte shokët e rrallë"***, dhe me aksentin e bukur shkodran ngulmonte se:" ***Ai nuk ka patur shokë si veten! Ai lirisht mund të krahasohet me njerëzit e shenjtë***"!

Pas përfundimit me rezultate të shkëlqyera të studimeve të larta në vitin 1976, ky matematicien i talentuar, do të dërgohej si mësues i matematikës në shkollat 8 vjeçare të fshatrave të thellë të Grykë-Nokës, Suhodollit dhe Fushë-Alies të rrethit të Dibrës, deri në vitin 1983, kur do të merej si mësues i matematikës në gjimnazin e Peshkopisë, dhe shkas për këtë do të bëhej shoku i tij i studimeve, Ramiz Lela, atëherë shefi i arsimit të rrethit, që i dinte mirë vlerat e vërteta Bashkimit. Ndërkohë ai kishte dhënë provimet plotësuese universitare dhe ato pasuniversitare në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës, me rezultate të shkëlqyera, duke i marrë të gjithë notat dhjeta! Tregojnë se në provimin e parë plotësues, profesori i Tiranës, i ndikuar nga fakti se ai nuk ishte student i ditës, e vlerëson me notën 9! Bashkimi, që nuk e ka njohur kurë këtë notë, i kërkon porfesorit që ta rijapë provimin, dhe kështu u bë; në sezonin tjetër, ai sigurisht që do të merte notën10!

Duke parë se është fjala për një talent në matematikë, prof. Petraq Pilika, atëhere shef i katedrës së matematikës dhe profesorë të tjerë të këtij fakulteti, emra të njohur të matematikës, si prof. Aleko Minga dhe prof. Petraq Pepo, ndërhyjnë deri në udhëheqjen e lartë të kohës, përkatësisht tek Sekretari i KQ të PPSH që mbulonte arësimin, z. Manush Myftiu, për ta sjellë Bashkim Gazideden si pedagogë në fakultetin e matematikës, lëvizje që realizohet vetëm në vitin 1984! Në vitet 1984-1992 Bashkim Gazidede do të shkëlqente si pedagog i matematikës në këtë fakultet, duke lënë mbresa të pashlyera tek kolegët e sidomos tek studentët e disa brezave. Prof. Petraq Pilika, që qe miqësuar shpejt me këtë ***"djalë të mrekullueshëm të Dibrës***", në ditët e sëmundjes së tij fatale, e shprehte dhimbjen e fortë me pyetjen memece që i bënte zonjës së tij ***"Po ku u gjet kjo sëmundje për këtë djalë xhanëm?!"***

Bashkimi iku para kohe nga kjo botë duke lënë pas një dhimbje të fortë tek familja e tij, tek njerëzit e tij të afërt, tek farefisi dhe tek të gjithë ata që patën rastin të punojnë apo të njihen me të. Ndërsa ishim mbledhur me nxitim në shtëpinë e tij në Tiranë, atë mbrëmje të së shtunës së 25 tetorit 2008, dhe asnjë nuk mund t'i mbante lotët, babai i tij 87 vjeçar, Osman Gazidede, të cilit i pikonte zemra gjak për birin e shtrenjtë, mundohej të ngushëllonte shokët e djalit! Ishin të gjithë të dashurit e tij të zemrës, ata që kishin humbur një pjesë të shpirtit të tyre. "***Nuk kemi përse të qajmë !*** - u thoshte ai shokëve të Bashkimit. Pastaj ai ua thoshte arabisht dhe shqip vargjet kuranore, që unë po mundohem t'ja përcjell ju në shqip ***:"Zoti xh. sh. na ka lajmëruar ne! Unë do t'ju lindi ju! Unë do t'ju vdes ju! Unë do t'ju ringjallë ju! Tek unë të gjithë do të vini"!*** Dhe të pranishmit, me sy të përlotur, të ngrirë nga dhimbja e madhe, habiteshin me burrërinë e këtij njeriu të jashtëzakonshëm, këtij besimtari të paepur, këtij simboli të urtësisë e të mençurisë dibrane.

Bashkimi ishte një njeri shumë kurajoz, me vlera të shumëanshme njerëzore. Ai në asnjë moment nuk ju dorëzua sëmundjes së rëndë, dhe vazhdimisht u jepte të tjerëve kurajo! Këtë karakter të fortë ai e shfaqi që në fillimet e sëmundjes, kur askush nuk e dinte dhe ai kishte shkuar për vizitën parë mjekësore në Itali në fundin e nëntorit 2006. Ndërsa doktori italian i thotë hapur që në ditën e parë diagnozën fatale, pra në atë moment mjaft të rëndë, tronditës dhe shpesh të papërballueshëm, Bashkimi, me stoicizëm matematikor, i përgjigjet: ***"Ju faleminderit shumë doktor. Tani që e di se ç'kam, mund ta luftoi më mirë sëmundjen, ashtu sikurse zgjidhet më lehtë problemi me më pak të panjohura!"***.

Kam patur fatin që të jem përkohësisht bashkëstudent me të në të njëjtin Universitet dhe ruaj kujtime të mrekullueshme për këtë njeri të rrallë e të jashtëzakonshëm. Kur bisedonim, gjithnjë më kështillonte që në se doja të nderoja veten dhe familjen, duhet të studioja sistematikisht, dhe kurrë të mos i shtyja për të nesërmen detyrat e të sotmes. Në kujtimet e mia të shumta për të, nuk mund të harroj një episod të thjeshtë, por shumë domethënës për karakterin e këtij njeriu të rrallë. Ishte vjeshtë e vitit 1983. Gjatë një loje ushtarake, reparti i Brezhdanit, ku ai bënte zborin dhe ai i Melanit, ku unë bëja zborin, u takuan në kodrat midis fshatrave Trepçë e Melan të Peshkopisë. Pasi i regulluam çadrat e fjetjes, në buzëmbrëmje u ulëm në sheshin para tyre, ku më të shkathtit kishin ndezur një zjarr, ndërsa dikush tjetër kishte sjellë disa gështenja nga pylli i gështenjave aty pranë, të cilat po i piqte. Rreth zjarrit ishim rreth 8-9 veta. Duke biseduar, gështenjat u poqën dhe dikush na ndau të gjithëve nga 4-5 kokra. Ndërsa të gjithë filluam t'i shijonim gështenjat e pjekura, i vetmi që nuk i provoi ishte Bashkimi. Kur e pyetën se përse nuk po i hante, ai, për të mos fyer asnjë, u përgjigj se ***"gështenjat i hante vetëm të ziera"*** dhe këtu diskutimi mbyllej. Ata që nuk e njihnin mirë e besuan, por kur shkuam në çadër për të fjetur, ai më tërhoqi mënjanë dhe më foli ashpër: ***" Unë e kam ditur se ti je njeri i regullt!"*** më qortoi i nxehur, ndërsa në dritën e hënës unë i shihja damarin e ngritur mbi ball, shenjë e një zemërimi të madh. Unë që e kisha atë si modelin e njeriut të përsosur, e pyeta se çfarë kisha bërë për të merituar zemërimin e tij, ndërsa ai mu përgjigj se ***" kisha ngrënë gështenja haram"!***

Ai la shumë ëndra përgjysëm. Një prej tyre ishte të shihte Kosovën e lirë. Megjithëse kjo tashmë ishte bërë e mundur, ai, duke vlerësuar pozicionin që kishte patur si shef i SHIK-ut në vitet 1992-1997, për të mos krijuar asnjë paragjykim tek kundërshtarët e tij politik në Tiranë e në Beograd, priste shpalljen e pavarësisë së saj, që të shkonte në Prishtinë! Por fati nuk deshi ! Paraliza e rëndë dhe e papritur e këmbëve të tij nga gjuri e poshtë, që u shfaq në datën 3 shkurt 2008, preu çdo mundësi për të shikuar Kosovën e lirë! Dhe ai e përjetoi me emocion të fortë të djelën e ***17 shkurtit 2008***, duke ndjekur festimet e pavarësisë së shumëpritur në Prishtinë nga televizori në shtëpinë e tij, emocione

profil

Dilaver Duka, nga Dibra e Madhe është në vitin e dytë në Rutgers University në NJ. "Jam rritur që i vogël me ndjenjën e shqiptarit. Unë do ta kem shumë kënaqësi dhe do të jetë një nder nëse më krijohet mundësia për të luajtur me Shqipërinë"

që herë pas here ia përlotën sytë dhe faqet!

Prof. Enver Hasani rektor i Universitetit të Kosovës, erdhi nga Prishtina kur e dëgjoi lajmin fatal. Ai kishte jetuar për 4 vjet në një shtëpi afër Bashkimit në një lagje të Ankarasë, dhe shumë shpejt ishin bërë miq. Ai me lot në sy tregonte se sa e donte Bashkimi Kosovën! Por ***"mjerisht nuk munda me e marrë njëherë Bashkimin në Prishtinë!"*** thotë profesori i përlotur.

Ai la në mes një karrierë brilante akademike. Pas mbrojtjes në Tiranë në janar 1997, të doktoraturës me temë ***"Unazat dhe grupet*** me rezultatin ***"shkëlqyeshëm""***, ai do ta vazhdonte atë punë cfilitëse në një apartament të ngushtë të Ankarasë, në kushte aspak të favorshme, duke punuar gjatë 8 vjetëve ditën dhe natën deri në orën 2 të mëngjezit! Pesë nga 8 librat e tij të shkruar në Ankara, përkatësisht ***"Analiza Matematike I-II"*** dhe ***"Algjebra I-II"***, u botuan në vitin 2008, me sponsorizimin e shokëve të tij. Ata janë vlerësuar me superlativa nga kolegët e tij pedagogë të fakultetit, si botimet më të mira të derisotme në fushën e matematikës. Madje prof. Petraq Pepo në një emision televiziv të "TV Koha" të dt. 30 tetor 2008 kushtuar Bashkimit, u shpreh se ***"këto libra janë piedestali i monumentit të Bashkim Gazidedes!"***.

Bashkim Gazidede e ngriti monumentin e tij, me karakterin e tij të papërkulshëm dhe edukimin e rallë, me punën e tij të jashtëzakonshme intelektuale e atdhetare. Ai ishte i inspiruar nga thirja e Leonardo da Vinçit ndaj përtacëve e gjumashëve: ***"O ti që fle! Thuam ç'është gjumi?! Gjumi i përngjan vdekjes! Atëhere përse nuk bën vepra që edhe kur të vdesësh tu përngjashë të gjallëve, ndërsa ti i gjallë dhe u ngjan të vdekurve të trishtuar?!*** Dhe sikur ta dinte jetëshkurtësinë e tij, Bashkimi punoi ditën dhe natën, duke na lënë si trashëgim vepra të shkëlqyera, që e bëjnë emrin e tij të gjallë e të pavdekshëm.

Të shtunën e 2 shkurtit 2008, kur Bashkimi festonte me familjen ditëlindjen e tij të 56[të] dhe mjerisht të fundit në këtë botë, asnjë nuk e dinte se ajo do të ishte edhe dita e fundit që ai do të ecte me këmbët e tij! Asnjë, as edhe djali i tij, Besmiri 21 vjeçar, që e kujton me mall atë ditë si dhe fotografinë e fundit me babanë, që të dy në këmbë, krahë për krahu, si burrat! Dëshira e tij e parealizuar, thotë me emocion ai, ishte ***"të ngrihej edhe njëherë në këmbë"***, dhe të zhvillonte mësimin në fakultetin e tij, ashtu siç dinte ai!

Ai ishte në moshën që po i shihte fëmijët teksa riteshin. Dy fëmijë të mrekullueshëm si ëngjej. Ëndëronte që një ditë, të bënte një dasëm të madhe e të martonte djalin e vetëm, sapo ai të mbaronte studimet! Dhe të ftonte në atë dasëm të gjithë miqtë e shokët e tij të shumtë, në të gjithë Shqipërinë. Por nuk qe e thënë! Sëmundja e rëndë ia kishte zënë të gjitha shtigjet!

Dhe shokët e miqtë e tij erdhën me zemër të dridhur dhe lot në sy, për ta përcjellë Bashkim Gazideden në altarin e përjetësisë. Erdhën nga Amerika dhe Europa, nga Kosova dhe nga e gjithë Shqipëria! Se Bashkim Gazidede është i të gjithë Shqipërisë! Dhe Shqipëria e vërtetë u përul para tij duke e nderuar si hero!

Në mesditën e të dielës së 26 tetorit 2008 ai hyri për herë të fundit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, ku nuk kishte shkelur që nga 2 marsi i vitit 1997, ditë kur u kishte rënë këmbanave të alarmit, mbi reziqet që i kanoseshin Shqipërisë! Por këtë radhë ai hynte mbi supet e Gardës Kombëtare dhe nën marshet funebre të bandës së saj! Bënë homazhe para tij të gjithë ata që e donin, që nga Presidenti, Kryetari i Kuvendit Popullor, Kryeministri dhe e gjithë qeveria, deputetët, akademikët, studiuesit, nxënësit dhe studentët, mijëra qytetarë të thjeshtë të Tiranës, shokët e miqtë e tij të shumtë nga e gjithë Shqipëria! Një turmë e madhe disa dhjetra mijëshe njerëzish që gjithnjë kishin vlerësuar ndershmërinë, atdhetarizmin dhe vlerat e larta morale të këtij njeriu.

Ne jemi krenarë që qemë bashkëkohës së këtij njeriu të jashtëzakonshëm, të këtij shkencëtari të madh e të pasionuar, të këtij njeriu të dashur e të dhemshur, të këtij simboli të atdhetarizmit e të ndershmërisë. Krenare është familja që e riti dhe e edukoi, një familje e shquar atdhetare dhe antikomuniste! Krenare është familja që ai krijoi, shoqja e tij e mirë dhe dy fëmijët e tyre të mrekullueshëm! Krenare është Partia Demokratike ku ai militoi si rallë kush! Krenare është Shqipëria për Bashkim Gazideden, njeriun që e shkriu jetën në moshën më të mirë vetëm për Shqipërinë!

Bashkimi do të na mungojë të gjithëve. Në çastet e vështira, kur dallgët e mallit rreken të na përpijnë, na vjen në ndihmë Dritëroi me poezinë e tij plot mall ***"Dhe kur të jeshë mërzitur shumë, në raft të librave kërkomë, aty i fshehur do të jemë unë, në ndonjë fjalë a ndonjë shkronjë...!"***. Me këtë ndjenjë zhytem në librat e tij të matematikës për të shuar etjen dhe për t'u çmallur sadopak! Çdo rrjesht dhe çdo shkronjë mban frymën, djersën dhe mundin e tij dhe mua më duket sikur takohem e bisedoj me të! I shfletoj me nxitim, pa i kuptuar formulat e ngatërruara, dhe sytë më vishen me një tis malli kur lexoj kushtimin e tij me një kaligrafi të shkëlqyer:***"Me konsideratën time më të lartë, Bashkim Gazidede"***.

TALENTI SHQIPTAR PO SHKËLQEN ME AFTËSITË E TIJ SI FUTBOLLIST

Dilaver Duka: Dua të luaj për Shqipërinë!

Nga **FATJON PANDOVSKI**



Pozicioni: Mesfushor
Datëlindja: 09/15/1989
Vendlindja: Montville, NJ, SH.B.A.
Gjatësia: 1.79 m
Skuadra: Rutgers University

Dilaver Duka, i njohur si "Dil ly" është një nga talentet e afirmuar shqiptarë në SHBA. Ai ka lindur në SHBA dhe është fëmijë me gjak shqiptar. Babai i tij është nga Dibra e Madhe dhe nëna e tije ka lindur në Belgjikë. Gjyshi është larguar mbas ardhjes së komunizmit. Është në vitin e dytë në Rutgers University në NJ, që është një Universitet shumë prestigjioz dhe ka një program shumë të respektuar. Atje ka marrë katër vjet studime të akredituara nga Universiteti pa pagesë.

"Dilly" është mesfushori me tipare sulmuese, më i mirë në shtetin e New Jersey dhe ne jemi me fat që ta kemi në skuadrën tone", u shpreh trajneri i ekipit të futbollit në këtë Akademi Bob Reaso.

"Duka është një lojtar me shumë aftësi tekniko-taktike. Ai është një organizator i shkëlqyer me një fantazi dhe hapësirë në fushën e lojës që është shumë impresionuese dhe ka një aftësi depërtuese midis dy mbrojtësve që është për tu admiruar", shpjegoi përsëri trajneri i talentit shqiptar, i cili është përzgjedhur nga BIG EAST në skuadrën e më të mirëve dhe do të shtonte se: "Dilly" po luan shumë mirë për ne, jo vetëm duke organizuar lojën, por edhe duke shënuar". Dilaveri ka shënuar 8 gola në 18 ndeshje për skuadrën e tij duke qenë golashënuesi më i mirë.

Mesfushori organizator ka një disiplinë sistematike, sidomos kur vjen tek stërvitja. Ai praktikon rregullisht duke shpenzuar orë të tëra stërvitje, si ekipore ashtu edhe individuale. "Duka është një lojtar me të ardhme dhe asgjë nuk e pengon që ai të ketë një karrierë të bujshme. Ai është jo vetëm i talentuar, por është shumë i përkushtuar duke punuar çdo ditë që të përparojë. Unë kam pasur rastin të punoj me të katër vjet dhe tani që ai është 19 vjeç, është mosha më e mirë, që nga drejtuesit e futbollit shqiptar të ketë një shenjë interesi, pasi është me të vërtetë një futbollist me të ardhme. Shume vite më parë, unë mbaj mend që na kanë humbur shumë lojtarë, të cilët kanë preferuar të mos luajnë me Shqipërinë, pasi kur kanë qenë në mosha më të reja janë nënvlerësuar ose neglizhuar për aftësitë e tyre. Për të mos u përsëritur gabime të së kaluarës, është mirë që kur shfaqen talente të këtij stili të kenë një përqendrim dhe përkushtim më dedikues për t'i afruar pranë skuadrave të moshave përfaqësuese. "Dilly" shquhet për teknikën e tij të lartë. Ai gjuan me të dyja këmbët dhe është krijues i jashtëzakonshëm në fushë, pa harruar aftësinë dhe fatnazinë e tij për të shënuar", shpjegon ish trajneri i Dukës dhe ish futbollisti i njohur i Partizanit dhe kombëtares Shqiptare, mbrojtësi Skënder Gega.

Personalisht, "Dilly" ka shprehur shumë interes që të luajë për skuadrën përfaqësuese të moshave, sepse e ndjen në gjak dashurinë e kombit të tij nga puna edukuese familjare që ka bërë babai i tij, i cili rregullisht i flet për Shqipërinë. "Jam rritur që i vogël me ndjenjën e shqiptarit. E ndjej në vetvete sikur jam rritur aty, ndonëse kam lindur në SHBA. Unë do ta kem shumë kënaqësi dhe do të jetë një nder nëse më krijohet mundësia për të luajtur me Shqipërinë, aq më tepër që gjithçka mund të lehtësohet, pasi shumë shpejt unë mendoj të transferohem në Europë, ku aktualisht kam 2-3 testime të programuara për tu parë dhe vërejtur nga drejtues të klubeve të huaja gjatë periudhës Dhjetor – Janar – Shkurt", - shpjegoi Dilaver Duka, posaçërisht për wbsitin sportiv *Albaniasoccer.com*, duke ëndërruar që një ditë të veshi fanellën kuq e zi.

www.*albaniasoccer.com*

Shkruaj dhe ti mendimin tënd!

BËHUNI PJESË E GAZETËS!

duke u pajtuar dhe duke bashkëpunuar
gazeta hap faqet e saj për të rinjtë e shkollave, kryesisht për ata
që pretendojnë të fillojnë rrugën e gazetarisë, duke krijuar hapsira të posaçme
për krijimet e tyreletrare e publicistike...

Tel. (04) 22 33 283. E-mail: rrugaearberit@gmail.com.
Numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit.

www.**dibra**.org

Almo Konstruksion nderohet me çmimin ndërkombëtar **"KURORA E CILËSISË"**



Cila është shoqëria "ALMO KONSTRUKSION"

Shoqeria e ndertimit "ALMO Konstruksion" eshte themeluar sipas vendimit te Gjykates Nr.14381 date 28. 03. 1996 me qender ne qytetin e Shkodres. Aktualisht me seli ne Tirane sipas vendimit Nr.6821 date 13.07.1999 dhe filial ne Shkoder.

Gjate periudhes qe nga krijimi e deri tani shoqeria "ALMO Konstruksion" ka kryer ne sipermarje punime te ndryshme pothuajse ne te gjithe sferen e ndertimit, si ura me hapesira te ndryshme, rruge e riveshje asfaltike, mbikalime metalike te ndryshme, shkolla, ujesjellesa e kanalizime, godina banimi shumekateshe, vila etj. Ne te gjitha sipermarjet shoqeria ka kryer punime me cilesi te mire dhe brenda afateve te percaktuara ne kontrate.

Sot shoqeria ka nje personel inxhinjeroteknik te pergatitur dhe me nje pervoje pune mbi 25 vjecare, gjithashtu shoqeria disponon mjete e makineri si dhe burime financiare te mjaftueshme per te perballuar cdo sipermarje qe mund te marre shoqeria.

Me poshte po paraqesim eksperiencen ne ndertim, stafin drejtues dhe kapacitetin teknik te shoqerise:

I. EKSPERIENCEN NE NDERTIM

Objektet e ndertuara nga shoqeria "ALMO Konstruksion" janë të shumëllojshme si ndërtim rrugësh, urash, mbikalimesh, shkollash, spitalesh, etj.

II.STAFI DREJTUES I SHOQERISE

Stafi drejtues i shoqerise ka nje eksperience te gjate pune dhe pervoje per te ndertuar objekte qe perfshijne te gjithe sferen e ndertimit. Aktualisht stafi eshte i perbere nga Ing. Ndertimi, Teknike, manaxhere e specialiste te ndryshem te fushes se ndertimit.

III. KAPACITETI TEKNIK I SHOQERISE:

Shoqeria "Almo Konstruksion" disponon mjete e makineri nga me te ndryshmet me qellim qe te garantoje ndertimin e objekteve te ndryshme qe merr ne sipermarrje. Mbi 25 mjete e makineri shoqeria i ka ne pronesi, per te cilen disponon dokumentacionin e duhur.

IV. FUQIA PUNETORE


Shoqeria ka te punesuar specialiste te ndryshem si: manovratore, Specialist, karpentiere, elektriciste, hidraulike, mekanike, shofere, punetore, gjithsej (defenitive) 40 veta te cilet jane te siguruar dhe disponojne kontraten me Sig. Shoqerore

Per sa me siper Shoq. "Almo Konstruksion" duke u bazuar ne eksperiencen e saj, pervojen e stafit drejtues, kapacitetin e mjeteve dhe makinerive, fuqine punetore te specializuar si dhe burimet financiare qe disponon eshte ne gjendje te marre ne sipermarje objekte te ndryshme ne fushen e ndertimit. Prandaj Shoq. "Almo Konstruksion" eshte interesuar qe te aktivizohet ne investimet e vitit 2008 te cilat manaxhohen nga institucione te ndryshme shteterore dhe te huaja, shoqata joqeveritare, dhe shoqeri te huaja e shqiptare.









Certifikatë

I jepet
"Almo Konstruksion" Sh.P.K.

Në njohje të angazhimit të jashtëzakonshëm për arritjen e cilësisë dhe përsosmërisë, që meriton **ÇMIMIN NDËRKOMBËTAR, KURORA E CILËSISË, LONDËR 2008**

Në arritjen e kënaqësisë së Klientit, Drejtimit, Novacionit dhe Rendimentit sipas modelit QC 100 TQM

Londër, 24 nëntor 2008

ANGAZHIMI I "ALMO KONSTRUKSION" SH.P.K. NDAJ CILËSISË


Kompania jonë e pranon se Cilësia është faktor për t'u bërë më konkurrues.

"Almo Konstruksion" SH.P.K. është zotuar ta ndajë këtë kulturë cilësie me punonjësit e saj, furnizuesit, klientët dhe komunitetin e mbështetur nga Modeli i Menaxhimit të Cilësisë së Plotë QC 100, parimet e të cilit janë si më poshtë:

1. Cilësia është rrjedhojë e vlerësimit të kënaqësisë së klientit dhe sigurimit të rezultateve pozitive në biznes.
2. Arritja e niveleve të cilësisë sipas pikave të cilësisë QC 100.
3. Inkurajimi i pjesëmarrjes dhe të punuarit në grup për vendimmarrje.
4. Plotësimi i nevojave të klientëve tanë e të asaj që ata presin nga ne.
5. Sigurimi i burimeve njerëzore, si teknike ashtu edhe ekonomike, për të arritur përmirësime të vazhdueshme dhe për të respektuar mjedisin.
6. Menaxhimi i burimeve njerëzore në kompaninë tonë për të siguruar potencialin maksimal.
7. Ndërgjegjësimi i punonjësve për rëndësinë e përqendrimit të veprimtarisë në fushat më fitimprurëse ose më të përfiteushme për të arritur rezultatet më të mira të biznesit.

Përmbushja e këtyre 7 parimeve nga "Almo Konstruksion" SH.P.K.do të nxitë përmirësimin për klientët, punonjësit, furnizuesit dhe të gjithë personat e tjerë që janë pjesë e kompanisë.

Londër, 24 nëntor 2008




Rruga Milot - Ulëz 27/06/2007


Rruga "Frederik Shiroka", Tiranë


Shkolla "Lasgush Poradeci"